

ANALIZA

E GJENDJES SË GRAVE

NË ZONAT RURALE

MË TEPËR PENGESA
SESA MUNDËSI



Gratë në zonat rurale – më tepër pengesa sesa mundësi

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë
i përfaqësuar nga prof. dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktore:

Uranija Pirovska
Drejtoreshë Ekzekutive - Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM-së

Autore:

D-r Dijana Stojanoviç Gjorgjeviç
Tanja Tomiç
Violeta Kunovska
Ana Vasileva

Përkthimi dhe përshtatja në gjuhën shqipe:

Edita Jashari

Disenji grafik dhe botimi:

Relativ

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave.....	6
Përmbledhje.....	7
Hyrje.....	8
Metodologjia.....	12
Arritjet formalo-juridike në vendosjen e barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë.....	16
Arsimi.....	27
Shëndetësia.....	45
Martetat e të miturve.....	56
Mbrojtja sociale.....	65
Juruket.....	78
Studim i rastit 1.....	83
Studim i rastit 2.....	85
Konkluzione dhe rekomandime.....	87
Bibliografia.....	90

Lista e shkurtesave

KB – Kombet e Bashkuara
OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
ESHS – Enti Shtetëror i Statistikave
SHGB – Shoqata e Grave Bujke
MPPS – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MD – Ministria e Drejtësisë
MB – Ministria e Bujqësisë
MPB – Ministria e Punëve të Brendshme
MASH – Ministria e Arsimit dhe Shkencës
RM – Republika e Maqedonisë
SHMPK – Shkollë e Mesme Profesionale Komunale
SHMKE – Shkollë e Mesme Komunale e Ekonomisë
SHFK – Shkollë Filllore Komunale
SHMK – Shkollë e Mesme Komunale
SHMPK – Shkollë e Mesme Komunale Profesionale
SHF – Shkollë Filllore
SHM – Shkollë e Mesme
SHMKSHN – Shkollë e Mesme Komunale me Shtëpi Nxënësish
SHKHT – Shkollë Komunale Hotelieriko-Turistike
QSHKEM – Qendër Shkollore Komunale e Elektro-Makinerisë
FB – Rrjeti Social Facebook
OJQ – Organizatë Joqeveritare
PAP Test – Metodë e ekzaminimit të ndryshimeve në grykën e mitrës
FSSHM – Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Maqedonisë
ISHP – Institucioni Shëndetësor Privat
MAKStat – Baza Statistikore për Maqedoninë e Entit Shtetëror të Statistikave
UNFPA – Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
ISHP – Institucioni Shëndetësor Publik
APRM – Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë
QPS – Qendra e Punës Sociale
UN Women – Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
VMRO DPMNE – Partia Politike Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas

Përmbledhje

Analiza e titulluar “Gratë në zonat rurale – më tepër pengesa sesa mundësi” është zhvilluar në kuadër të Projektit “Mbështetja e shoqërisë civile në krijimin e politikave mbi kohezionin social dhe dallimeve” dhe ka për qëllim ta prezantojë pozicionimin e grave që jetojnë në zona të caktuara rurale në territorin e Republikës së Maqedonisë. Kjo analizë nëpërmjet një pasqyrimi gjithëpërfshirës të kornizës ligjore, politikave dhe praktikave që ndikojnë mbi jetën e këtyre grave, është përqëndruar në fushat qëllimore: arsimin, mbrojtjen shëndetësore, martesat e të miturve dhe mbrojtjen sociale, pasqyron gjendjen aktuale, si dhe qasjen e grave rurale në shërbimet dhe serviset e këtyre fushave.

Analiza pasqyron se ku për momentin gjendet Republika e Maqedonisë në arritjet formalo-juridike për vendosjen e barazisë gjinore, dhe njëkohësisht nëpërmjet të identifikimit të problemeve dhe sfidave me të cilat në bazë ditore po përballen gratë rurale në procesin e realizimit të të drejtave të caktuara, tregon se në cilën masë vendimet ligjore, politikat dhe praktikat ekzistuese u mundësojnë këtyre grave qasje të barabartë në arsim, mbrojtje sociale dhe shëndetësore. Me dhënien e shembujve të praktikave të mira nga legjislacioni ndërkombëtar në analizë janë prezantuar përvojat pozitive për inkuadrim të plotë të vajzave rurale në procesin arsimor, për përmirësimin e qasjes në shërbime sociale për gratë rurale, si dhe për fuqizimin e mbrojtjes shëndetësore të grave rurale, me vështrim në shërbimet gjinekologjike.

Specifika e këtij hulumtimi përbëhet nga ajo se grupi qëllimor në pjesën më të madhe nuk percepton fare se ekzistojnë probleme apo vështirësi në realizimin e të drejtave të caktuara, dhe si rezultat i kësaj, nuk ndien nevojën për aktualizimin e tyre, gjë kjo e cila do të kishte rezultuar me gjetjen e rrugëdaljeve përkatëse për zgjidhjen e tyre. Zhvillimi i ndryshëm ekonomik, social dhe shoqëroro-kulturor i rajoneve të Republikës së Maqedonisë ka treguar se të folurit rreth këtyre temave është i padëshiruar, problematik, madje edhe i ndaluar në zona të caktuara. Pikërisht për shkak të kësaj, sigurimi i hapësirës së sigurt ishte vendimtar për dëgjimin e storjeve të sinqerta jetësore, të ndërthurura me probleme dhe sfida në jetesën e përditshme të këtyre grave.

Edhe pse mund të konstatohet se sot jeta e grave rurale në përgjithësi po dallon nga jeta e të parave të tyre, prapseprap matrica patriarkale dhe ndarja tradicionale në role mashkullore-femërore janë akoma në masë të madhe të përfaqësuara në këto zona. Si rezultat i kësaj, është i madh probabiliteti se përpjekjet për zgjidhjen e problemeve të tyre me masa dhe politika të rregullta nuk do të japin rezultatin e dëshiruar. Ekipi hulumtues ka sintetizuar të gjitha informacionet dhe të dhënat e grumbulluara nga institucionet, si dhe nga vetë gratë, në rekomandime dhe masa konkrete, të cilat jo vetëm se do të kishin patur efekt mbi tejkalimin e problemeve dhe sfidave me të cilat po përballen këto gra, por ato njëkohësisht do të kishin patur ndikimin edhe mbi përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetave të tyre.

Hyrje

Në dekadat e fundit, në pjesën më të madhe të botës, është ndryshuar konsiderueshëm vështrimi ndaj rolit të gruas në shoqëri. Në të kaluarën, roli i gruas ishte në masë të madhe i lidhur me amvisërinë, dhe gruaja para së gjithash, është perceptuar si përgjegjësjja e vetme për gatim dhe pastrim, përkujdesje për shtëpinë dhe familjen, ndërsa roli i burrit kishte patur të bënte me fushën publike, sigurimin e mjeteve financiare të nevojitura për ekzistencën e familjes, si dhe për aktivitetet shoqëror. Ndarja e roleve të gruas dhe burrit në shtëpi, andaj dhe në shoqëri, kishte filluar përpara shumë mijëvjeçarëve, që nga koha kur filozofët dhe teoricientët e lashtë grekë gruan nuk kishin konsideruar as si qytetar, andaj ia kishin rrëmbyer të drejtën që barabartësisht me burrin të merr pjesë në sjelljen e vendimeve të cilat kishin prekur polisin. Ajo ishte vënë në të njëjtën pozitë me robërit dhe fëmijët, andaj nuk është për t'u habitur se autorët e asaj kohe shikojnë nëpër prizmin e burrave dhe grave. "Për burrat, shkëlqimi i një çështjeje të guximit, inteligjencës dhe suksesit shoqëror. Për gratë, bukuria, aftësitë për obligimet e shtëpisë, e sidomos besnikëria martesore, janë virtyte të njohura"¹.

Se klima e frytshme për skllavërimin e gruas kishte zgjatur me shekuj dhe pothuajse deri në ditët tona dëshmojnë shumë fakte nga fusha të ndryshme të jetës. "Në bazë të të dhënave të OKB, gratë e planetit kryesisht nuk posedojnë tokë, por kryesisht po e përpunojnë atë; nuk kanë kapital, por punojnë më tepër për më pak para, sidomos kur kihet parasysh puna pa pagesë, e cila në historinë botërore po identifikohet me punën skllave; sipas numrit, ato paraqesin shumicën e votuesve, ndërsa janë të përfaqësuara jopërkatesisht në pushtet; kanë qasje më të ulët në mallrat kulturore dhe mediat, edhe pse personaliteti i gruas në ato fusha po keqpërdoret masovikisht; institucionet e arsimit, ato shëndetësore dhe akademike ofrojnë depërtimin më të ulët të grave"². Kohëve të fundit, në disa shtete grave nuk u është lejuar të dalin për votime, e as të sjellin vendime. Vetëdijësimi i grave, si dhe organizimi i tyre ka bërë të mundur që ato ta ngrisin zërin dhe të fillojnë të luftojnë për arritjen e të drejtave më të mëdha. Mund të thuhet se ndër vite po vërehet një përmirësim i konsiderueshëm i cilësisë së jetesës së grave, sidomos në kuptimin e çështjeve të ekzistencës, por megjithatë, disa nga problemet dhe çështjet që prekin gratë akoma mbeten të hapura. Suksesi i lëvizjes së grave mund të rangohet nga arritja e grave nëpërmjet të pushtimit të së drejtës së votës, vendosjes së qasjes së barabartë në arsim, si dhe rritjes së numrit të grave në pozita të larta në jetën publike, e deri në luftën e tyre për legalizimin e abortit, dhënies fund të gjymtimit gjeneral dhe çrënjosjen e dhunës së bazuar mbi gjininë.

Sipas hulumtimit të Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Zhvillimor - Sida³ të zbatuar në vitin 2015⁴, gratë në zonat rurale, gjithandej në botë, mund të fuqizohen ekonomikisht po që se kanë qasje në resurse dhe po që se kanë njohuri dhe aftësi që ato t'i shfrytëzojnë në mënyrën përkatëse. Nësë gratë kanë qasje në mundësitë ekonomike dhe kontrollit mbi përfitimet ekonomike nga ato mundësi, si dhe nëse mund dhe dijnë si t'i shfrytëzojnë ato përfitime për të bërë zgjedhje strategjike, mund të presin ndryshime pozitive në jetat e tyre.

1 Mallnes, Raino dhe Midgard, Knut, Filozofia politike, Feniks, Shkup, 2008, fq. 290

2 Sllashpak, Svetlana, Ikonat e gruas të shekullit XX, Templum, Shkup, 2003, fq. 312

3 "Sida" është një agjenci qeveritare e cila vepron në emër të Riksdagut Suedez dhe Qeverisë për reduktimin e varfërisë në botë. Me ndihmën e punës së tyre, ato kontribuojnë për zbatimin e politikës zhvillimore globale të Suedisë.

4 "Supporting Women's Economic Empowerment: Scope for Sida's Engagement", publikuar nga: Sida, 2015, fq. 8, 9 dhe 10

Ekzistimi i kushteve eksploative dhe diskriminatore të punës, segregimi gjinor në tregun e punës, lëvizja e kufizuar, ngarkesa e dyfishtë me punë e grave, janë vetëm disa nga faktorët që ndikojnë jo vetëm mbi qasjen e grave në ndonjë vend pune të caktuar, por edhe mbi efektshmërinë dhe efikasitetin e tyre gjatë kryerjes së detyrave të punës. Kushtet e këtilla të punës, jo rrallë çojnë drejt problemeve me shëndetin – duke përfshirë këtu edhe problemet me shëndetin riprodhues. Puna e papaguar, si në fushën produktive, ashtu edhe në fushën shtëpiake, e cila merr shumë kohë dhe energji, është njëra nga pengesat më kryesore drejt sigurimit të të ardhurave përkatëse dhe fuqizimit ekonomik të grave. Të dhënat nga Enti Shtetëror i Statistikave tregojnë se “punësimi në Republikën e Maqedonisë po karakterizohet me një strukturë shumë të pafavorshme gjinore. Kjo strukturë është e pandryshuar në një periudhë më të gjatë kohore, para së gjithash, për arsye të kushteve jostabile ekonomiko-sociale në vend dhe të mosharmonizimit të profileve të disponueshme dhe të nevojitura në tregun e punës. Shkalla e punësimit^{5*} në Republikën e Maqedonisë në vitin 2016 tek gratë kishte arritur 33.8 dhe është konsiderueshëm më e ulët në krahasim me atë tek burrat, e cila kishte arritur 52.3. Shkalla e punësimit* tek gratë kishte arritur 22.7, ndërsa tek burrat 24.4. Shkalla e aktivitetit^{6*} tek gratë është më e ulët dhe arrin 43.8, ndërsa është dukshëm më e lartë tek burrat, duke arritur 69.2”⁵.

Anketa mbi shfrytëzimin e kohës⁶, e zbatuar nga Enti Shtetëror i Statistikave i Republikës së Maqedonisë në periudhën nga maji 2014 deri në prill 2015 tregon se dita e punës, me të cilën përfshihen edhe aktivitetet shtëpiake* dhe punësimi* është më e gjatë për gratë dhe zgjatë 5 orë dhe 36 minuta, sesa për burrat, e cila zgjatë 4 orë dhe 13 minuta. Fatkeqësisht, proporcioni ndërmjet përqindjes së punës e cila po kryhet me kompensimin ekonomik ka dallim nga 1 orë dhe 44 minuta në shfrytëzimin e burrave, që gjithësesi u mundëson realizimin e fitimit, pozitave më të mira dhe benefiteve më të larta. Të dhënat tregojnë se gratë në zonat rurale pjesën më të madhe të kohës së vet, apo 4 orë dhe 22 minuta ua kushtojnë aktivitetet shtëpiake, të papaguara, ndërsa vetëm një orë e 18 minuta në ditë ia kushtojnë një aktiviteti i cili u mundëson realizimin e kompensimit financiar⁷. Njëra nga arsyet kryesore për varësinë ekonomike të grave është fakti se ato marrin përsipër përgjegjësinë elementare të punës së papaguar në shtëpi. Funksionimi drejtpërsëdrejti në shtëpi, dhe tërthorazi edhe në shoqëri, në masë të madhe varet nga puna e papaguar e grave, nëpërmjet të së cilës po sigurohet kujdesi i nevojshëm për anëtarët e rinj, pleq dhe të sëmurë të familjes. Kjo gjë kufizon kohën e grave, që mund t’u përkushtohet angazhimit efikas me punë, e cila gjeneron të ardhura dhe në shumë vende në zhvillim kjo gjendje rezulton me varfëri akute të grave. Edhe pse të dhënat nga Enti Shtetëror i Statistikave⁸ tregojnë rënie të shkallës së papunësisë

*Shkalla e punësimit – pjesëmarrja e numrit të të punësuarve në popullsinë me aftësi juridike të punës në moshë nga 15 deri 79 vjeç

*Shkalla e punësimit – pjesëmarrja e numrit të të punësuarve në krahun e përgjithshëm të punës.

*Shkalla e punësimit – pjesëmarrja e numrit të të punësuarve në popullsinë me aftësi juridike të punës në moshë nga 15 deri 79 vjeç

5 “Gratë dhe burrat në Maqedoni” 2017, Enti Shtetëror i Statistikave, Shkup, fq. 57, e disponueshme në: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/Gender2017.pdf>

5 Anketë mbi shfrytëzimin e kohës, 2014/2015, Enti Shtetëror i Statistikave, Shkup, e disponueshme në: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.20.pdf>

*Pastrimi i shtëpisë, përkujdesja për fëmijët dhe të rriturit, kopshtaria dhe përkujdesja për kafshët shtëpiake, ndërtimi dhe riparimet, blerja dhe shërbimet dhe përkujdesja për amvisërinë.


*Koha e kaluar në punën dhe aktivitetet kryesore dhe plotësuese lidhur me punësimin, pauzat dhe udhëtimet gjatë orëve të punës dhe kërkimit të punës.

7 Anketë mbi shfrytëzimin e kohës, 2014/2015, Enti Shtetëror i Statistikave, Shkup, fq. 26, e disponueshme në: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.20.pdf>

8 http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat__PoloviStat/125_PoloviStatistiki_en.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef

tek gratë në 3 vitet e kaluara, siç është prezantuar në Grafikon 1, fatkeqësisht hulumtime të caktuara tregojnë se “gratë fitojnë për 12.5% më pak se burrat për një punë e cila ka vlerë të barabartë, ndërsa boshllëku po rritet me uljen e shkallës së arsimit; gjegjësisht, po rritet në 28.4% për personat pa arsim formal, ose pa arsim fillor. Gratë janë për 17.3% më pak të paguara se burrat për punë që kanë vlerë të barabartë, dhe janë me shkallë të njëjta të përvojës ose arsimit”.⁹

Grafiku 1



Si rezultat i kësaj, më tepër gra sesa burra nuk kanë qasje në resurse dhe mundësi të vlefshme, që fuqizon pozitën e tyre të nënshtruar në shoqëri. Të dhënat e Kombeve të Bashkuara¹⁰ tregojnë se rreth një miliardë njerëz jetojnë në varfëri ekstreme, dhe nga ata, shtatëdhjetë përqind janë gra dhe vajza, dhe, meqë gratë përbëjnë gjysmën e njerëzimit, ato posedojnë vetëm një përqind nga prona e përgjithshme në botë. Varfëria gjithnjë e më tepër po feminizohet, ndërsa mbi kufizimet e të drejtave të grave në pjesë të caktuara të botës, shumë shpesh ndikim vendimtar kanë kultura, tradita dhe feja.

Në Republikën e Maqedonisë, që nga pavarësimi i saj e deri më sot, shënohet një avancim i të drejtave të grave në të gjitha fushat e jetesës, si në kuptimin e realizimit të së drejtës së arsimit dhe punësimit, ashtu edhe në kuptimin e mbrojtjes shëndetësore. Edhe përskaj asaj se të drejtat e grave në Republikën e Maqedonisë janë garantuar me Kushtetutën, dhe me sjelljen e Ligjit mbi Mundësitë e Barabarta është arritur një progres në kornizën institucionale, politike dhe juridike, prapëprap me keqardhje mund të konstatohet se në shtetin tonë akoma ka rajone rurale ku jetojnë gra, të cilat për arsye nga më të ndryshmet (tradita, kultura, feja, e ngjashëm) nuk kanë mundësi të formojnë arsimim të qëndrueshëm, nuk mund të punësohen, herët hyjnë në martesë dhe krijojnë familje, kurse kanë edhe qasje të kufizuara në mbrojtjen sociale dhe shëndetësore, gjë kjo e cila çon drejt cilësisë së reduktuar të jetave të tyre.

Problemet me të cilat po përballen gratë e zonave rurale më së shpeshi po shpërfillen nga institucionet kompetente, ose po trajtohen me masa të rregullta të cilat jo çdoherë çojnë drejt rezultatit të dëshiruar. Për shkak të qasjes së tillë, gratë nga zonat ru-

9 Finance Think, EdPlako Application, <<http://www.edplako.mk/истражувања/>>

10 Worlds apart – Reproductive health and rights in an age of inequality, UNFPA, State of world population, 2017, e disponueshme në: https://www.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/UNFPA_PUB_2017_EN_SWOP.pdf

rale janë në gjendje shumë të vështirë dhe shpesh biejnë në mesin e popullsisë më të varfër, puna e tyre është cilësuar me vlerë të ulët, duke përfshirë këtu dhe punën në amvisërinë familjare, obligimet familjare dhe puna në pronën bujqësore familjare. Në këto amvisëri, më së shpeshi të ardhurat për familjen i realizon burri, i cili është tradicionalisht pronar i tërë pronës, që bën gratë plotësisht të varura nga anëtarët mashkullorë të familjes. Një pjesë e madhe e grave që jetojnë në zonat rurale janë të papunësuar, dhe për këtë në pjesë të madhe kontribuon shkalla e ulët e arsimit, që më së shpeshi është rezultat i hyrjes së hershme në martesë dhe i krijimit të familjes, ose i përkujdesjes për të tjerët – vëllezërit/motrat më të reja ose anëtarët më të moshuar të familjes me të cilët jetojnë në bashkësi. Vlerat patriarkale të shprehura në masën dominante dhe ndarja tradicionale e roleve gjinore edhe më tepër ndikojnë pozitën e gruas rurale si në familje, ashtu dhe në shoqëri.

Specifika e këtij hulumtimi përbëhet nga fakti se ekipi hulumtues po gjente mënyra të ndryshme që të mund të prek grupin qëllimor – gratë rurale. Duke patur parasysh se jo të gjitha rajonet në Republikën e Maqedonisë kanë arritur zhvillim të njëjtë ekonomik, social dhe shoqëroro-kulturor, gjatë zbatimit të hulumtimit, ekipi hulumtues po përballëj me një sërë sfidash lidhur me atë se si t'i motivonte gratë të flasnin për tema të cilat në mjedise të caktuara po konsiderohen si të padëshiruara, madje edhe të ndalura, dhe si të siguronte një hapësirë të sigurt, ku ato do të ndjeheshin mjaftueshëm të sigurt dhe komode që të mund të ishin të sinqerta në përgjigjet e tyre. Ekipi hulumtues po përdorte mënyrat kreative që të "nxjerr" nga gratë e intervistuarat përgjigje të cilat nuk do jenë në drejtim të qëndrimeve të favorshme për shoqërinë, ose ato që supozojnë se duhet të dëgjohen, por ndarje të storjeve të tyre të sinqerta jetësore, përplotë me problemet dhe sfidat që sjell me vete jeta në një zonë rurale. Grupi qëllimor i këtij hulumtimi në masë të madhe nuk percepton fare se ka probleme ose vështirësi të caktuara në realizimin e të drejtave të caktuara, gjë kjo e cila në fakt zvogëlon nevojën e tyre për prezantim publik të problemeve, folje të hapur për ato dhe gjetje të rrugëdaljeve me të cilat do të ishin zgjidhur ato. Për shkak të vetëdijësimit publik dhe rënimit të stereotipeve dhe paragjyqimeve gjinore, ekipi hulumtues vendosi që për të gjitha pjesëmarrëset në këtë hulumtim të përdoret gjinia femërore.

Metodologjia

Qëllimi i këtij hulumtimi është të identifikohet pozita e grave të cilat jetojnë në zona të caktuara rurale në territorin e Republikës së Maqedonisë, si dhe të identifikohen problemet dhe sfidat me të cilat ato po përballen, për sa i përket qasjes në shërbime dhe servise të caktuara. Të dhënat e marra gjatë hulumtimit, si dhe vetë analiza kanë për qëllim të dëshmojnë se zgjidhjet ekzistuese ligjore mundësojnë dhe nxisin një qasje të barabartë në arsim, mbrojtje sociale dhe shëndetësore të grave në zonat rurale, si dhe në cilën mënyrë mund të përmirësohet gjendja e tyre nëpërmjet të dhënies së rekomandimeve konkrete për tejkalimin e problemeve dhe propozimeve për përmirësimin e jetës së përgjithshme të këtyre grave.

Analiza ofron një pasqyrë të përgjithshme mbi atë se ku për momentin po gjendet Republika e Maqedonisë për sa iu përket arritjeve formalo-juridike në vendosjen e barazisë gjinore, nëpërmjet të një analize të dokumenteve kombëtare. Në të njëjtën kohë, me shembuj të praktikave të mira nga legjislacioni ndërkombëtar në dokument janë prezantuar përvojat pozitive e përfshirjes së plotë të vajzave rurale në procesin arsimor, përmirësimin e qasjes në shërbime sociale për gratë rurale, si dhe fuqizimin e mbrojtjes shëndetësore të grave rurale, me vështrim në shërbimet gjinekologjike.

Hulumtimi kryesisht u përqëndrua në katër fushat në vijim: **arsimin, mbrojtjen shëndetësore, martesat e të miturve dhe mbrojtjen sociale**, ku bëri përpjekje ta prezantonte gjendjen aktuale, si dhe qasjen e grave rurale në shërbimet dhe serviset e këtyre fushave.

Në kuadër të hulumtimit u targetuan katër rajone planore me tipare të ndryshme demografike¹¹ (Rajoni i Pollogut, Rajoni Jug-Perëndimor, Rajoni Lindor dhe Rajoni Jug-Lindor), në të cilët u grumbulluan të dhënat primare me vegla dhe teknika të ndryshme metodologjike. Rajonet e targetuara janë shënuar me ngjyrë të kuqe në Imazhin 1.


Imazhi 1



11 Më tepër informacione mbi rajonet planore janë të disponueshme në: <http://brr.gov.mk/mk/>

Në kuadër të rajoneve u targetuan komunat në vijim: në Rajonin e Pollogut – komunat: Bërvenicë, Vrapçisht, Jegunoc dhe Tearcë (vendet e banuara: Zuboc, Toplicë, Gllogjë, Pirok, Miletinë, Jazhincë); në Rajoin Lindor – komunat: Zërnoc, Çeshinovë–Obleshevë dhe Karbincë (vendi i banuar: Kauzlija), Rajoni Jug-Perëndimor – komunat Debërcë (vendet e banuara: Vellmej dhe Mesheishtë) dhe Qendra Zhupa (vendi i banuar Brashticë) dhe në Rajonin Jug-Lindor – komuna e Radovishit (vendi i banuar: Ali Koç) dhe Konçë. Komunat e targetuara janë të shënuara me ngjyrë të kuqe në Imazhin 2.

Imazhi 2




Hulumtimi po bazohej në grumbullimin e të dhënave kualitative dhe kuantitative të marra me ndihmën e teknikave dhe metodave të hulumtimit, si vijon: analizë destop, intervista të semi-strukturuara me gra rurale dhe përfaqësuese të institucioneve qendrore, grupe fokusi me përfaqësuese të organizatave joqeveritare, analizë të të dhënave me karakter publik dhe studim të rastit, me të cilën janë përdorur instrumentet hulumtuese në vijim: pyetësorë anketues, pyetësor për intervistë të semi-struktuar, pyetësor për grupe fokusi, kërkim të informacioneve me karakter publik, protokoll mbi studimin e rastit.

Analizimi i dokumentacionit. Në kuadër të hulumtimit u shfrytëzua një analizë de-stop të ligjeve kombëtare, akteve nënligjore, dhe dokumenteve tjera relevante kombëtare dhe ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, në bazë të përgjigjeve në kërkesat për qasje në informacione me karakter publik, si dhe pyetësorët anketues të marrë nga institucione qendrore dhe lokale, u bë një analizë e të dhënave statistikore dhe e të dhënave tjera relevante kualitative lidhur me arsimin, martesat e të miturve, mbrojtjen sociale dhe shëndetësore të grave të zonave rurale të targetuara me këtë hulumtim.

Intervista e semi-struktuar. Me këtë teknikë hulumtimi u përfshinë gjithsej 57 gra të intervistuar, si vijon: a) në Rajonin e Pollogut u intervistuan gjithsej 22 gra të intervistuar, nga të cilat 11 janë nga komuniteti etnik maqedonas, 8 nga komuniteti etnik shqiptar dhe 3 nga komuniteti etnik rom; nga ato, 4 janë me arsim të kryer filor, 9 me arsim të kryer të mesëm dhe 9 me arsim të kryer të lartë, në moshë nga 22

deri 57 vjeç; b) në Rajonin Lindor janë intervistuar gjithsej 14 gra, nga të cilat 8 nga komuniteti etnik maqedonas dhe 6 nga komuniteti etnik turk – juruke; nga ato 6 me arsim të kryer fillor, 7 me arsim të kryer të mesëm dhe 1 me arsim të kryer të lartë, në moshë nga 18 deri 54 vjeç; c) në Rajonin Jug-Perëndimor janë intervistuar gjithsej 11 gra, nga të cilat 7 janë deklaruar si maqedonase muslimane, ndërsa të tjerat si maqedonase; nga ato 7 me arsim të kryer fillor, 2 me arsim të kryer të mesëm dhe 2 me arsim të kryer të lartë, në moshë nga 25 deri 58 vjeç; ç) në Rajonin Jug-Lindor u intervistuan gjithsej 10 gra të komunitetit etnik turk – jurukë, gjithë me arsim të pakryer fillor (me 4 klasa të kryera të shkollimit) dhe në moshë nga 30 deri 71 vjeç. Moshë e të gjitha të intervistuarave lëvizte nga 18 deri 71 vjeç, dhe nga ato, 10 ishin me arsim të pakryer fillor (me 4 klasa të kryera të shkollimit), 17 ishin me arsim të kryer fillor, 18 me arsim të kryer të mesëm dhe 12 me arsim të kryer të lartë, ndërsa 25 ishin të punësuara, 32 ishin të papunësuara. Përfaqësimi procentual i komuniteteve etnike të cilëve u përkasin të intervistuarat është prezantuar në Grafikon 2.

Grafiku 2



Intervistat e zbatuara mundësuan qasje në perceptimin e grave nga rajonet e targetuar mbi pozitën e tyre në shoqëri, si dhe qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve dhe serviseve nga fushat e përmendura më lartë.

Në kuadër të hulumtimit u zbatuan edhe 3 intervista me përfaqësuese të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Intervistat e zbatuara mundësuan vështrim në perceptimin e përfaqësueseve të institucioneve qendrore mbi pozitën e grave nga zonat rurale në shoqëri, si dhe shkallën e shfrytëzimit të shërbimeve dhe serviseve të caktuara nga fushat e përmendura më lartë.

Grupet e fokusit. Në kuadër të hulumtimit u zbatuan 4 grupe fokusi me gjithsej 35 përfaqësuese të 31 organizatave joqeveritare, të cilat po trajtojnë çështjet dhe problemet të cilat po i trajton ky hulumtim. Grupet e fokusit u zbatuan në rajonet në vijim: a) në Rajonin e Pollogut në takimin e grupit të fokusit morën pjesë gjithsej 9 përfaqësuese nga organizatat joqeveritare në vijim: Qendra e Edukimit dhe Zhvillimit – Tearcë; Instituti i Zhvillimit të Komunitetit – Tetovë; “Romano Avazi” – Tetovë; Asociacioni i Zhvillimit Demokratik të Romëve “Sonce” – Tetovë; Shoqata e Zhvillimit Lokal dhe Rural – Tetovë; “Zllatna Raka” – Tetovë dhe Shoqata “Forumi i Gruas” – Tetovë; b) në Rajonin Jug-Lindor në takimin e grupit të fokusit morën pjesë gjithsej 7 përfaqësuese të organizatave joqeveritare në vijim: Qendra e Komunitetit të Komunës së Strumicës – Strumicë; “Prodollzhen Zhivot” – Strumicë; “ZUG” – Valandovë; Qendra Rajonale e Zhvillimit – Gjevgjeli; “Rodova perspektiva” – Strumicë dhe “Zhenska Akcija” – Radovish; c) në Rajonin Lindor në takimin e grupit të fokusit morën pjesë gjithsej 9 përfaqësuese të organizatave joqeveritare në vijim: “Eho” – Shtip; “Kllaster Kreativa” – Shtip; Unioni i Grave – Shtip; SHGB “Agro Vinka” – Vinicë, Unioni i Rretheve Makinerike – Probishtip; “Ambrozija” – Pehçevë; KHAM – Dellçev;

“Gllasen tekstilec” – Shtip; “Edukativen centar” – Çeshinovë-Obleshevë; ç) në Rajonin Jug-Perëndimor në takimin e grupit të fokusit morën pjesë gjithsej 10 përfaqësues të organizatave joqeveritare në vijim “Rilindja” - Strugë; “Rilindja” - Kërçovë; SH.F. “Vëllazërim-Bashkim” - Dibër; Shoqata e integritit multikulturor “Inkluzioni” - Ohër; Shoqata e Mundësive të Barabarta “Ezerka” - Strugë; Shoqata e Gruas Shqiptare – Kërçovë; “Akua” - Strugë; Shoqata “Aureola” - f. Veleshtë; Shoqata “Aureola” - Dellogozhdë.

Grupet e zbatuara të fokusit mundësuan vështrim në aktivitetet e organizatave joqeveritare nga rajonet e targetuara në identifikimin, analizimin dhe aktualizimin e problemeve me të cilat po përballen gratë rurale në zonat e përfshira me këtë studim.

Kërkesa për informacione me karakter publik. Deri tek Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Publike, Drejtoria e Mbajtjes së Librave Amëz, 15 komunat e targetuara, si dhe deri tek 60 shkolla fillore dhe të mesme, 6 qendra të punës sociale, 6 shtëpi shëndetësore lokale dhe 9 klinika dhe spitale të përgjithshme nga rajonet e targetuara, u dërguan gjithsej 102 kërkesa për qasje në informacione me karakter publik dhe pyetësorë anketues të cilët duhej të ofronin vështrim në të dhëna të caktuara kuantitative dhe kualitative, të cilat përfshijnë rajonet e targetuara dhe temat e këtij hulumtimi.

Studimi i rastit. Kjo teknikë e hulumtimit ka për qëllim të sigurojë të dhëna kualitative që duhet të prezantojnë detaje si dukuri dhe procese të caktuara, të cilat ndikojnë cilësinë e jetesës së një gruaje, si dhe pasojat të cilat ato shkaktojnë. Në kuadër të hulumtimit u zbatuan 2 studime **të rastit, me ndihmën e të cilëve** është prezantuar jeta e dy grave, nëpërmjet të fushave të cilat trajton kjo analizë.

Arritjet formalo-juridike në vendosjen e barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë*

Në 26 vitet e pavarësisë, Republika e Maqedonisë ka arritur një progres të caktuar në vendosjen e barazisë gjinore, është miratuar një numër i konsiderueshëm i masave formalo-juridike, por megjithatë akoma duhet punuar në drejtim të zbatimit të tyre të plotë në praktikë. Në pajtim me Nenin 9 të **Kushtetutës** së Republikës së Maqedonisë, në pjesën që përfshin liritë dhe të drejtat civile dhe politike, rregullohet çështja se: “qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, origjina kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare; gjendja pronësore dhe shoqërore”¹². Mundësitë e barabarta të grave dhe burrave, përveç se janë të garantuara me Kushtetutë, në të njëjtën kohë siguri i tyre bën pjesë edhe të një numri të madh të ligjeve të cilët ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë¹³ dhe përmbajnë dispozita me të cilat po inkorporohet koncepti gjinor në aktet e brendshme ligjore¹⁴.

Vetëdijësimi mbi nevojën e vendosjes së mundësive të barabarta të grave dhe burrave, si dhe promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të grave në të gjitha fushat e jetës shoqërore, merr formën e organizuar kur Ministria e Punës dhe Politikës Sociale harton **Planin e parë Kombëtar të Veprimit mbi Barazinë Gjinore**, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në dhjetor të vitit 1999. Në dokument janë identifikuar objektivat dhe masat me realizimin e të cilave do të kishte patur ndikim mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gruas në të gjitha fushat e jetës shoqërore, si dhe mbi vetëdijësimin e vazhdueshëm për nevojën për veprim në drejtim të vendosjes së barazisë së grave dhe burrave. Ai përfshin dhjetë fusha strategjike të jetës shoqërore brenda të të cilave duhet të avancohet barazia gjinore, në mesin e të cilave dhe push-teti dhe vendimjellja, dhuna mbi gratë, tregtia me gra, shëndetësia, të drejtat e njeriut dhe aktivitetet paqësore. Implementimi i Planit Kombëtar të Veprimit, kishte treguar për pengesat ekzistuese të cilat kishin pamundësuar zbatimin e plotë të vetë planit, në mesin e të cilave dhe mospasja e kornizës precize kohore, si dhe të buxhetit të caktuar për realizimin e aktiviteteve të parashikuara.

Në vitin 2006, për herë të parë në Republikën e Maqedonisë është sjell **Ligji i parë mbi Mundësitë e Barabarta të Grave dhe Burrave**. “Me këtë Ligj rregullohen masat elementare dhe të posaçme për vendosjen e mundësive të barabarta të grave dhe burrave, kompetencat, detyrat dhe obligimet e subjekteve përgjegjëse për siguri të mundësive të barabarta, procedura për përcaktimin e trajtimit të jobarabartë të grave dhe burrave, të drejtat dhe obligimet e Përfaqësuesit të Mundësive të Barabarta të Grave dhe Burrave (më tej në tekst referuar si: Përfaqësuesi), si person i përcaktuar për zbatimin e procedurës së caktimit të trajtimit të pabarabartë të grave dhe burrave, si dhe të drejtat dhe obligimet e subjekteve që marrin pjesë në atë procedurë”¹⁵. Qëllimi i Ligjit

*Pjesa e arritjeve formalo-juridike në vendosjen e barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë, me përjashtim të analizës së Ligjit mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, është marrë nga disertacioni i doktoratës së D-r Dijana Stojanoviç Gjorgjeviç, “Integrimi i aspektit gjinor në politikë si një nga kushtet e vendosjes së barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë”, Instituti Universiteti Kirili dhe Metodi, Instituti i Kërkimeve Sociologjike dhe Politiko-Juridike, Shkup, 2014

12 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 52/91 e 22.11.1991 <http://www.sobranie.mk/default.asp?ItemID=A431BEE83F63594B8FE11DA66C97BEAF>, e qasur më 24.09.2017

13 Gjinia në legjislacionin pozitiv maqedonas shfaqet si bazë e ndaluar për diskriminim direkt dhe indirekt

14 Kodi Penal; Ligji mbi Zbatimin e Sanksioneve; Ligji mbi Arsimin e Mesëm; Ligji mbi Arsimin e Lartë; Ligji mbi Shoqatat e Qytetarëve dhe Fondacionet; Ligji mbi Partitë Politike; Ligji mbi Punët e Brendshme; Ligji mbi Zgjedhjet Lokale; Ligji mbi Trashëgimin; Ligji mbi Familjen; Ligji mbi Kulturën; Ligji mbi Veprimtarinë Radiodifuzive.

15 Ligji i Mundësive të Barabarta të Grave dhe Burrave, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 66/06 e 29.5.2006, <http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/ZEM.pdf>, qasur më 24.09.2017

është që ta promovojë parimin e vendosjes së mundësive të barabarta të grave dhe burrave në fushën politike, ekonomike, sociale, arsimore, si dhe në fushat tjera të jetës shoqërore, gjegjësisht, të ndikojë në mënjanimin e pengesave ekzistuese për vendosjen e këtij parimi. “Ligji trajton aspektin e parandalimit të trajtimit të pabarabartë midis grave dhe burrave dhe krijimin e kushteve të vendosjes së pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës shoqërore, para së gjithash, në fushën politike, ekonomike, arsimore, sociale dhe të tjera dhe gjithashtu trajton dhe aspektin e mënjanimin të sjelljes që tanimë ka mund të kishte ndodhur diskriminatore”¹⁶. Ligji ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë në disa sektorë dhe andaj në mënyrë precize përcakton nocionin e diskriminimit në Nenin 4, si “çdo bërje e dallimit, shfrytëzimit ose kufizimit në bazë të gjinisë, e cila rrezikon ose pamundëson realizimin ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat, në fushat e punësimit dhe punës, arsimit, sigurisë sociale, kulturës dhe sportit”¹⁷. Në pajtim me këtë Ligj, mungesa e cilësdo forme të diskriminimit konsiderohet për sigurim të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave, që është një përcaktim tepër i ngushtë i trajtimit të barabartë dhe është e vështirë që ai të mund të çojë drejt vendosjes së barazisë gjinore në praktikë. Në këtë periudhë u miratua dhe **Plani i dytë i Veprimit mbi Barazinë Gjinore** për periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2012. Vitet pasuese u janë përkushtuar zbatimit të Ligjit të Mundësive të Barabarta dhe themelemit të mekanizmave në nivelin kombëtar dhe lokal, me qëllim avancimi i mundësive të barabarta të grave dhe burrave.

Në vitin 2012 është sjellë dhe **Ligji aktual i Mundësive të Barabarta midis Grave dhe Burrave**. Ajo që qysh nga fillimi i këtij Ligji është akoma e re, në pajtim me Ligjin e vjetër, është vënia theks në vendosjen e mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të grave dhe burrave si lëndë e Ligjit. Përvojat dëshmuar se Ligji i vitit 2006 në mënyrë pamjaftueshëm precize përcaktonte vendosjen e mundësive të barabarta. Kështu, në Nenin 1, paragrafin 2 të Ligjit të Mundësive të Barabarta të vitit 2012, lexon “vendosja e mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave rregullohet me këtë dhe me një ligj tjetër, me të cilin rregullohen çështjet me interes për mundësitë e barabarta të grave dhe burrave nga fusha e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor, mbrojtjes sociale, qasjes në mallra dhe shërbime, ekonomi, marrëdhëniet e punës dhe punësimit, në arsim dhe avancim profesionist, në marrëdhëniet ekonomike dhe pronësore, në shfrytëzimin e produkteve dhe shërbimeve publike (të drejtat e konsumatorit), në kulturë dhe sport, në teknologjitë e informatikës dhe komunikimit, në mbrojtje dhe siguri, në jurisprudencë dhe administratë, në banim, në informim publik dhe media, në administratën shtetërore dhe publike, si dhe fusha tjera të jetesës shoqërore”¹⁸. Ajo që ligjvënasi në vitin 2006 kishte përcaktuar si obligim për tërë shoqërinë (vendosjen e mundësive të barabarta), në vitin 2012 është ndryshuar në përkujdesje e tërë shoqërisë, gjegjësisht, e gjithë subjekteve të sektorit publik dhe privat. Një kre të posaçëm të këtij Ligji i është përkushtuar dhe aplikimit të Ligjit, ndërsa ato që janë shënuar si “subjekte që vendosin mundësitë e barabarta dhe trajtimin e barabartë të grave dhe burrave janë: organet e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe organet dhe organizatat tjera në sektorin publik dhe privat, ndërmarrjet publike, partitë politike, mjetet e informimit publik dhe sektori civil, si dhe gjithë personat që sigurojnë mallra dhe shërbime që janë të disponueshme për publikun dhe të cilat ofrohen jashtë zonës së jetës private dhe familjare dhe transaksionet

16 Analiza e shkallës së zbatimit të Ligjit të Mundësive të Barabarta të Grave dhe Burrave, Shkup, qershor, 2011, fq. 3, http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/analiza_zem.pdf, qasur më 24.09.2017

17 Ligji i Mundësive të Barabarta të Grave dhe Burrave, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 66/06 e 29.5.2006, <http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/ZEM.pdf>, qasur më 24.09.2017

18 Ligji i Mundësive të Barabarta të Grave dhe Burrave, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 6/2012 e 13.1.2012, http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/zem_2012.pdf, qasur më 24.09.2017

që kryhen në këtë kontekst pavarësisht nëse personi në fjalë i takon sektorit publik, apo atij privat”¹⁹ (Neni 3 paragrafi 2). Në Ligj në mënyrë të detajuar dhe të zgjeruar janë shënuar fushat në të cilat ndalohet diskriminimi, shqetësimi dhe shqetësimi seksual në bazë të gjinisë. Në pajtim me Ligjin dhe parimin e trajtimit të barabartë, çdo qytetar gëzon të drejtën e punësimit pa asçfarë kufizimesh, e sidomos “... diskriminimi është i ndaluar edhe në bazë të statusit martesor, statusit familjar, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, bindjes politike dhe tjetër, aktivitetit në sindikatat, përkatësisë kombëtare ose statusit social, aftësisë së kufizuar, moshës, pronësisë, statusit shoqëror apo ndonjë statusit tjetër”²⁰ (Neni 3 paragrafi 6).

Në mesin e përkufizimeve të precizuara në këtë Ligj, është dhe definimi i diskriminimit në bazë të gjinisë dhe ajo paraqet “çdo bërje dallim, çdo përjashtim ose kufizim në bazë të gjinisë, që ka si pasojë ose qëllim ta rrezikojë ose pamundësojë pranimin, realizimin, ose praktikimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore në bazë të barazisë së grave dhe burrave në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe civile ose në bazë të ndonjë fushe tjetër, pavarësisht nga raca e tyre, ngjyra e lëkurës, gjinia, përkasja një grupi të marginalizuar, përkasja etnike, gjuha, shtetësia, origjina sociale, feja ose bindja fetare, arsimi, përkatësia politike, statusi personal ose shoqëror, aftësia e kufizuar mendore dhe trupore, moshja, gjendja familjare ose martesore, statusi pronësor, gjendja shëndetësore ose në cilëndo bazë tjetër”²¹ (Neni 4). Gjithashtu, në pajtim me po të njëjtin Nen, ekziston dhe dallimi në përkufizimin e nocioneve të diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, dhe kështu, “si diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të gjinisë konsiderohet në rastet kur një person është trajtuar, po trajtohet ose do të ishte trajtuar më keq në bazë të gjinisë, sesa një person tjetër në situatë të ngjashme”²², ndërsa “si diskriminim i tërthortë në bazë të gjinisë është kur një dispozitë që duket neutrale në shikim të parë, ose kriter ose e drejtë zakonore vendos personat e një gjinie në gjendje më të pafavorshme, në krahasim me persona të gjinisë tjetër, përveçse nëse ajo dispozitë, kriter ose e drejtë zakonore është objektivisht e arsyetuar me një qëllim legjitim, ndërsa mjetet për arritjen e atij qëllimi janë përkatëse dhe të domosdoshme”²³. Në Nenin 4 të këtij Ligji janë dhënë disa përkufizime të reja, siç janë: “barazia e plotë e grave dhe burrave paraqesin të drejtat, mundësitë, kushtet dhe trajtimi i barabartë në të gjitha fushat e jetës publike dhe private dhe mungesa e kushteve kulturore, sociale, ekonomike dhe politike, që prodhojnë marrëdhënie të pabarabarta të fuqisë dhe ndarje të pabarabartë të mallrave shoqërore midis grave dhe burrave. Përfaqësim i barabartë është çdo përfaqësim procentual i një gjinie, i cili nuk është më i ulët se përqindja e përfaqësimit të asaj gjinie në popullsinë e përgjithshme. Inkuadrimi i perspektivave gjinore në rrjedhat kryesore të integritimit të perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit të ndërtimit, sjelljes, zbatimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të politikave – duke patur parasysh promovimin dhe avancimin e barazisë midis grave dhe burrave”²⁴. Ky Ligj njuh konceptin e *gender mainstreaming* (integrim gjinor), si vegël e nevojitur për promovim dhe avancim të barazisë në Republikën e Maqedonisë, si dhe strategjinë e vendosjes së barazisë gjinore në shoqërinë tonë, andaj ai dhe në mënyrë precize përkufizon atë.

Llojet e masave të vendosjes së mundësive të barabarta të grave dhe burrave janë përpunuar hollësisht në këtë Ligj. Kështu, fushat për të cilat nevojitet ndërmarrja e masave elementare normative për realizimin e parimit të mundësive të barabarta, janë

19 Njëjtë

20 Njëjtë

21 Njëjtë

22 Njëjtë

23 Njëjtë

24 Njëjtë

numëruar veçmas, ndërsa vetë masat janë përkufizuar edhe si "... masat për realizimin e barazisë së plotë midis grave dhe burrave, të përcaktuara me politikat dhe programet e promovimit sistematik të promovimit të parimit të mundësive të barabarta të grave dhe burrave dhe respektimit të dallimeve, për ndryshim të zakoneve shoqërore dhe kulturore në kuptimin e sjelljes së grave dhe burrave për mënjanim të paragjyqimeve, si dhe çdo praktikë tjetër të bazuar mbi inferioritetin ose superioritetin e njëjës apo tjetrës gjini ose në bazë të rolit shoqëror tradicional të burrave ose të grave"²⁵ (Neni 5 paragrafi 2). Këtu biejnë edhe masat që nënkuptojnë përfshirjen sistematike edhe të burrave edhe të grave në procesin e krijimit, zbatimit dhe vëzhgimit të politikave dhe buxheteve në fushat e posaçme shoqërore. Në pjesën e masave themelore janë vendosur edhe ato masa të cilat në pajtim me këtë Ligj duhet të ndërmerren në arsimin dhe avancimin profesionist, për të mënjanuar paragjykimet dhe stereotipet gjinore në planet mësimore, librat e mësimin dhe programet e arsimit, dhe ato duhet qenë rezultat i analizave të rregullta të përmbajtjeve të tyre. Si masa të posaçme të parashikuara me këtë Ligj konsiderohen "...masat e përkohshme që ndërmerren me qëllim tejkalimi i gjendjes ekzistuese jo të favorshme shoqërore të grave dhe burrave, e cila është rezultat i diskriminimit sistematik ose i pabarazisë gjinore strukturore, e cila buron nga rrethanat historike dhe socio-kulturore"²⁶ (Neni 7 paragrafi 1). Këto masa të posaçme duhet të mundësojnë "... pozita të barabarta fillestare të grave dhe burrave, trajtim të barabartë, pjesëmarrje të balancuar ose status të barabartë shoqëror, zhvillim të potencialeve të tyre individuale, nëpërmjet të cilave ato kontribuojnë për zhvillim shoqëror dhe shfrytëzimin e barabartë të përfitimeve të zhvillimit në fjalë"²⁷ (Neni 7 paragrafi 2). Ligji ofron edhe përkufizime më të ndryshme të një pjese të masave të posaçme, andaj "masat pozitive paraqesin masa me të cilat nën kushtet e barabarta, u jepet përparësi pjesëtarëve të gjinisë më pak të përfaqësuar, përderisa nuk arrihet përfaqësimi i barabartë ose nuk arrihet qëllimi për të cilin janë ndërmarrë ato"²⁸ (Neni 7 paragrafi 3).

Subjektet përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e masave për vendosje të mundësive të barabarta të grave dhe burrave, si dhe obligimet e tyre janë përcaktuar mjaft gjerësisht dhe përpikërisht me këtë Ligj. Kështu, në pajtim me Nenin 9 paragrafin 1 të Ligjit "Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në kuadrin e kompetencave të tyre kujdeset për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit në bazë të gjinisë dhe për përmirësimin e statusit shoqëror të grave; integron parimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave në iniciativat ligjore, në politikat dhe programet; organizon debate dhe shqyrtime publike të çështjeve nga fusha e mundësive të barabarta të grave dhe burrave; analizon dhe jep mendime mbi efektin e dispozitave ligjore mbi statusin e grave dhe burrave, kërkon raporte dhe dokumentacion nga institucionet kompetente për sa i përket fushëveprimit dhe përgatit dhe shpall raporte mbi punën e vet"²⁹. Kuvendi, në pajtim me këtë Ligj është ngarkuar me detyrë të sjell Strategjinë e Barazisë Gjinore, si dhe ta vëzhgojë zbatimin e saj, përderisa për propozimin e saj është ngarkuar me detyrë Qeveria e Republikës së Maqedonisë, e cila poashtu ka kompetencë për të emërtuar "... koordinatorin dhe zëvendës-koordinatorin e mundësive të barabarta dhe ta ndjek zbatimin e parimit të mundësive të barabarta të grave dhe burrave në planet strategjike të ministrive të dikasterit dhe në buxhetet, të cilat bashkëpunojnë me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale"³⁰ (Neni 10 paragrafi 3). Qeveria poashtu ka obligim të shpall të dhëna statistikore mbi përfaqësimin e grave dhe burrave në funksionet dhe organet e

25 Njëjtë
 26 Njëjtë
 27 Njëjtë
 28 Njëjtë
 29 Njëjtë
 30 Njëjtë

numëruara të vendimsjelljes, drejtimit dhe udhëheqjes. Një risi tjetër të cilën parashikon ky Ligj, si obligim të Qeverisë, është formimi i një grupi ndër-dikasterial këshillues dhe këshilldhënës për mundësitë e barabarta të grave dhe burrave, i cili duhet të përbëhet nga funksionarë/nëpunës shtetërorë udhëheqës, përfaqësues të organizatave qytetare, shoqata të punëdhënësve, ekspertë, përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, sindikatat dhe subjektet tjera, e cila vepron në koordinim me MPPS. Ky grup "... është i obliguar që ta promovojë konceptin e inkuadrimin të aspekteve gjinore në politikat e përgjithshme të të gjithë institucioneve publike; ta ndjek integrimin e konceptit në politikat sektoriale në bashkëpunim me partnerët socialë dhe institucionet nga fushat individuale; ta ndjek progresin dhe harmonizimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit dhe standardet evropiane në fushën e çështjeve gjinore; të merr pjesë në përgatitjen dhe të jep drejtime në procesin e përgatitjes së Strategjisë së Barazisë Gjinore; dhe t'i ndjek raportet periodike nga institucionet"³¹ (Neni 10 paragrafi 8).

Organet e administratës shtetërore në pajtim me këtë ligj kanë kompetenca saktësisht të definuara, gjegjësisht, ata janë të obliguar të punojnë në drejtim të promovimit dhe avancimit të mundësive të barabarta, nëpërmjet të marrjes së masave themelore dhe të posaçme. "Organet e administratës shtetërore janë të obliguara që në kuadrin e planeve të tyre strategjike dhe buxheteve, ta inkorporojnë parimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave; t'i ndjekin efektet dhe ndikimin e programeve të tyre mbi gratë dhe burrat, si dhe të raportojnë në kuadër të raporteve të veta vjetore"³² (Neni 11 paragrafi 3). Gjithashtu, ky Ligj obligon Koordinatorin e Mundësive të Barabarta të jep mendime dhe propozime për promovim dhe avancim të mundësive të barabarta në kuadrin e kompetencave të organit shtetëror në fjalë, si dhe ta shpallin në ueb-faqen e organit të administratës shtetërore Planin Vjetor të Punës, të cilin e dërgon edhe në MPPS.

MPPS me këtë ligj ka për detyrë që analizat, raportet dhe dokumentet tjera të hartuara e që kanë të bëjnë me mundësitë e barabarta, t'i shpall në ueb faqen e Ministrisë. Afati i dërgimit të Raportit Vjetor mbi aktivitetet e zbatuara dhe progresin e arritur, i cili duhet t'i dërgohet Qeverisë, sipas Ligjit, është në qershor të secilit vit.

Me Ligjin detyrohen njësitë e vetëqeverisjes lokale të hartojnë Planin Vjetor, me të cilin do të përcaktohen masat themelore dhe të posaçme. "Njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara që në kuadër të planeve të veta strategjike dhe buxheteve, ta inkorporojnë parimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave; t'i ndjekin efektet dhe ndikimet e programeve të tyre mbi gratë dhe burrat, si dhe të raportojnë brenda raporteve të veta vjetore, si dhe të marrin pjesë në hartimin e Strategjisë së Barazisë Gjinore në pjesën që lidhet me njësitë e vetëqeverisjes lokale"³³ (Neni 14 paragrafi 2), dhe në të njëjtën kohë, "organet e njësitë të vetëqeverisjes lokale, gjatë sjelljes së planeve të veta zhvillimore dhe të akteve dhe vendimeve tjera, janë të obliguar t'i shqyrtojnë dhe t'i marrin parasysh masat dhe aktivitetet e propozuara nga Komisioni i Mundësive të Barabarta ndërmjet Grave dhe Burrave dhe të Koordinatorit të Mundësive të Barabarta ndërmjet Grave dhe Burrave"³⁴ (Neni 14 paragrafi 3). Me këtë Nen poashtu parashikohet dhe bashkëpunimi i vetëqeverisjes lokale me shoqatat e punëdhënësve, sindikatën, organizatat joqeveritare aktive në fushën e mundësive të barabarta, e gjithë kjo me qëllim sigurimi i propozimeve dhe masave për avancimin e mundësive të barabarta dhe vendosjen e barazisë gjinore në nivelin lokal.

31 Njëjtë

32 Njëjtë

33 Njëjtë

34 Njëjtë

Në paragrafin 8 të Nenit 14 në mënyrë të detajuar janë precizuar obligimet dhe kompetencat e Koordinatorit të Mundësive të Barabarta në nivelin lokal: “avancimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi në kuadër të kompetencave të njësisë së vetëqeverisjes lokale; jep propozime dhe mendime në lidhje me mundësitë e barabarta në Këshillin e njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe në institucionet dhe organizatat në nivelin lokal; përgatit raporte mbi gjendjen e mundësive të barabarta dhe të mosdiskriminimit në kuadër të njësisë së vetëqeverisjes lokale; bashkëpunon me Komisionin e Mundësive të Barabarta ndërmjet Grave dhe Burrave në kuadër të Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe ngrisin nisma të përbashkëta me qëllim avancimi i mundësive të barabarta dhe i mosdiskriminimit; bashkëpunon me organizatat joqeveritare dhe institucionet tjera në nivelin lokal në lidhje me çështjen e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit, vëzhgon gjendjen e mundësive të barabarta në nivelin lokal dhe propozon nisma për marrje të masave për përmirësimin e mundësive të barabarta dhe të mosdiskriminimit, si dhe në përmbushjen e detyrave të veta po bën koordinimin dhe bashkëpunimin me Ministrinë”³⁵. Koordinator i është i obliguar që të paktën një herë në vit të dërgojë raport mbi punën e vet në MPPS dhe atë ta shpall në ueb faqen e komunës.

Me Nenin 16 të Ligjit rregullohet se “partitë politike në aktet e veta rregullojnë mënyrën dhe masat e avancimit të pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në organet dhe trupat e partisë”³⁶.

Neni 17 i këtij Ligji i cili ka të bëjë me mjetet e informimit publik, obligon “Këshillin e Radiodifuzionit të Republikës së Maqedonisë, në kuadër të kompetencave të veta ta vëzhgojë mënyrën e prezantimit të grave dhe burrave në konceptet dhe përmbajtjet e programit dhe një herë në vit parashtron raport përpara Kuvendit”³⁷ (Neni 17 paragrafi 3). Ky Këshill ka për obligim edhe të zhvillojë analiza vjetore mbi çështjet gjinore në konceptet dhe përmbajtjet e programeve të mjeteve të informimit publik, të cilat poashtu ia parashtron Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, ndërsa për opinionin publik do t’i shpall në ueb faqen e vet.

Në pajtim me këtë Ligj, të gjithë vepruesit janë të obliguar me grumbullimin dhe prezantimin e të dhënave statistikore, të segreguara sipas gjinisë dhe ato duhet të dërgohen edhe deri tek Enti Shtetëror i Statistikave.

Pamundësia për të sjell një Plan Kombëtar të Veprimit për Mundësitë e Barabarta ndërmjet burrave dhe grave përgjatë gjashtë viteve përderisa ishte në fuqi Ligji i vjetër i Mundësive të Barabarta (2006 – 2012), solli ndryshime në formën e këtij dokumenti dhe ai, në pajtim me Ligjin aktual është parashikuar si **Strategji e Barazisë Gjinore**. Kjo Strategji është parashikuar të miratohet për një periudhë tetë-vjeçare dhe në të, përveç të analizës së gjendjes, duhet të përfshihen dhe udhëzimet dhe masat e arritjes së qëllimeve në fushat e ndryshme të jetesës shoqërore; përmbajtja, organet kompetente dhe personat përgjegjës të detyruar për zbatimin e saj; të dhënat e nevojitura të segreguara sipas gjinisë; metodat e vëzhgimit dhe raportimit mbi aplikimin e Strategjisë, mjetet e nevojitura për zbatimin e Strategjisë, si dhe burimet dhe mënyrat e sigurimit të tyre.

Sa i përket mbrojtjes juridike, Ligji parashikon një përfaqësues juridik, i cili së bashku me Avokatin e Popullit, Komisionin e Mbrojtjes nga Diskriminimi, si dhe gjykatën kompetente, janë të obliguar ta mbrojnë të drejtën e trajtimit të barabartë të qytetarëve të Re-

35 Njëjtë

36 Njëjtë

37 Njëjtë

publikës së Maqedonisë, të cilët, në rast të shkeljes së kësaj të drejte, mund para tyre të paraqesin parashtrësë. “Një parashtrësë mund të paraqesë çdo person juridik ose fizik, personalisht ose nëpërmjet të personit të autorizuar, me shkrim, me gojë gjatë procesverbalit, ose në ndonjë formë tjetër, me telefaks ose me postë elektronike”³⁸(Neni 22 paragrafi 1) dhe ajo është falas, ndërsa është obligim i qytetarit ta paraqesë atë brenda afatit gjashtë-mujor nga dita e shkeljes së kësaj të drejte, ose më së voni brenda afatit një-vjeçar. Në qoftë se vetë parashtrësja përmban paqartësi, fakte dhe prova të pamjaftueshme, përfaqësuesi juridik ka për obligim të kërkojë qartësim dhe plotësim nga parashtruesi, dhe në qoftë se përcakton se nuk ka shkelje të së drejtës, në qoftë se afati i paraqitjes ka skaduar, në qoftë se parashtrësja është anonime, ose në qoftë se tanimë është ngritur një procedurë përpara gjykatës kompetente ose është sjell një aktvendim i prerë, atëherë përfaqësuesi juridik nuk ngrit procedurë dhe për këtë informon parashtruesin brenda 15 ditëve. Nën kompetencën e përfaqësuesit juridik është përcaktimi i gjendjes faktike, me marrje të deklaratave nga gjithë palët e përfshira në këtë rast, ndërsa në rast të ngritjes së procedurës, parashtrësja e paraqitur i dërgohet edhe personit kundër të cilët është ngritur, që të mund të deklarohet në lidhje me pretendimet e saja. Personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar që me kërkesë të përfaqësuesit juridik, t’i dorëzojnë të dhënat që kanë në dispozicion për raste konkrete të diskriminimit, si dhe të lejojnë bërjen e inspektimit të menjëhershëm brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës³⁹ (Neni 27). Në bazë të tërë dokumentacionit të grumbulluar, përfaqësuesi juridik përgatit mendimin e vet për (mos)ekzistimin e trajtimit të pabarabartë në bazë të gjinisë dhe jep rekomandimin e vet, në qoftë se ai ekziston, në cilën mënyrë nevojitet të bëhet mënjanimi i tij. Ky mendim, përveçse u dërgohet personave të përfshirë në tërë procedurën, i dërgohet edhe MPPS, ndërsa “personi të cilit i përket rekomandimi, është i obliguar të veprojë sipas tij dhe ta mënjanojë shkeljen e së drejtës brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të mendimit dhe për këtë duhet ta informojë përfaqësuesin juridik”⁴⁰. Në qoftë se kjo nuk ndodh dhe personi nuk vepron sipas rekomandimit të përfaqësuesit juridik, ai gëzon të drejtën e ngritjes së procedurës përpara një gjykate kompetente. Përfaqësuesi juridik poashtu, në pajtim me këtë Ligj, ka për obligim të përpilojë raporte vjetore të cilët përmbajnë punën e tij të përgjithshme dhe ato raporte ua dërgon institucioneve kompetente dhe MPPS-së, ku dhe bëhet shpallja në ueb faqen e tyre.

Një progres i rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e mundësive të barabarta, nëpërmjet një qasjeje më komplekse ndaj këtyre çështjeve është bërë plotësueshëm edhe me sjelljen e **Ligjit mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi**, i cili Paraqet një formë juridike e rrumbullakësuar për mbrojtje nga diskriminimi në baza të ndryshme. Ligji ka për obligim të sigurojë masa dhe aktivitete për parandalimin e diskriminimit, por megjithatë, njëkohësisht vendos mekanizma dhe mjete përkatëse për mbrojtje juridike në rast të diskriminimit në baza të ndryshme. Andaj, ky Ligj paraqet një instrument posaçërisht të rëndësishëm në luftimin e diskriminimit të dyfishtë dhe të shumëfishtë, me të cilin po përballen posaçërisht gratë, si rezultat i kryqëzimit të gjinisë me identitetet tjera.⁴¹

38 Njëjtë

39 Njëjtë

40 Njëjtë

41 Neni 3 i Ligjit të Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Diskriminimi përcakton se: “Ndalohet çdo diskriminim i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, thirrje për dhe nxitje të diskriminimit dhe ndihmimi në veprimin diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkasjes një grupi të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, origjinës sociale, fesë dhe bindjes fetare, llojeve tjera të bindjeve, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal dhe shoqëror, aftësisë së kufizuar mendor dhe trupor, moshës, gjendjes familjare statusit pronësor, gjendjes shëndetësore ose në cilëndo bazë tjetër e cila është përcaktuar me ligj ose me ndonjë marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare (baza diskriminatore).”

Në kontekstin e fuqizimit ekonomik të grave dhe reduktimit të varfërisë dhe shkallës së lartë të papunësisë tek popullsia femërore, me rëndësi janë dispozitat e inkuadruara në **Ligjin e Marrëdhënëve të Punës**. Ky Ligj urdhëron se punëdhënësi nuk guxon kërkuesin e punës ose punëtorin ta vëjë në pozitë të pabarabartë në bazë të disa kriterëve, në mesin e të cilëve është dhe gjinia e tij. Njëkohësisht, Neni 6 paragrafi 2 përcakton se “grave dhe burrave patjetër duhet t’u sigurohen mundësitë e barabarta dhe trajtimi i barabartë në lidhje me: 1) qasjen në punësim, duke përfshirë këtu avancimin dhe trajnimin profesional në punë; 2) kushtet e punës; 3) pagimin e barabartë për punën e barabartë; 4) skemat profesionale të sigurimit shëndetësor; 5) mungesën nga puna; 6) orarin e punës dhe 7) pezullimin e kontratës së punës”⁴². Me një krye të posaçme në këtë Ligj përcaktohet se patjetër duhet ekzistuar barazia gjinore gjatë shpalljes së vendeve të lira të punës, gjegjësisht, “punëdhënësi nuk guxon që vendin e lirë të punës ta shpall vetëm për burra apo vetëm për gra, përveç nëse gjinia e caktuar paraqet një kusht të domosdoshëm për kryerjen e punës” (Neni 24 paragrafi 1) dhe “shpallja e vendit të lirë të punës nuk guxon të sugjerojë se punëdhënësi në punësim i jep përparësi një gjinie të posaçme, përveç me përjashtimin nga paragrafi (1) të këtij Neni” (Neni 24 paragrafi 2)⁴³. Mbrojtja e grave në periudhën e riprodhimit, të cilën rregullon ky Ligj ka të bëjë me ndalesën e lëshimit nga puna për arsye të shtatzënisë, lindjes dhe prindërisë, apo në pajtim me Nenin 101 paragrafin 1 “punëdhënësi nuk guxon ta pezullojë kontratën e punësimit të punëtores përgjatë shtatzënisë, lindjes dhe prindërisë dhe mungesës për shkak të përkujdesjes dhe ruajtjes së fëmijëve”⁴⁴. Sigurimi i kushteve të barabarta nënkupton edhe pagim të barabartë pavarësisht nga gjinia, dhe kështu, Neni 108 paragrafi 1 rregullon se “punëdhënësi është i obliguar që për punën e njëjtë me kërkesat e njëjta të vendit të punës, t’u paguajë rrogë të barabartë punëtorëve, pavarësisht nga gjinia”⁴⁵. Në këtë mënyrë dhe me respektimin e kësaj dispozite, në masë të madhe do të kishte mundur të zvogëlohej boshllëku gjinor në rrogat në Republikën e Maqedonisë. Ky Ligj ndalon kryerjen e punës më gjatë se orari i punës dhe në mënyrë të prerë ndalon punëdhënësin që të urdhëroj orar më të gjatë pune: “punëtores grua, në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, për shkak të mbrojtjes së shtatzënisë, lindjes dhe prindërisë; nënës me fëmijë deri në moshën tre-vjeç dhe prindit të vetëm të fëmijës deri në moshën gjashtë-vjeç, përveç nëse punëtori jep deklaratë me shkrim se vullnetarisht pajtohet me punë jashtë orarit”⁴⁶ (Neni 120 paragrafet 2 dhe 3). Gruaja, konform këtij Ligji, është e mbrojtur në periudhën e riprodhimit, dhe kështu “punëtorët për shkak të shtatzënisë dhe prindërisë kanë të drejtë për mbrojtje të posaçme në kuadër të marrëdhënies së punës” (Neni 161 paragrafi 1), gjegjësisht, “punëdhënësi është i obliguar që punëtorëve t’u mundësojë harmonizim më të lehtë të obligimeve familjare dhe atyre profesionale”⁴⁷ (Neni 161 paragrafi 2). Gjithashtu, një lloj të caktuar të mbrojtjes merr gruaja gjatë shtatzënisë, si dhe pas lindjes dhe kështu, “gjatë shtatzënisë dhe një vit pas lindjes, punëtorja nuk guxon të zbatojë aktivitete, në qoftë se ato, me rrezik të shktuar, ndikojnë shëndetin e saj ose shëndetin e fëmijës”⁴⁸ (Neni 162 paragrafi 1). Në pjesën e posaçme të përkushtuar mbrojtjes së posaçme gjatë shtatzënisë, rregullohet se “punëdhënësi nuk guxon të kërkojë asçfarë të dhënash mbi shtatzëninë e punëtores, përveç nëse ajo vet nuk i dorëzon për arsye të realizimit të së drejtave përgjatë shtatzënisë” (Neni 163 paragrafi 1), dhe njëkohësisht, “në qoftë se punëtorja kryen

42 Ligji i Marrëdhënëve të Punës, “Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 74/15, <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/ZRO%20Precisten%2074-15.pdf>, qasur më 07.11.2017

43 Njëjtë

44 Njëjtë

45 Njëjtë

46 Njëjtë

47 Njëjtë

48 Njëjtë

punë e cila gjatë shtatzënisë së saj mund të ketë efekt të dëmshëm për shëndetin e saj ose shëndetin e fëmijës, atëherë punëdhënësi është i detyruar t'i sigurojë kryerje të një pune dhe rroge tjetër përkatëse, sikur ajo ta kishte kryer punën e vet, në qoftë se kjo gjë është më e favorshme për të"⁴⁹ (Neni 163 paragrafi 2). Gruaja gjatë shtatzënisë dhe prindërisë, konform këtij Ligji, duhet qenë e mbrojtur nga puna e natës dhe puna jashtë orarit, dhe ajo është e ndaluar në mënyrë të prerë gjatë shtatzënisë, ose tek nënat me fëmijë në moshë deri një-vjeç. "Punëtores e cila ka fëmijë në moshë nga një deri tre vjeç, mund t'i urdhërohet të bëjë punë jashtë orarit ose punë nate vetëm në bazë të pëlqimit të saj paraprak me shkrim"⁵⁰ (Neni 164 paragrafi 2). Kjo e drejtë i transmetohet babait të fëmijës në qoftë se nëna e fëmijës është shpallur e paaftë që vet të përkujdeset për fëmijën, në qoftë se ka braktisur fëmijën ose ka vdekur. Njëra nga dispozitat më të rëndësishme të këtij Ligji, për gratë në periudhën e riprodhimit, është rregullimi i mungesës nga puna për shkak të lindjes. Neni 165 paragrafi 1 përcakton se "punëtorja gjatë shtatzënisë, lindjes dhe prindërisë, gëzon të drejtën e mungesës së paguar nga puna, përgjatë nëntë muajve pandërprerë, dhe në qoftë se ajo lind më tepër fëmijë përnjëherë (bineq, tre ose më tepër fëmijë) – për 15 muaj"⁵¹. Neni 171 mbron nënën gjdhënëse, duke përcaktuar se "punëtorja i jep gji fëmijës edhe pas skadimit të mungesës nga puna për arsye të shtatzënisë, lindjes dhe prindërisë, do të fillojë të punojë me orar të plotë pune, ka të drejtë për pauzë të paguar gjatë orarit të punës, në kohëzgjatje nga një orë e gjysëm në ditë, brenda të cilës kohë llogaritet dhe pauza ditore. Këtë të drejtë gëzon punëtorja fëmija e së cilës është në moshë deri një-vjeç"⁵². Duke ndaluar pabarazinë gjinore, Ligji i Marrëdhënieve të Punës po angazhohet për sigurimin e mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë në fushën e marrëdhënieve të punës, si dhe sigurimin e kushteve të barabarta dhe pagimit të barabartë, pavarësisht nga gjinia dhe gjithashtu, në masë të madhe dhe në mënyra të ndryshme, mbron gruan gjatë periudhës së riprodhimit, dhe i mundëson asaj të drejtat formalisht të garantuara.

Ligji i Pengimit, Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Dhuna në Familje⁵³ është kthyer drejt respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, jetës, integritetit personal, mosdiskriminimit dhe vendosjes së barazisë gjinore. Ky Ligj rregullon përgjegjësinë e institucioneve dhe shoqatave, koordinimin dhe bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë, për të penguar dhe parandaluar dhunën në familje, si dhe për të siguruar mbrojtjen e viktimave. Në pajtim me Ligjin, është formuar një Trup Koordinues Kombëtar kundër Dhunës në Familje, në përbërje të institucioneve kompetente (MPPS, MD, MB, MPB, MASH), deputetë të Kuvendit të RM-së, përfaqësues të sistemit jurisprudent, të Avokatit të Popullit, si dhe të organizatave qytetare.

Sipas Ligjit të Pengimit, Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Dhuna në Familje, me dhunë në familje nënkuptojmë keqtrajtimin, fyerjen, rrezikimin e sigurisë, lëndimin trupor, dhunën gjinore ose tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike, e cila shkakton pasiguri, rrezikim ose frikë, duke përfshirë këtu dhe kërcënimet për veprimet e tilla, ndaj bashkëshortit/bashkëshortes, prindërve ose fëmijëve, ose ndaj personave tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtë-martesorë ose në amvisëri të përbashkët, si dhe ndaj bashkëshortit/bashkëshortes, partnerit jashtë-martesorë ose ndaj personave që kanë fëmijë të përbashkët ose janë në marrëdhënie të afërta personale, pavarësisht nëse kryerësi ndan apo ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën, ose jo⁵⁴.

49 Njëjtë

50 Njëjtë

51 Njëjtë

52 Njëjtë

53 Ligji i Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Dhuna në Familje, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 138/14

54 <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/Zakon%20za%20prevencija%20semejno.pdf>

Organe kompetente për pengimin dhe parandalimin e dhunës në familje janë Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Drejtësisë, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet që kryejnë veprimtari nga fusha e mbrojtjes sociale, e mbrojtjes së fëmijëve, e punëve të brendshme, e shëndetësisë, e punësimit dhe arsimit, dhe kanë për detyrë të ndërmarrin masa të mbrojtjes së viktimës dhe parandalimit të dhunës, si dhe të realizojnë bashkëpunim dhe koordinim të ndërsjellë.

Viktima ka të drejtë për ndihmë, mbështetje dhe mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe të informohet nga personat zyrtarë mbi të drejtat e veta, masat e mbrojtjes dhe procedurat e realizimit të tyre, si dhe të shërbimeve në dispozicion për ndihmë dhe mbrojtje.

Qendra e Punës Sociale po ndërmerr masat për mbrojtjen e viktimave, si vijon:

- 1) sistemim në Qendër për persona – viktima të dhunës në familje;
- 2) mbrojtje shëndetësore përkatëse;
- 3) intervencë adekuate psiko-sociale dhe trajtim;
- 4) trajtim psiko-social në këshillimore;
- 5) ndihmim i familjes në shkollimin e rregullt të fëmijës;
- 6) ndihmesë juridike dhe përfaqësim, dhe
- 7) fuqizim ekonomik të viktimës nëpërmjet të inkuadrimit të saj aktiv në tregun e punës.

Në rastet kur ekziston njohuria për rrezikimin e jetës dhe shëndetit të viktimës dhe të anëtarëve të familjes, si dhe në rastet kur një fëmijë është viktimë e dhunës në familje, atëherë hartohet një plan sigurie për ndihmë nga një ekipi profesionist multisektorial, i cili është përbërë nga profesionistë të Qendrës së Punës Sociale, policisë dhe një institucioni shëndetësor nga zona nën përgjegjësinë e Qendrës. Në punën e ekipit profesionist multisektorial marrin pjesë përfaqësues të shoqatave që veprojnë në fushën e dhunës në familje, të cilët mund të propozojnë dhe të zbatojnë masa dhe aktivitete që dalin nga plani i sigurisë për ndihmim të viktimës. Ndihmën juridike sigurojnë profesionistët e Qendrës së Punës Sociale dhe të shoqatave. Të drejtën e ndihmës falas juridike viktima realizon konform Ligjit të Ndhmës Falas Juridike⁵⁵. Qendra e Punës Sociale poashtu ndihmon viktimën në realizimin e së drejtës së mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, që është në pajtim me Ligjin.

Si mbrojtje plotësuese nga abuzimi i postit nga personat zyrtarë, është bërë dhe një ndryshim plotësues i Ligjit, në bazë të të cilit Qendra e Punës Sociale, çdoherë kur merr njohuri se dhuna në familje është kryer nga një person që posedon armë zjarri, menjëherë informon atë, e më së voni brenda 24 orëve dërgon edhe raport me shkrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe në institucionin ose subjektin juridik ku është punësuar personi.

Zyrtari i Policisë, çdoherë kur pranon denoncim mbi dhunën në familje, është i detyruar të del në vendin e ngjarjes dhe të përpilojë raport policor menjëherë, e më së voni brenda 12 orëve nga intervenca në ngjarje, si dhe ta informojë Qendrën kompetente të Punës Sociale.

55 Ligji i Ndhmës Falas Juridike – teksti i konsoliduar, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 161/09 dhe 185/11, i disponueshëm në: <http://pravda.gov.mk/documents>

Gjithashtu, Ligji parashikon që këqyrjet mjekësore dhe trajtimet tjera mjekësore të jenë falas për viktimën, të cilës në të njëjtën kohë duhet t'i lëshohet dokumentacioni mjekësor përkatës për lëndimin e konstatuar.

Ligji parasheh dhe lloj të ndryshëm të masave të përkohshme të mbrojtjes: largimin e kryerësin nga shtëpia dhe ndalesa për t'iu afruar shtëpisë shqiptohet për një afat nga të paktën 10 e më së shumti 30 ditë; ndalesa për t'u kërcënuar se do të kryejë dhunë në familje; ndalesë për të keqtrajtuar, telefonuar, kontaktuar ose për të komunikuar në çfarëdo mënyre tjetër me ndonjë anëtarë të familjes, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi; ndalesë për t'u afruar në distancë që është më e vogël se 100 metra afër vendbanimit, shkollës, vendit të punës ose vendit të caktuar të cilin rregullisht viziton ndonjë anëtar tjetër i familjes; largim nga shtëpia pavarësisht nga pronësia, ndalesë për posedimin e armës së zjarrit ose armës tjetër dhe e njëjta duhet t'i konfiskohet; detyrimisht duhet t'i kthejë sendet që nevojiten për përmbushjen e nevojave të përditshme të familjes; mbajtje të detyrueshme ligjore të familjes; vizitë të detyrueshme të këshillimores përkatëse; mjekim të detyrueshëm të kryerësit, në qoftë se abuzon alkool, drogë dhe substanca tjera psikotropike ose në qoftë se ka sëmundje psikike; është i detyruar t'i kompensojë shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet tjera të shkaktuara nga dhuna në familje dhe shqiptimi i cilësdo mase të cilën gjykata konsideron si të domosdoshme për të mundësuar siguri dhe mirëqenie për anëtarët tjerë të familjes.

Arsimi

Arsimi paraqet një faktor të rëndësishëm i cili kontribuon për shoqërinë ku gjinitë do të jenë të barabarta, të bazuar mbi mundësitë e barabarta dhe normave dhe praktikave të balancuara për nga gjinia. Është ky njëri nga instrumentet me ndihmën e të cilëve njerëzit mund të bëhen më të vetëdijshëm për pozitën vetjake në shoqëri, si dhe për të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga legjislacioni shtetëror. Mësuarja e informacioneve të caktuara lidhur me çështjet gjinore mund të ndikojë ndryshimin e jetave të tyre, dhe në të njëjtën kohë paraqet dhe hapin fillestar për eliminimin e pabarazisë gjinore.

Në pajtim me Nenin 5 të Ligjit të Arsimit Fillor: “prindi, apo kujdestari i nxënësit është i obliguar t’i mundësojë fëmijës së vet përmbushjen e obligimit për arsim dhe edukim të detyrueshëm fillor”⁵⁶. Po i njëjti Ligj, me Nenin 172 parashikon kundërvajtje me gjoba për prindin e nxënësit, në qoftë se nuk përmbush obligimet e regjistrimit dhe ndjekjes së rregullt të mësimit, si vijon: (4) gjobë në lartësi nga 60 deri 80 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje prindit apo kujdestarit, në qoftë se nxënësi nuk është regjistruar brenda afatit të përcaktuar me Nenin 47 paragrafin (1) të këtij Ligji; (5) Gjobë në lartësi nga 80 deri 100 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet prindit apo kujdestarit për kundërvajtje në qoftë se nuk paraqitet brenda afatit të caktuar për këshillim në vijim të ftesës së dytë të dërguar (Neni 64-a paragrafi (2)); (6) Gjobë në lartësi nga 200 deri 280 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet prindit apo kujdestarit për kundërvajtje në qoftë se nuk paraqitet brenda afatit të caktuar për këshillim në vijim të ftesës së tretë të dërguar (Neni 64-a paragrafi (2)); (7) Gjobë në lartësi nga 300 deri 400 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet prindit apo kujdestarit për kundërvajtje nëse nuk e bën të mundur për fëmijën e vet përmbushjen e obligimit për arsim dhe edukim të detyrueshëm fillor (Neni 5); (8) Për çdo përsëritje të ardhshme të kundërvajtjeve nga paragrafet (1) deri (7) të këtij Neni gjatë vitit aktual shollor shqiptohet gjoba me shumë të dyfishtë. Në pajtim me Nenin 3 paragrafin 1 të Ligjit të Arsimit të Mesëm: “arsimi i mesëm është i detyrueshëm për çdo qytetar, nën kushte të barabarta, të përcaktuara me këtë Ligj”⁵⁷. Në po të njëjtin Ligj, Neni 109 parashikon kundërvajtje me gjoba për prindin e nxënësit në qoftë se nuk përmbush obligimet e regjistrimit dhe ndjekjes së rregullt të mësimit, si vijon: (1) gjobë në lartësi nga 600 deri 800 euro në kundërvlerë denari për kundërvajtje të prindit apo kujdestarit të nxënësit të mitur në qoftë se nxënësi nuk është regjistruar në shkollë të mesme ose në mënyrë të parregullt viziton shkollën (Neni 3 paragrafi (1)); (9) Gjobë në lartësi nga 80 deri 100 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet prindit apo kujdestarit për kundërvajtje, në qoftë se nuk paraqitet brenda afatit të caktuar për këshillim pas ftesës së dytë të dërguar (Neni 58-a paragrafi (2)); (10) Gjobë në lartësi nga 200 deri 280 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet prindit apo kujdestarit për kundërvajtje në qoftë se nuk paraqitet brenda afatit të caktuar për këshillim pas ftesës së tretë të dërguar (Neni 58-a paragrafi (2)); (11) Për çdo përsëritje vijuese të kundërvajtjeve nga paragrafet (1) deri (10) të këtij Neni gjatë vitit aktual shkollor, shqiptohet gjobë në shumë të dyfishtë.


Nga të dhënat e marra për nevojat e këtij hulumtimi nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit, ky institucion në tre vitet e fundit sipas bazave të përmendura më herët, kishte paraqi-

56 Ligji i Arsimit Fillor, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017

57 Ligji i Arsimit të Mesëm, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017


tur në gjykatat kompetente gjithsej 578 parashtrës kundër prindërve. Detajet rreth numrit të parashtrësve, të ndara sipas vitit dhe shkallës së arsimit, janë prezantuar në Grafikon 3.

Grafiku 3



Informacionet e dhëna në Raportin e gjashtë Periodik mbi Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Nenin 10 të saj – Arsimi – Përgjigje në Rekomandimin nr. 30 (a) (b) (c) të Komitetit, pika 121 lexojnë se: “shkalla e braktisjes së parakohshme të shkollës gradualisht po bie dhe shkalla e kryerjes së arsimit të lartë është në rritje e sipër”⁵⁸. Megjithatë, në qoftë se vështrohen të dhënat e po të njëjtit Raport, të dhëna nën pikën 131⁵⁹, dhe të cilat i referohen publikimit Gratë dhe burrat në Maqedoni, të vitit 2015, si dhe të dhënave të ofruara në publikimin Gratë dhe Burrat në Maqedoni, të vitit 2017⁶⁰, të përmbledhura në Grafikon 4, mund të vërehet një rritje të numrit të nxënësve që braktisin arsimin e vet, sidomos gjatë arsimit fillor, përderisa ky numër në po të njëjtën periudhë po zvogëlohet tek nxënëset në shkollë të mesme.

Grafiku 4



58 Raporti i gjashtë Periodik mbi Konventën e Eliminimit të të gjitha formave të Diskriminimit, viti 2017, fq. 26


59 Njëjtë, fq. 28

60 “Gratë dhe burrat në Maqedoni”, viti 2017, Enti Shtetëror i Statistikave, Shkup, fq. 42, e disponueshme në: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/Gender2017.pdf>

Familjet rurale jetojnë relativisht larg nga shkollat publike dhe udhëzimi i vajzave në shkollat në lagjen më të afërt plotësueshëm ngarkon buxhetin familjar, dhe njëkohësisht i nënshtron vajzat ndaj rrezikut për dhunë të mundshme. Arsimi fillor dhe i mesëm në Republikën e Maqedonisë janë të detyrueshëm, por megjithatë, edhe përkundër faktit se Ligji i Arsimit Fillor⁶¹ dhe Ligji i Arsimit të Mesëm⁶² parashikojnë transport falas për nxënësit, ndërsa shteti informon se “gjatë vitit 2015, Ministria e Arsimit ka ndërmarrë masa që mundësojnë mobilitetin në arsim (sistemim, transport dhe mjete financiare), me qëllim përzgjedhja e arsimimit sipas prirjeve, e jo sipas vendbanimit”⁶³, megjithatë, jemi dëshmitarë se mediat vazhdimisht informojnë⁶⁴ se si kjo gjë nuk funksionon çdoherë në praktikë, pasi që në disa komuna as nuk ekziston transporti i organizuar i nxënësve nga vendbanimet rurale deri tek qytetet më të mëdha dhe lagje.

Për marrje të të dhënave statistikore konkrete në lidhje me faktin se sa vajza kanë braktisur procesin arsimor në komunat e targetuara, u dërgua një kërkesë për qasje në informacione me karakter publik deri tek Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të cilët, në përgjigjen e tyre na informuan se “.. me procesin e decentralizimit të vitit 2005, shkollat fillore dhe të mesme biejnë nën kompetencat e komunave”⁶⁵ dhe me këtë na udhëzuan që këto të dhëna t’i kërkojmë nga këto të fundit. Për këtë qëllim, dërguam kërkesa për qasje në informacione me karakter publik deri tek 15 komuna të targetuara, dhe deri në fund të përpilimit të kësaj analize, janë marrë përgjigje nga 11 komuna.

Grafiku 5



61 Neni 61 (1) Nxënësi gëzon të drejtën e transportit falas në qoftë se vendbanimi është i distancuar të paktën dy kilometra nga shkolla më e afërt fillore

62 Neni 41-a (2) Nxënësi nga paragrafi (1) i këtij Neni gëzon të drejtën e transportit falas në qoftë se vendbanimi është i distancuar të paktën 2,5 kilometra nga shkolla e mesme në të cilën nxënësi është i regjistruar dhe ndjek mësimin dhe në qoftë se profesioni dhe profili i përzgjedhur nuk është përfaqësuar në komunën ku jeton nxënësi

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij Neni, në qoftë se në komunën në të cilën jeton nxënësi, me regjistrimin në vitin e parë të arsimit janë plotësuar të gjitha vendet në shkollë, gjegjësisht në shkollat e komunës, atëherë nxënësi gëzon të drejtën e transportit falas deri tek shkolla e mesme në një komunë tjetër në të cilën nxënësi është regjistruar, në qoftë se vendbanimi është i distancuar të paktën 2,5 kilometra dhe në qoftë se nxënësi viziton mësimin.

63 Raporti i gjashtë Periodik mbi Konventën e Eliminimit të të gjitha Formave të Diskriminimit, viti 2017, fq. 27

64 Një pjesë e raporteve mediatike mbi kësaj rastesh mund të gjendet në: <http://mkd-news.com/detsa-za-orden-peshachat-na-20-sekoj-den-po-4-km/>

65 Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Përgjigja në kërkesë nr. 12-8734/2 e datës 03.08.2017

Nga Komuna e Vallandovës informojnë se gjatë tre viteve të fundit, janë çregjistruar gjithsej 33 vajza, si vijon: nga SHFK “Strasho Pinxhur” – Josifovë, 2 vajza (njëra nga komuniteti etnik maqedons dhe tjetra nga komuniteti etnik turk) janë çregjistruar në vitin shkollor 2015/2016 për arsye të shpërnguljes jashtë vendit; nga SHFK “Josip Broz Tito” në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar gjithsej 7 vajza (njëra nga komuniteti etnik turk dhe gjashtë nga komuniteti etnik maqedonas), si rezultat i largimit jashtë vendit ose regjistrimit në ndonjë shkollë tjetër, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar gjithsej 7 vajza (njëra nga komuniteti etnik rom dhe gjashtë nga komuniteti etnik turk), të gjitha këto për arsye të largimit jashtë vendit, në vitin shkollor 2015/2016, shkollën kanë braktisur gjithsej 4 vajza, të gjitha këto nga komuniteti etnik maqedonas, për arsye të largimit jashtë vendit ose për arsye të regjistrimit në ndonjë shkollë tjetër; nga SHMK “Goce Dellçev”, në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 4 vajza (përkatësia etnike nuk është shënuar për gjithë nxënësit, andaj nuk mund të merret një informacion konkret mbi përkatësinë etnike e vajzave të çregjistruara), në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar gjithsej 4 vajza (përkatësia etnike nuk është shënuar për gjithë nxënësit, andaj nuk mund të merret një informacion konkret mbi përkatësinë etnike e vajzave të çregjistruara), në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar gjithsej 5 vajza (përkatësia etnike nuk është shënuar për gjithë nxënësit, andaj nuk mund të merret një informacion konkret mbi përkatësinë etnike e vajzave të çregjistruara), në lidhje me çregjistrimin e nxënësve nga kjo shkollë, janë dhënë të dhëna të përgjithshme siç janë largimi jashtë vendit, regjistrimi në ndonjë shkollë tjetër, pushimi nga ose braktisja e shkollës, të cilat nuk janë të specifikuara sipas gjinisë, gjë kjo për të cilën nuk mund të merren të dhëna konkrete për arsyen pse vajzat kanë ndërprerë arsimin e vet në këtë shkollë.

Nga Komuna e Shtipit informojnë se gjatë tre viteve të fundit janë çregjistruar gjithsej 18 vajza me vendbanim në Komunën e Karbincës, si vijon: nga SHMK “Dimitar Mirasçiev”, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar gjithsej 7 vajza (njëra nga komuniteti etnik maqedonas, tre nga ai rom dhe tre nga ai turk); në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar gjithsej 6 vajza (dy nga komuniteti etnik rom dhe katër nga ai turk); si arsye për çregjistrimin e vajzave nga kjo shkollë, janë numëruar: mosinteresi për të ndjekur mësim nga nxënësit dhe prindërit e tyre, lidhja e martesave të të miturve, shkuarja në një shkollë tjetër, largimi jashtë vendit, po gjithnjë pa specifikuar një numër konkret të vajzave që janë çregjistruar për arsyet e numëruara; nga SHMK “Kole Nehtenin”, në vitin shkollor 2013/2014 është çregjistruar 1 vajzë nga komuniteti etnik maqedonas, për arsye të kalimit në shkollim të çrregullt (me korrespondencë), në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar gjithsej 4 vajza (tre nga komuniteti etnik turk dhe një nga komuniteti etnik maqedonas, si rezultat i braktisjes së shkollës me dëshirë vetjake..

Nga Komuna e Strumicës nga informojnë se gjatë tre viteve të fundit janë çregjistruar gjithsej 13 vajza me vendbanim në Komunën e Novosellës, të cilat kishin ndjekur mësim në SHMKSHN “Dimitar Vllahov”, si vijon: në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 3 vajza, të gjitha për arsye të largimit jashtë vendit; në vitin shkollor 2014/2015 është çregjistruar një nxënëse për arsye të largimit jashtë vendit dhe në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar gjithsej 9 vajza, nga të cilat 6 për arsye të largimit jashtë vendit dhe 3 për arsye të lidhjes së martesës. Sipas të dhënave të dorëzuara, vajzat që kanë lidhur martesë, kishin braktisur shkollën në vitin e dytë dhe në vitin e tretë. Të gjitha nxënëset janë të komunitetit etnik maqedonas.

Nga Komuna e Çeshinovës-Obleshevës informojnë se në tre vitet e fundit janë çregjistruar gjithsej 9 vajza me vendbanim në këtë komunë, si vijon: nga SHFK “Klimenti i

Ohrit” – Obleshevë, në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 2 vajza, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar 4 vajza dhe në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar 2 vajza. Të gjitha vajzat janë të komunitetit etnik maqedonas, por fatkeqësisht, në korrespondencë nuk janë numëruar arsyet për të cilat këto vajza ishin çregjistruar; nga SHFK “Strasho Pinxhur”, f. Sokolloarcë raportojnë se në vitet shkollore 2013/2014 dhe 2014/2015 nuk janë shënuar vajza të çregjistruara, ndërsa në vitin shkollor 2015/2016 vetëm një vajzë e komunitetit etnik maqedonas ishte çregjistruar për arsye të shpërnguljes.

Nga Komuna e Dellçevës informojnë se në tre vitet e fundit janë çregjistruar gjithsej 20 vajza, si vijon: nga SHMK “Metodi Mitevski Brico”, në vitin shkollor 2013/2014 nuk ka vajza të çregjistruara, ndërsa në vitin 2014/2015 ishte çregjistruar një vajzë e komunitetit etnik maqedonas, kurse në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar dy vajza, njëra nga të cilat është e komunitetit etnik maqedonas dhe tjetra nga komuniteti etnik rom; fatkeqësisht në korrespondencë nuk janë numëruar arsyet për të cilat ishte shkaktuar çregjistrimi i këtyre vajzave; nga SHFK “Vanço Përke”, në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar gjithsej 5 vajza, katër nga komuniteti etnik maqedonas dhe një nga komuniteti etnik rom, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar gjithsej 7 vajza, katër nga komuniteti etnik maqedonas dhe tre nga komuniteti etnik rom, ndërsa në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar gjithsej 5 vajza, katër nga komuniteti etnik maqedonas dhe një nga komuniteti etnik rom; fatkeqësisht në korrespondencë nuk janë numëruar arsyet për të cilat ishte shkaktuar çregjistrimi i këtyre vajzave; nga SHFK “Shën Klimenti i Ohrit” raportojnë se nuk kanë në dispozicion të dhënat mbi nxënësit e çregjistruar nga kjo shkollë.

Nga Komuna e Koçanës informojnë se në tre vitet e fundit ishin çregjistruar gjithsej 4 vajza, si vijon: nga SHMK “Lupço Santov” sipas të dhënave të shënuara në korrespondencë, nuk ka të dhëna të çregjistrimeve, ndërsa në SHMK “Gjosho Vikentiev”, në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 2 vajza, e në vitin shkollor 2014/2015 dhe 2015/2016 ishte çregjistruar një vajzë. Si arsye të çregjistrimit të nxënësve nga kjo shkollë janë numëruar: regjistrimi në një shkollë tjetër, mënjanimi dhe regjistrimi me korrespondencë (mësim të çrregullt), por pa specifikuar e pa lidhur gjininë e nxënësit të çregjistruar me arsyen konkrete të çregjistrimit.

Nga Komuna e Radovishtit informojnë se gjatë tre viteve të fundit janë çregjistruar gjithsej 197 vajza, si vijon: nga SHFK “Kosta Racin” – Podarësh, në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 2 vajza, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar 2 vajza dhe në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar 2 vajza, të gjitha nga komuniteti etnik maqedonas dhe ishin çregjistruar për arsye të largimit jashtë vendit; nga SHFK “Kërste P. Misirkov”, në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar gjithsej 20 nxënëse, nga të cilat 2 nga komuniteti etnik maqedonas, si rezultat i ndryshimit të vendbanimit dhe 18 nga komuniteti etnik rom, si rezultat i azilit ose braktisjes me vetëdashje; në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar 60 vajza, nga të cilat 4 nga komuniteti etnik maqedonas dhe 56 nga komuniteti etnik turk për arsye të azilit ose ndryshimit të vendbanimit ose të braktisjes me vetëdashje; në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar 23 vajza, nga të cilat 2 nga komuniteti etnik maqedonas dhe 21 nga komuniteti etnik turk, si rezultat i azilit, ndryshimit të vendbanimit ose largimit jashtë vendit; nga SHFK “Nikolla Karev”, në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 6 vajza, 2 nga të cilat të komunitetit etnik maqedonas dhe 4 të komunitetit etnik turk, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar 18 vajza, 6 nga të cilat të komunitetit etnik maqedonas dhe 12 të komunitetit etnik turk, në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar 13 vajza, 7 nga të cilat të komunitetit

etnik maqedonas dhe 6 të komunitetit etnik turk. Të gjitha vajzat ishin çregjistruar nga kjo shkollë si rezultat të azilit, ndryshimit të vendbanimit, largimit jashtë vendit ose transferrimit në një shkollë tjetër; nga SHFK "Orce Nikollov", f. Injevë, në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 5 vajza, të gjitha të komunitetit etnik maqedonas, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar 13 vajza, nga të cilat 11 të komunitetit etnik maqedonas dhe 2 të komunitetiet etnik turk, në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar 15 vajza, nga të cilat 14 të komunitetit etnik maqedonas dhe 1 të komunitetit etnik turk. Të gjitha vajzat ishin çregjistruar si rezultat të shpërnguljes jashtë vendit; nga SHMK "Kosta Susinov", në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 9 vajza, nga të cilat njëra ishte pushuar nga shkolla, ndërsa 8 kishin braktisur shkollën, në vitin shkollor 2014/2015, 3 vajza kishin braktisur shkollën, ndërsa në vitin shkollor 2015/2016, 6 vajza kishin braktisur shkollën. Për fat të keq, në të dhënat e shënuara në korrespondencë, nuk është specifikuar përkatësia etnike e nxënësve.

Nga Komuna e Ohrit informojnë se në tre vitet e kaluara janë çregjistruar gjithsej 27 vajza, si vijon: nga SHKTH "Vanço Pitosheski – Ohër, në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 5 vajza, të gjitha të komunitetit etnik maqedonas, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar 3 vajza, të gjitha të komunitetit etnik maqedonas, në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar 3 vajza, të gjitha të komunitetit etnik maqedonas. Për fat të keq, në korrespondencë nuk është shënuar arsyeja e çregjistrimit të vajzave; nga SHMKP "Shën Kirili dhe Metodi" informojnë se gjatë 2 viteve të fundit (shkolla si subjekt juridik ekziston që nga data 01.09.2014) nuk ka nxënës të çregjistruar; nga QKSHEM "Shën Naumi i Ohrit", në vitin shkollor 2013/2014 ishte çregjistruar një vajzë, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar 4 vajza, nga një të komuniteteve etnike maqedonase dhe turke dhe dy nga komuniteti etnik rom, në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar 5 vajza, dy nga komuniteti etnik maqedonas dhe tre nga komuniteti etnik rom. Në korrespondencë, si arsye janë numëruar transferrimi në shkollim t çrregullt, transferrim në shkollë tjetër dhe largim jashtë vendit, por megjithatë, fatkeqësisht, këto të dhëna nuk janë ndarë sipas gjinisë, kështu që nuk mund të merret një informacion përkatës rreth mënyrës së çregjistrimit të vajzave; nga SHMK "Shën Klimenti i Ohrit", në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 3 vajza nga komuniteti etnik maqedonas, në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar 3 vajza të komunitetit etnik maqedonas. Në korrespondencë mungojnë të dhëna për vitin shkollor 2015/2016, si dhe për arsyet e çregjistrimit të vajzave;


Nga Komuna e Konçës informojnë se gjatë tre viteve të fundit janë çregjistruar gjithsej 16 vajza, si vijon: në vitin shkollor 2013/2014, nga shkolla në këtë komunë janë çregjistruar 2 vajza të komunitetit etnik maqedonas për arsye të shpërnguljes në vendbanim tjetër; në vitin shkollor 2014/2015 janë çregjistruar 7 vajza të komunitetit etnik maqedonas për arsye të shpërnguljes në vendbanim tjetër dhe 3 vajza të komunitetit etnik turk për arsye të kërkimit të azilit në një vend tjetër; në vitin shkollor 2015/2016, shkollën kishin braktisur 3 vajza të komunitetit etnik maqedonas dhe 1 vajzë të komunitetit etnik turk, për arsye të kalimit në shkollë tjetër në komunë tjetër.

Nga Komuna e Karbincës informojnë se gjatë tre viteve të fundit janë çregjistruar gjithsej 3 vajza, si vijon: në vitin shkollor 2013/2014, nga shkolla në këtë komunë nuk ka vajza të çregjistruara; në vitin shkollor 2014/2015, 1 vajzë të komunitetit etnik turk është çregjistruar nga shkolla, ndërsa në vitin shkollor 2015/2016 janë çregjistruar 2 vajza të komunitetit etnik turk. Si arsye e çregjistrimit të të gjitha vajzave është shënuar regjistrimi në një shkollë tjetër.

Nga Komuna e Kërçovës informojnë se gjatë tre viteve të fundit janë çregjistruar gjithsej 12 vajza, si vijon: në vitin shkollor 2013/2014, nga shkollat e kësaj komune janë mënjanuar 8 vajza me vendbanim në komunën e Pllasnicës; në vitin shkollor 2014/2015 - 1 vajzë, ndërsa vitin shkollor 2015/2016 janë mënjanuar 3 vajza. Të gjitha vajzat që kanë ndërprerë arsimin janë të komunitetit etnik turk, dhe tek të gjitha si arsye e largimit ishte shënuar se kishin bërë mbi 25 mungesa të paarsyetuara.

Në qoftë se shikohen të dhënat e komunave të numëruara më lartë, do të shihet se për tre vite, gjithsej 352 vajza kanë ndërprerë arsimimin e vet të detyrueshëm, në baza të ndryshme. Këto të dhëna, të përmbledhura në Grafikon 6 tregojnë se numri më i lartë i vajzave janë çregjistruar në vitin shkollor 2014/2015, për arsye të largimit jashtë vendit, por prapsepër mbetet e hapur pyetja se cila është arsyeja konkrete e bërjes së mbi 25 mungesave të paarsyetuara dhe çregjistrimi nga shkolla, shkollimi i braktisur, si dhe cila është arsyeja konkrete e gjithë atyre vajzave të çregjistruara për të cilat shkollat nuk kanë shënuar në korrespondencat e veta.

Grafiku 6



Për të marrë informacione plotësuese kualitative, në 60 shkolla fillore dhe të mesme në rajonet e targetuara u dërgua një pyetësor anketues, ku janë marrë të dhëna nga gjithsej 27 shkolla, nga të cilat 12 shkolla informojnë se vajzat ndjekin shkollimin e detyrueshëm në komunat e targetuara, apo më saktësisht, nuk kishte patur raste ku vajzat kanë ndërprerë shkollimin e detyrueshëm nga shkollat e tyre. Sa iu përket shkollave tjera, të ndara sipas rajoneve të targetuara, informojnë për gjendjen në vijim:

Rajoni i Pollogut:

Nga SHMKP “Gjoce Stojçeski” të komunës së Tetovës informojnë se vajzat nga komunat e Bërvenicës, Vrapçishtit, Jegunocit dhe Tearcës që janë regjistruar në këtë shkollë, vazhdimisht po e ndjekin shkollimin e detyrueshëm. Megjithatë, në 3 vitet e kaluara janë regjistruar 20 raste të vajzave të komunitetit etnik shqiptar, në moshë ndërmjet 15 dhe 18 vjeç të komunave të përmendura më lartë, të cilat kishin braktisur shkollimin për arsye të largimit të familjeve të tyre jashtë vendit. Përfaqësuesit e shkollës konsiderojnë se duhet parandaluar emigrimin dhe se çdo braktisje të shkollimit të detyrueshëm ka efekt negativ mbi jetën e vajzave.

Nga SHMKE "8 Shtatori" të komunës së Tetovës po informojnë se vajzat nga komunat e e Bërvenicës, Vrapçishtit, Jegunocit dhe Tearcës që janë regjistruar në këtë shkollë, vazhdimisht po e ndjekin shkollimin e detyrueshëm. Megjithatë, në 3 vitet e kaluara janë regjistruar 13 raste të vajzave të komunitetit etnik maqedonas dhe atij shqiptar, në moshë ndërmjet 15 dhe 18 vjeç të komunave të përmendura më lartë, të cilat kishin braktisur shkollimin për arsye të largimit të familjeve të tyre jashtë vendit, vazhdim të shkollimit në një shkollë tjetër të mesme, për arsye personale dhe lidhje të martesës. Përfaqësuesit e shkollës konsiderojnë se duhet parandaluar emigrimin dhe se çdo braktisje të shkollimit të detyrueshëm ka efekt negativ mbi jetën e vajzave, duke u mundësuar punësim të rinjë në shtetin tonë.

Rajoni Lindor:

Nga SHFK "Strasho Pinxhur" në f. Sokollarcë, komuna e Çeshinovës-Obleshevës informojnë se është një rast i vetëm ku një vajzë, bijë e një prindi të vetëm, e cila kohë pas kohe kishte ndërprerë arsimin, mirëpo, si pasojë e instistimit të shkollës dhe në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit – Koçan, ajo përsëri ktheheshka në shkollë. Ata gjithashtu informojnë se në këtë vit shkollor, nxënësja rregullisht po vizitonte shkollimin e saj të detyrueshëm.

Nga SHF "Sinisha Stoillov" nga Komuna e Zërnocit informojnë se vetëm në vitin shkollor 2013/2014 janë çregjistruar 2 vajza për arsye të emigrimit, ndërsa në vitet tjera të targetuara me këtë hulumtim, nga kjo shkollë as edhe një vajzë nuk kishte braktisur arsimin.

Nga SHFK "Vanço Përke" të Komunës së Dellçevës informojnë se në 3 vitet e fundit janë regjistruar 3 raste ku vajza të kombësisë rome, në moshë nga 12 deri 14 vjeç kishin ndërprerë arsimin e vet të detyrueshëm për arsye të lidhjes së martesës. Përfaqësuesit e shkollës konsiderojnë se pasojat e ndërprerjes së arsimit janë pamundësia e punësim-it përkatës, vajzat mbeten të pasocializuara dhe po përballen me probleme nga më seriozet që nga mosha e hershme dhe nuk kanë përvojë për t'u bërë ballë atyre. Sipas tyre, me ndihmën e bisedave këshilldhënëse me familjet e vajzave, me realizimin e punëtorive nga organizatat joqeveritare mbi lidhjen e hershme të martesave, me informimin e prindërve për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre mund të bëhet ndikimi mbi vajzat që mos ta ndërpresin arsimimin e tyre të detyrueshëm.

Nga SHMK "Dimitar Mirasçiev" të Komunës së Shtipit informojnë se në vitin shkollor 2015/2016, në vitin e parë nga Komuna e Karbincës janë regjistruar 2 vajza të cilat kishin ndjekur mësimin në mënyrë të parregullt, në vitin shkollor 2016/2017 janë regjistruar 3 vajza, nga të cilat 1 nxënëse kishte ndjekur mësimin rregullisht, 1 nxënëse kishte kaluar në shkollë tjetër dhe 1 nxënëse kishte ndjekur mësimin në mënyrë të parregullt, ndërsa në vitin shkollor 2017/2018 ishin regjistruar 4 vajza dhe të gjitha kishin ndjekur mësimin në mënyrë të rregullt. Përfaqësuesit e shkollës informojnë se arsyet e mosndjekjes së mësimin ka natyrë personale, ose, siç kumtojnë ata, mosinteresimi për ndjekjen e mësimin, gjë kjo për të cilën ishin zbatuar veprime për shqiptim të masave pedagogjike, ndërsa prindërit janë ftuar në shkollë, por fatkeqësisht ata nuk iu ishin përgjigjur ftesave. Në këtë shkollë, gjatë 3 viteve të fundit janë regjistruar 2 raste të ndërprerjes së shkollimit nga vajza të komunitetit etnik turk në moshë nga 15 deri 18 vjeç, siç shënojnë, për arsye të mosinteresimit nga nxënësit dhe prindërit e tyre për

ndjekje të mësimimit, të informimit të parregullt dhe edukimit të pamjaftueshëm. Përfaqësuesit e shkollës konsiderojnë se ndërperja e arsimit ka ndikim negativ mbi jetën e vajzave, sepse i kufizon mundësitë e tyre për pjesëmarrje të barabartë në shoqëri dhe më tej ndikon në rritjen e numrit të martesave të të miturve. Sipas tyre, edukimi përkatës i vajzave që nga moshja e hershme për sa i përket rëndësisë, kuptimit dhe ndikimit të shkollës së kryer të mesme mbi cilësinë e jetesës së tyre të mëtejshme, si dhe edukimi përkatës i prindërve për shkak të rolit të tyre të rëndësishëm në zhvillimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre mund të ndikojë mbi vajzat dhe vendimin e tyre që ta mos ndërpresin arsimimin e tyre.

Nga SHMK “Sllavço Stojmenski” të Komunës së Shtipit informojnë se gjatë tre viteve të fundit nuk kishin patur raste të braktisjes së shkollës nga vajza të Komunës së Karbinçës, por kishin patur raste të tilla në vitet paraprake, ku arsyeja më e shpeshtë kishin qenë martesat e dakorduara. Sipas shkollës, bindjet tradicionale të prindërve, si dhe bërja e dallimit midis fëmijëve në bazë të gjinisë ka ndikim mbi këtë dukuri negative, ku në të njëjtën kohë këto vajza, pothuajse pa përjashtim, nuk gëzojnë të drejta të barabarta me djemtë, dhe shpesh janë pamjaftueshëm të emancipuara. Shkolla konsideron se edukimi, vizitat e drejtpërdrejta familjeve, si dhe bisedat me prindërit e vajzave dhe vetëdijësimi i tyre, sidomos i babait, janë vendimtare për vazhdimin e arsimimit të këtyre vajzave.

Rajoni Jug-Lindor:

Nga SHF “Mustafa Kemal Atatürk” të Komunës së Pllasnicës informojnë se në 3 vitet e fundit janë regjistruar 4 deri 5 raste të ndërprerjes së shkollimit nga vajza të moshës nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, të gjitha këto të përkatësisë etnike turke, për arsye të largimit jashtë vendit.

Nga SHF “Debërcë” fshati Bellçisht, Komuna e Debërcës informojnë se vajzat rregullisht po vizitojnë arsimin e detyrueshëm, ekzistojnë raste të çregjistrimit të nxënëseve për shkak të shpërnguljes, ku kanë në posedim prova se ato janë regjistruar në shkolla tjera fillore. Nuk kanë rast të regjistruar të shkollimit të ndërprerë nga vajza në 3 vitet e fundit, dhe njëkohësisht informojnë se si shkollë janë të përgatitur t’i ndërmarrin të gjitha masat e nevojitura për t’i përfshirë të gjitha palët dhe institucioet e interesuara në qoftë se bëhet një rast i tillë. Nga shkolla informojnë se ndikojnë mbi vajzat që mos ta ndërprerjnë arsimimin e detyrueshëm me mbajtjen e një numri të madh të ligjeratave për vajzat dhe prindërit e tyre, punëtori edukative të organizuara nga shkolla dhe nga organizatat joqeveritare.

Nga SHMK “Shën Naumi i Ohrit”, nga Komuna Makedonski Brod informojnë se në vitin shkollor 2013/2014, 14 vajza kanë braktisur shkollimin e tyre, nga të cilat 8 maqedonase, 5 turke dhe 1 përfaqësuese e komunitetit etnik boshnjak; në vitin shkollor 2014/2015 ka rënie të këtij numri, apo 3 vajza kishin braktisur shkollimin e tyre, nga të cilat 2 maqedonase dhe 1 turke dhe në vitin shkollor 2015/2016 po aq nxënëse kishin braktisur shkollimin e tyre, nga të cilat 1 maqedonase dhe 2 turke. Sipas shkollës, arsyet e çregjistrimit janë transferrim në shkollë tjetër dhe shpërngulje, ndërsa tek vajzat arsyeja më e shpeshtë e braktisjes së shkollës është lidhja e martesës.

Rajoni Jug-Lindor:

Nga SHM “Jane Sandanski” e Komunës së Strumicës informojnë se një nxënëse 16-vjeçe e komunitetit etnik maqedonas, me vendbanim në Komunën e Novosellës kishte ndërprerë arsimimin e vet për shkak të shtatzënisë dhe lidhjes së martesës, dhe pas lindjes së fëmijës, nxënësja kishte vazhduar arsimimin e vet si nxënëse e çrregullt. Ata informojnë se për fat të mirë, në këtë rast bëhet fjalë për nxënëse e cila edhe përkundër shtatzënisë dhe martesës, ajo prapëseprap vazhdon shkollimin e vet pa vështirësi posaçërisht të rënda dhe arrin sukses të mirë në provimet e çrregullta. Sipas shkollës, nëpërmjet të rolit edukativ dhe këshilldhënës të shkollës dhe shërbimit pedagogjiko-psikologjik duhet të bëhet ndikimi mbi vajzat që ta mos ndërpresin shkollimin e tyre të detyrueshëm.

Nga SHMK “Nikolla Karev” e Komunës së Strumicës informojnë se si rezultat i faktit se kjo shkollë ka gjashtë profesione teknike, pjesa më e madhe e nxënësve është e gjinisë mashkullore. Megjithatë, në 3 vitet e fundit janë regjistruar 2 raste të ndërprerjes së shkollimit të vajzave të komunitetit etnik maqedonas, për arsye të pushimit nga shkolla për shkak të numrit të madh të mungesave të paarsyetuara dhe si e dyta, për shkak të lidhjes së martesës.


Nga SHFK “Josip Broz Tito” e Komunës së Vallandovës informojnë se është evidentuar një numër i vogël i rasteve ku vajzat po braktisin shkollimin, por më së shpeshti pas një periudhe të caktuar po i kthehen mësimin. Në shkollën konkrete kishte patur një rast ku një vajzë e komunitetit etnik rom ka sjellje asociale në shkollë, ndërsa në jetën private ka sjellje normale. Prindërit kishin kërkuar ndihmën e shërbimeve të shkollës dhe për këtë rast ishte informuar inspektori i arsimit. Poashtu nga shkolla ishin çregjistruar motra të komunitetit etnik rom për shkak të largimit jashtë vendit. Shkolla informon se pas disa muajsh e tërë familja ishte kthyer në vend, megjithatë vajzat nuk kishin vazhduar shkollimin e tyre. Në të dy rastet vajzat kishin qenë të moshës 12 deri 14 vjeç. Nga shkolla konsiderojnë se ndërperja e shkollimit ka efekt negativ mbi jetën e vajzave, sepse pas ndërprerjes, ato më së shpeshti vazhdojnë të punojnë nëpër konfeksione ose lidhin martesë. Megjithatë, duke ditur se nuk kanë tepër raste të këtij lloji, administrata e shkollës nuk kishte menduar rreth mënyrave se si mund të bëhet ndikimi mbi vajzat e Komunës së Vallandovës që ta mos ndërpresin arsimimin e tyre të detyrueshëm.

Nga SHMK “Goce Dellçev” e Komunës së Vallandovës bëjnë të ditur për 12 raste ku vajza të moshës 16-17 vjeç, pjesëtare të komuniteteve etnike maqedonase dhe turke, që kishin ndërprerë arsimimin e tyre në 3 vitet e fundit, si rezultat i lidhjes së martesës, shpërnguljes jashtë vendit e ngjashëm. Fatkeqësisht, është kjo shkolla e vetme nga ato që iu përgjigjën pyetësorit anketues, e cila nuk ia arrin dot të identifikojë se në cilën mënyrë ndikon ndërprerja e arsimit mbi jetesën e vajzave, gjegjësisht, konsideron se “nuk ka ndonjë ndikim të posaçëm”. Megjithatë, përfaqësuesit e shkollës konsiderojnë se edukimi më i madh, inkuadrimi në aktivitete jashtë-shkollore, edukimi i prindërve, informimi më i lartë mbi martesën dhe familjen, si dhe mbi obligimet që burojnë nga ato, do të kishte patur ndikim mbi vajzat e kësaj komune që ato ta mos ndërpresin arsimimin e vet.

Nga SHMK “Kosta Susinov” e Komunës së Radovishit bëjnë të ditur se vajzat e kësaj komune rregullisht po ndjekin arsimin e detyrueshëm, me përjashtime të vogla tek vajzat e konfesionit fetar islam – jurukët. Në këtë shkollë, në 3 vitet e fundit janë regjistruar rreth 10 raste të ndërprerjes së arsimit të detyrueshëm, ku si arsye më e shpeshtë

po shënohet lidhja e martesës. Përfaqësuesit e kësaj shkolle bëjnë të ditur se më së shpeshti, vajzat që po ndërpresin shkollimin janë të moshës diku 16-17 vjeç dhe janë kryesisht të komunitetit etnik turk – jurukë, por është një numër i ulët i nxënësve të konfesionit fetar i krishter, ndërsa më së shpeshti si arsye për ndërprerjen e shkollimit shënohet shtatzënia e paplanifikuar, ku vajzat po vazhdojnë si nxënës të çrregullta. Përfaqësuesit e shkollës konisderojnë se ndërprerja e shkollimit ka ndikim jashtëzakonisht negativ mbi jetën e mëtejshme të vajzave.

Po të përmbledhim dhe prezantojmë grafiksht të dhënat që kanë numëruar shkollat që iu kanë përgjigjur pyetësorit anketues, rreth arsyeve për të cilat vajzat po çregjistrohen nga shkollat e tyre, mund të vërejmë tek Grafiku 7 se lidhja e martesës është numëruar si arsye për ndërprerjen e shkollimit në numrin më të lartë të shkollave.



Sipas të dhënave të numëruara më lartë, mund të konkludohet se edhe shkollat, pa përjashtim, ndërperjen e arsimit tek vajzat e konsiderojnë si dukuri negative dhe po bëjnë përpjekje, në kuadër të kompetencave të tyre, për vetëdijësimin e popullsisë (prindërve dhe nxënësve) për nevojën nga arsimimi i detyrueshëm i vajzave, dhe sipas nevojës, ndërmarrin edhe masa institucionale.

Pas marrjes së të dhënave të caktuara kualitative që duhej të ofrojnë vështrim në perceptimin se Ministria e Arsimit dhe Shkencës ndaj çështjeve të ndryshme në lidhje me (mos)përfshirjen e vajzave të zonave rurale në procesin arsimor, u zbatua një intervistë me përfaqësuese të Ministrisë. Gjatë bisedës, ato theksuan se konsiderojnë se ekzistojnë kushte përkatëse (qasje në shkollat, afërsia e shkollave, profesione përkatëse) në shkollat e zonave rurale. Sipas tyre, arsyeja më e shpeshtë për ndërprerjen e arsimit të detyrueshëm është shpërngulja ose regjistrimi në një shkollë tjetër. Përfaqësueset e MASH theksuan se të dhënat e grumbulluara për vitin shkollor 2015/2016 tregojnë se 1408 nxënës ishin “nxituruar” në atë viti shkollor, nga të cilët 656 nxënës kishin qenë të gjinisë femërore. Këto të dhëna po përputhen me të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave, të dhëna në Grafikon 4. Informacionet që na i dhanë nga Ministria gjenden në nivelin qëndror dhe fatkeqësisht ato nuk po procesohen sipas nivelit të zhvillimit të komunave, më saktësisht, në qoftë se janë të zonave urbane apo rurale, dhe në të njëjtën kohë, MASH bëri të ditur se në pajtim me Nenin 3 të Ligjit mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale⁶⁶, nuk mbahen të dhëna mbi përkatësinë etnike të nxënësve. Sipas përfaqësueseve të MASH mbi vazhdimin e shkollimit tek vajzat, me ndihmën e vetëdijësimin

66 Ligji i Mbrojtjes së të Dhënave Personale “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/05, 103/08, 124/10, 43/14, 135/11, 153/15 11 99/16

të popullsisë (komunikimit të drejtpërdrejtë me prindërit) mbi rëndësinë e arsimit, forumeve, edukimit. Ato theksuan rëndësinë e arsimit mbi jetën e vajzave të zonave rurale, sepse, siç theksuan, në të kundërtën, mund të shfaqet asocializimi, mosemancipimi, varësia ekonomike e familjes/bashkëshortit, gjendja e vështirë ekonomike, martesat e parakohshme, shtatzënësitë e parakohshme dhe dukuritë e ngjashme që mund të kenë ndikim negativ mbi jetën e tyre të përgjithshme. Për të ndërmarrë masa në drejtim të përmirësimit të qasjes në arsim për vajzat rurale, përfaqësueset e MASH konsiderojnë se nevojitet një qasje multisektoriale të më tepër institucioneve siç janë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, e shoqëruar me vetëdijësimin dhe këshillimin mbi rëndësinë e arsimit dhe të prindërve dhe nxënësve.

Nga informacionet e grumbulluara me ndihmën e bërjes së intervistave me gra të përkatësive të ndryshme etnike, me shkallë të ndryshme të arsimit dhe me status të ndryshëm ekonomik në rajonet e targetuara, janë marrë të dhënat në vijim.

Në Rajonin e Pollogut, gratë, duke folur për vetë, edhe për atë se si po e kalojnë kohën, përshkruan nga një ditë të jetave të tyre, ku u dëshmuua se nuk ekzistojnë dallime për sa i përket përkatësisë etnike të grave të intervistuar. Në përgjithësi, gratë që janë me arsim fillor, më së shumti i janë përkushtuar familjes dhe detyrave të shtëpisë dhe njëkohësisht konsiderojnë se nuk kanë nevojë për ndihmë plotësuese nga partneri, sepse ai është i zënë me fitimin për jetë. Sipas tyre, roli tradicional i grave në shtëpi dhe në familje është pranuar si mënyra e dëshiruar dhe e përditshme e funksionimit, së bashku me respektin përkatës të atij që siguron kushte për jetesë dhe siguri ekonomike. Gratë që janë me arsim të mesëm, dhe janë të papunësuar, shumica janë prirur ndaj vlerave tradicionale dhe familjare, kurse respektojnë dhe rolet e ndara sipas gjinive, gjegjësisht, nuk ndiejnë nevojë të kërkojnë ndihmë në kryerjen e detyrave të shtëpisë, e as nuk presin nga anëtarët tjerë të familjes të marrin pjesë në të. Poashtu, në pjesën më të madhe ato edukojnë edhe fëmijët e vet, duke mos shikuar asgjë problematike në këtë gjë. Për dallim nga ato, gratë që janë të punësuar, edhe përkundër asaj se e kanë patjetër t'i kryejnë detyrat e punës, ato njëkohësisht po kujdesen edhe për shtëpinë dhe për familjen. Ato konsiderojnë se traditën duhet respektuar, por edhe nuk duhet të robërohen nga ajo. Për dallim nga ato, gratë që janë me arsim të lartë, dhe në të njëjtën kohë janë të punësuar, po bëjnë përpjekje ta ndërtojnë vetën profesionalisht dhe të ndërtojnë karrierën e vet, duke bërë përpjekje që në të njëjtën kohë të mos i shpërfillojnë edhe obligimet tradicionale patriarkale rreth shtëpisë dhe familjes. Ato theksuan se nganjëherë ndiejnë lodhje të tepërt nga obligimet si në punë ashtu dhe në shtëpi dhe duke patur parasysh faktin se vijnë nga zonat rurale, shumë shpesh e kanë të vështirë të vendosin ekuilibrin, ndërsa një pjesë të obligimeve t'u kalohen anëtarëve tjerë të familjes. Njëra nga gratë e intervistuar e cila është me arsim të lartë, por njëkohësisht është e papunësuar, u është përkushtuar vetëm obligimeve të shtëpisë, ndërsa dëshira për të relazuar komunikim me dikë po e arrin vetëm nëpërmjet të rrjeteve sociale, apo siç thotë: *"me disa reflektime dhe shkrime të statuseve në FB, si dëshirë për realizimin e komunikimit me dikë"*.

Sa i përket mënyrës së jetesës së grave në këtë rajon më herët dhe tani, të gjitha gratë e intervistuar, pa dallim të shkallës së arsimit theksuan se ka dallim të madh ndërmjet jetës së nënave dhe gjysheve të tyre dhe jetës së tyre për sa i përket marrëdhënies burrë-grua, gjegjësisht, tani është më mirë për ato, sesa kishte qenë për paraardhëset e tyre, por për arsye të ndryshme. Për një pjesë të tyre është më mirë sepse tanimë ka makina të reja të cilat e shkurtojnë kohën e kryerjes së detyrave të shtëpisë, për një pjesë tjetër është më mirë sepse konsiderojnë se kanë liri më të madhe të vendimsjel-

ljes dhe liri të lëvizjes, krahasuar me më parë, kur gratë kishin qëndruar në shtëpi, dhe për një pjesë tjetër të grave, arsyeja është sepse ishin ndryshuar rolet dhe se burrat marrin pjesë në kryerjen detyrave të shtëpisë. Siç tha njëra nga të intervistuarat më të reja: *“Në kohën e ime gjyshe kishte qenë katastrofale, gruaja nuk kishte patur të drejtën e fjalës ose e vendimsjelljes. Në kohën e ime ëmë gjërat ishin përmirësuar sadopak, ajo kishte kryer shkollën e mesme, nuk kishte patur presion si një grua për të punuar me ndërrime, as nga im atë e as nga rrethi”*. Sipas pjesës më të madhe të të intervistuarave, traditën duhet respektuar, kurse, edhe përkundër faktit se roli i gruas në familje ishte përmirësuar, prapëseprap konsiderojnë se në kohën e gjysheve të tyre, familjet kishin qenë më të lumtura. Një pjesë e tyre konstatuan se edhe hahas asaj se më herët gratë kanë qenë të paarsimuara, ato kishin qenë më të urta dhe kishin qenë shtylla e familjes.

Edhe pse në përgjithësi ato konsiderojnë se janë më të barabarta se më herët, prapëseprap, kur përshkruajnë ditën e tyre, përshtypja është se ato akoma po jetojnë në botën e roleve të caktuara gjinore në bazë të stereotipeve. Për pjesën më të madhe të tyre, dita u është plotësuar me përmbushjen e asaj që ato identifikojnë si “punë grash” (larje të robave, hekurosje, pastrim, kujdes për fëmijët dhe personat e moshuar), ndërsa burrat kryesisht merren me “punët e burrave”, siç janë ngjyrosja, meremetimet në shtëpi, e ngjashëm. Sipas tyre, kjo paraqet një ndarje e barabartë e obligimeve në shtëpi dhe familje, për shkak të së cilës konsiderojnë veten si anëtarë të barabartë në familje. Në lidhje me dispozicionin e buxhetit familjar, pjesa më e madhe e të intervistuarave theksoi se ai është i përbashkët, jo rrallëherë edhe së bashku me fëmijët (nëse janë të rritur), ndërsa të tjerat thanë se në familjet e tyre, burrat janë të obliguar me administrimin e buxhetit familjar, me përjashtim të rasteve kur duhet sjellur ndonjë vendim më i madh (siç është blerja e banesës ose regjistrimi i fëmijëve në fakultet), në të cilat raste përfshihen dhe gratë në sjelljen e vendimit përfundimtar.

Në lidhje me arsimimin e të intervistuarave të Rajonit të Pollogut dhe atë se si ai kishte ndikuar jetat e tyre, mund të konkludohet se të gjitha të intervistuarat që kishin kryer vetëm arsim fillor me keqardhje po deklarojnë se nuk kishin vazhduar arsimimin e tyre, dhe si arsye më e shpeshtë e ndërprerjes theksojnë gjendjen financiare të familjes. Njëra nga të intervistuarat e komunitetit etnik shqiptar theksoi se si më e madhja në familje, ishte detyruar ta braktiste shkollimin, për të kontribuar në buxhetin familjar, gjë kjo për të cilën ajo ndjen keqardhje, Si rezultat i përvojës së saj së vështirë, ajo sot nxit motrat dhe vëllezërit e saja të vazhdojnë shkollimin. Si një nga problemet për ndërprerjen e procesit arsimor, njëra nga të intervistuarat e komunitetit etnik rom, theksoi se për arsye të procesit të rëndë të nostrifikimit të disa dëftesave për kryerje të një pjese të arsimit fillor të fituar jashtë vendit, kishte qenë e detyruar ta braktiste shkollimin e saj. Ajo deklaroi *“nuk ma pranoni arsimimin në Gjermani, nuk e di cila është arsyeja, kisha edhe dëftesat, por nuk ma pranoni dot atë, thanë se kjo nuk mund të pranohet këtu dhe se e kam patjetër të vazhdojë mësimin, të mësoja me fëmijë më të vegjël se unë, unë isha shumë më e rritur se ata dhe nuk dëshiroja të shkoja, kështu që, vet hoqa dorë në klasën e gjashtë”*. Shumica e të intervistuarave me shkollë të kryer të mesme nuk kishin vazhduar shkollimin e vet për shkak të mungesës së financave. Disa nga ato theksuan se në qoftë se kushtet e jetës do të ishin më të ndryshme në kohën kur ato kishin ndjekur mësimin, atëherë do ta kishin vazhduar arsimin. Megjithatë, disa nga ato nuk konsiderojnë se arsimimi i njerëzve është vendimtar për cilësinë e jetesës së tyre. Një e anketuar deklaroi *“konsideroj se arsimi i lartë nuk është pikë referimi për suksesin e një njeriu, me rëndësi është që njeriu të dëshirojë të mësojë dhe të zhvillohet joformalisht. Arsimi nuk ishte pengesa për mua që të zhvillohem, sepse unë jam ambicioze”*. Një pjesë e të intervistuarave theksuan se janë të kënaqura me jetat e tyre, nuk pendohen

se nuk kanë vazhduar arsimimin e vet, sepse menjëherë pas përfundimit të shkollës së mesme, kishin arritur të punësohen dhe të fitojnë për jetë në mënyrë të pavarur. Siç tha njëra nga të intervistuarat: *“isha e kënaqur nga vendi i punës ku u punësova, aty kishte mirësjellje ndaj të punësuarve, rroga të rregullta, sigurim, bonuse”*. Të intervistuarat me arsim të lartë konsiderojnë se mjetet financiare në rastet e tyre kishin qenë vendimtare për sjelljen e vendimit mbi vazhdimin e arsimit, si dhe mbi përzgjedhjen e fakultetit. Disa nga ato, kryesisht për shkak të gjendjes financiare të familjes, nuk kishin qenë në mundësi ta kryenin fakultetin që kanë dëshiruar, por vetëm për të mos mbetur me arsim të mesëm, kishin vendosur që ta kryenin cilindo fakultet. Si rezultat i kësaj, ato sot janë të punësuara përkatësisht me arsimin e tyre, edhe pse në të kaluarën kishin patur dëshira dhe plane tjera për veten dhe jetën e tyre, gjëra këto të cilat i kujtojnë me nostalgji.

Në lidhje me punësimin, si dhe me kënaqësinë nga puna, nuk ka dallime ndërmjet përkatësive të ndryshme etnike të të intervistuarave të Rajonit të Pollogut; në përgjithësi mund të konkludohet se gratë që kanë arsim fillor, dhe janë të punësuara, kryesisht nuk janë të kënaqura me punën e tyre dhe kushtet që kanë aty. Disa nga ato kërkojnë punësim jashtë vendit ose përpjekjen që nëpërmjet të kurseve të kualifikohen plotësuashëm dhe të gjejnë vend punë më dinjitoz. Një pjesë e grave që kanë arsim të mesëm dhe janë të punësuara janë të kënaqura me jetën e vet, sidomos ato që në kushtet aktuale shoqërore, fitojnë dhe kanë sigurim shëndetësor, edhe përkundër faktit se mbase nuk kanë gjasa të mëdha për avancim dhe ndërtim të karrierës. Ato gra kualifikimet e të cilave arsimore nuk përputhen me vendin e punës, më së shpeshi ndjehen të pakënaqura dhe të paplotësuara, sepse punojnë vetëm për të përmbushur nevojat e ekzistencës. Siç theksoi njëra nga të intervistuarat: *“Është rëndë, por e kam patjetër të punoj. Fëmijët nuk kund të punojnë, nuk kanë as alternativa dhe dëshirojnë të largohen”*.

Në Rajonin Jug-Perëndimor, gratë me arsim fillor, duke folur për vete personalisht dhe për përditshmërinë e tyre, theksuan se në esencë, ato janë të kënaqura me jetën e tanishme, por se fëmijëria e tyre, pa përjashtim, kishte qenë shumë e vështirë. Ato më së shpeshi kalojnë ditët në kryerjen e obligimeve të shtëpisë dhe me punë në tokën bujqësore që posedojnë dhe në përgjithësi konsiderojnë se jeta në fshat është shumë e vështirë. Një pjesë e të intervistuarave të cilat për momentin janë punëtore tepriçë teknologjike, dhe konsiderojnë se jeta e tyre kishte qenë më komode kur kishin punuar, edhe pse puna e tyre kishte qenë me ndërrime. Një pjesë e të intervistuarave me arsim të mesëm theksuan se edhe pse jetojnë në zonë rurale, ato nuk merren me bujqësi, sepse pjesën më të madhe të kohës kalojnë në punë, ndërsa pjesën tjetër kalojnë në pushim dhe shoqërim me familjen.

Një pjesë e të intervistuarave të këtij rajoni theksojnë se ndikimi i traditës është më i ulët sot, për dallim nga e kaluara. Ato konsiderojnë se vajzat e reja tani janë më të emancipuara dhe të vetëdijësuara për nga çështjet e gjinisë, sepse kanë jetë më të bukur dhe më liberale, për dallim nga nënat dhe gjyshet e tyre, të cilat kanë jetuar të ngarkuara me “shtrëngesat” e traditës. Të gjitha të intervistuarat theksuan se së bashku me bashkëshortët e tyre po kujdesen për ndarjen e buxhetit familjar. Një pjesë e të intervistuarave theksuan se në ditët tona, shumica e burrave kryejnë një pjesë të madhe të obligimeve të shtëpisë, të cilat në të kaluarën janë konsideruar si, siç ato i identifikojnë, vetëm punë të grave. Megjithatë, ekzistojnë raste ku burrat marrin përsipër një pjesë të obligimeve vetëm kur janë të disponuar për këtë, ose kur u jepen obligime konkrete nga gartë, për t’iu ndihmuar atyre. Një pjesë e vogël e të intervistuarave konsideruan se është obligimi i tyre të përkujdesen për punët e shtëpisë sepse burri, me vetë faktin që është i punësuar dhe fiton për jetë, po kontribuon mjaftueshëm për familjen.

Mungesa e mjeteve financiare kishte shtyrë edhe një pjesë të grave të Rajonit Veri-Perëndimor ta braktisin arsimimin për t'u punësuar në moshë shumë të re. Njëra nga të intervistuarat theksoi se për arsye të gjendjes së vështirë financiare, ajo madje ishte martuar në moshë 16 vjeç, me lejen e të atit. Gratë që kanë kryer arsim të mesëm, më së shpeshi nuk kishin vazhduar shkollimin e vet për shkaqe financiare, por kishin gjetur mënyra për avancim të mëvetësishëm. Njëra nga të intervistuarat me arsim të kryer të lartë konsideron se arsimimi i deritanishëm nuk i kishte dhënë nivelin e kënaqshëm të diturisë, për shkak të cilësisë konsiderueshëm të rënuar të institucionit të arsimit të lartë, ku ajo kishte ndjekur studimet.

Nga ana tjetër, një pjesë e të intervistuarave të këtij rajoni, Maqedonase Muslimane (nga fshati Broshticë, në lartësi mbidetare nga 1400m), akoma po jetojnë në frymën e vlerave patriarkale tradicionale dhe me role të ndara sipas gjinisë, ku obligimet “femërore” dhe ato “mashkullore” nuk përzhihen. Sipas botëkuptimeve të tyre, është joadekuate që vajzat të shkojnë në shkollë të mesme, sepse në qoftë se themelojnë ose dyshohen për themelim të çfarëdo lidhjeje të dashurisë me një moshatar, mund të shkaktojnë dëm të pakompensueshëm për “nderin” dhe statusin shoqëror të familjes. Kjo frikë po fuqizohet plotësisht për faktin se shkollat e mesme janë mjaft të distancuara, kështu që disa prindër frikësohen për sigurinë e vajzave të veta. Shumica e grave haptazi tregojnë se nuk do t'i (kishin lëshuar) lëshojnë vajzat e veta në shkollë të mesme, ndërsa disa nga vajzat kanë vendosur që mos ta vazhdojnë arsimin, për shkak të presionit të rrethit, edhe pse prindërit kishin inkurajuar ato. Ose, siç tha njëra nga të intervistuarat: *“ne themi “e mençur” për ato vajza që qëndrojnë në shtëpi, martohen heret dhe janë të dëgjueshme ndaj vjehrrit dhe vjehrrës, dhe për ato që dëshirojnë të mësojnë dhe të udhëtojnë, themi “nuk është e mençur”*. Gjithashtu, ato theksuan se në pjesën më të madhe të rasteve tek ata, shteti nuk zbaton gjokat e parashikuara për prindërit që nuk dërgojnë fëmijët në shkollë të mesme. Sipas dëshmimeve të këtyre grave, ato në mesin e tyre të cilat megjithatë do të vendosin të vazhdojnë arsimimin dhe pastaj kthehen, fillojnë të ndjehen si lidere dhe anëtare shumë të çmuara të bashkësisë, por megjithatë, morali i tyre përjetohet si “më i dyshimtë”. Tek të intervistuarat mbisundon mendimi i përgjithshëm se për pavarësinë ekonomike drejt së cilës shpesh çon arsimimi është e padëshiruar, sepse, siç tha njëra nga ato: *“në qoftë se gruaja fiton për jetë, ajo mund ta nënçmojë burrin dhe mund të dëshirojë të jetë mbi të”*. Një vërejtje e njëzëshme e këtyre grave është se ato familje që janë shpërngulur (ka përqindje të lartë të popullsisë së shpërngulur nga ky fshat), me shumë lehtësi pranojnë vlerat moderne të shoqërive perëndimore dhe pa asçfarë problemi po arsimohen dhe punësohen, por në fshatin e lindjes akoma vlejnë nocionet tradicionale të roleve gjinore.

Në Rajonin Lindor, gratë që janë me arsim fillor dhe janë në marrëdhënie pune, konsiderojnë se jeta e tyre është mjaft intensive, sepse punojnë me ndërrime. Për shkak të kësaj, siç theksuan ato, nuk kanë kohë të mjaftueshme që t'i përkushtohen amvisërisë, po në përgjithësi janë të kënaqura, sepse marrin rrogë të rregullt dhe kanë sigurim shëndetësor. Ato me kënaqësi kujtojnë fëmijërinë e vet, sidomos për faktin se prindërit e tyre janë përkujdesur për të gjitha. Njëjtë si ato, të intervistuarat me arsim të mesëm dhe të lartë theksuan se kanë patur fëmijëri të lumtur, që u nxit kujtime të bukura, dhe po të kishin patur mundësi, do të ishin kthyer në fëmijëri. Këto gra theksuan se po kalojnë ditën e vet me obligimet e rregullta familjare dhe të punës, ndërsa të papunësuarat po merren edhe me aktivitete bujqësore, mes tjerash. Të intervistuarat e reja theksuan se pas përfundimit të obligimeve të shtëpisë, ato po shoqërizohen me moshataret e veta.

Në përgjithësi, të intervistuarat e këtij rajoni vetë po kujdesen për obligimet e shtëpisë, madje edhe në rastet ku burrat janë të papunësuar. Përveç përkujdesit për tërë amvisërinë, tek disa gra madje edhe sigurimi i financave bie në barrën e tyre. Sipas tyre, tradita nuk ndikon jetat e tyre dhe ato nuk perceptojnë familjet e veta si tradicionale. Një pjesë e të intervistuarave janë në përgjithësi të kënaqura me rrethin ku jetojnë dhe konsiderojnë se në vendin e tyre i kanë të gjitha gjërat që u nevojiten për jetë, për dalim nga ato, disa të intervistuarat theksuan se po të kishin patur mundësi, do të kishin ndryshuar shumë gjëra në jetën e tyre, në kuptimin e vazhimit të arsimit, formimit të familjes, e ngjashëm. Në lidhje me marrëdhënien tradicionale burrë-grua, të intervistuarat konsiderojnë se në të kaluarën kishin ekzistuar rregulla shumë më të rrepta dhe se gruaja ka patur më tepër respekt nga frika ndaj burrit, ndërsa sot gratë jetojnë një jetë më të mirë, ato kanë mundësi të punësohen dhe të jenë të mëvetësishme. Në të njëjtën kohë, ato theksuan se tanimë në familje nuk ka një linjë të prerë të ndarjes së punëve midis punëve “të grave” dhe “të burrave”, por bashkëshortët po plotësojnë njëri tjetrin në kryerjen e obligimeve të shtëpisë dhe në ndarjen e buxhetit familjar.

Të intervistuarat me arsim të kryer fillor të këtij rajoni theksuan se financat kishin qenë arsyeja kryesore që ato nuk kishin vazhduar arsimin e tyre. Sipas tyre, arsimi ishte vështruar si ngarkesë e panevojshme për buxhetin familjar, për shkak të së cilës ato ishin orientuar drejt krijimit të punëve të dorës, thurjes dhe qëndisjes, të cilën e konsiderojnë më efektive dhe si një gjë që i bën të lumtura. Një pjesë e të intervistuarave më të moshuara me arsim të kryer të mesëm nuk kishin vazhduar shkollimin për arsye financiare, ndërsa njëra nga dy të intervistuarat më të reja u shpreh se akoma po mendon për vazhdim të shkollimit, ndërsa tjetra theksoi se po planifikon ta vazhdojë shkollimin, siç tha dhe vet: *“sepse me të vërtetë mëson diçka, mirëpo njeriu mëson përderisa gjallon dhe sepse dëshiron të avancohesh dhe të arrish diç më tepër, jo se pa fakultet nuk mundesh dhe nuk i kupton gjërat, por prapsepap, më mirë është me fakultet”*. Të intervistuarat që nuk kanë vazhduar shkollimin për arsye të lidhjes së martesës ndiejnë keqardhje për këtë, apo konsiderojnë se do të kishin arritur shumë më tepër në jetë po ta kishin vazhduar arsimin.

Pjesa më e madhe e grave me arsim të lartë, të cilat mbajnë vende pune që nuk përputhen me arsimin e tyre ndiejnë pakënaqësi, por megjithatë pranojnë vendin e tyre të punës për arsye të mospasjes së opsionit tjetër për të siguruar të ardhura në familje. Gratë me arsim të lartë që punojnë sipas profesionit për të cilin kanë kryer arsim, konsiderojnë veten si shumë me fat. Njëra nga të intervistuarat e këtij rajoni, në momentin kur është dashur të vendoste midis karrierës dhe familjes, ishte përcaktuar për familjen, gjë kjo për të cilën nuk kishte fituar vendin e punës në pajtim me arsimin e vet të lartë, por ishte përcaktuar të punonte në nivel të shkollës së mesme. Megjithatë, ajo konsideron se kishte bërë zgjidhjen e duhur, sepse është e kënaqur me punën aktuale.

Në përgjithësi, mund të konkludohet se pavarësisht nga përkatësia etnike, shkalla e arsimit, statusi ekonomik dhe vendin e banimit, gratë, shumë shpesh, pothuajse secilën herë, pa vetëdije “luajnë” rolet e veta të përcaktuara për nga gjinia. Duke pranuar rregullat e vendosura në mënyrë tradicionale dhe patriarkale të sjelljes dhe ndarjes së obligimeve rreth shtëpisë dhe familjes, të gjitha i pranojnë obligimet plotësuese, pa bërë përpjekje për të gjetur mënyrë që të delegojnë një pjesë të tyre dhe t’ua kalojnë anëtarëve tjerë të familjes. Pothuajse pa përjashtim, gjendja financiare është arsyeja kryesore për ndërprerjen e arsimit tek këto gra, edhe pse tek shumica e tyre kishte ekzistuar dëshira për avancim dhe edukim i plotësueshëm, në të njëjtën kohë, është kjo arsyeja kryesore për pranimin e një vendi të punës i cili nuk përputhet me nivelin ose llojin e arsimit.

Nga informacionet e marra me zbatimin e grupeve të fokusit me përfaqësuese të organizatave joqeveritare të rajoneve të targetuara që veprojnë në fushat që janë përfshirë me këtë dokument, janë marrë të dhënat më poshtë.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit të Rajonit të Pollogut theksuan se arsimi është njëra nga veglat më të rëndësishme të cilat do kishin ndihmuar vajzat në jetën e mëtejshme dhe pikërisht për këtë shteti duhet zhvilluar mekanizma me të cilat do të mundësojë krijimin e kushteve për pjesëmarrjen e fëmijëve nga të gjitha komunitetet etnike në procesin e detyrueshëm arsimor. Pjesëmarrëset e organizatave joqeveritare rome u shprehën se shumë shpesh ndodh që vajzat rome (kryesisht fëmijë) nuk kanë mundësi të kyçen në procesin arsimor, për shkak të mosekzistimit të dokumentacionit të identifikimit dhe/ose për shkak të varfërisë. Sipas pjesëmarrëseve, në përgjithësi, standardi i keq jetësor në zonat rurale është njëra nga arsytet pse vajzat po dorëzohen ose nuk përfundojnë arsimin e tyre të detyrueshëm. Sipas tyre, shumë shpesh tregojnë se nuk kanë kushte për t'i dërguar fëmijët e tyre në shkollë, nuk kanë çka t'u veshin gjatë dimrit, dhe shumë shpesh fëmijët punojnë edhe nëpër shtëpi ose në fushë, duke ndihmuar në këtë mënyrë prindërit e tyre. Siç u shprehën përfaqësueset e organizatave joqeveritare rome *"në qoftë se shkolla është larg, ndërsa të dy prindërit nuk janë në marrëdhënie pune, nuk kanë të drejtën e ndihmesës sociale, nuk kanë veshje, atëherë si ta lëshojnë fëmijën? Vallë, a duhet ai fëmijë t'i blejë vetes diç për të ngrënë? Nëse mendojmë më thellë, janë këto arsye reale. Punojnë fëmijët me prindërit e tyre, mbledhin shishe, hekur, letër, edhe kjo është një punë, kryesisht nuk vjedhin, disa shkojnë në fushë, disi kjo familje e ka patjetër të mbijetojë, të jetojë, ata nuk janë si ne që të marrin rrogë të rregullt dhe t'i planifikojnë paratë, por jetojnë nga dita në ditë"*. Pjesëmarrëset e grupit të fokusit ranë dakord se në përgjithësi, të gjithë njerëzit e rajonit, pa dallim të përkatësisë etnike udhëhiqen nga mendimi *"çka nëse kryen shkollë, kur nuk ka punë"*. Në një klimë të tillë ekonomike, ata konsiderojnë se gjoba për prindërit është një masë e cila nuk mund të funksionojë në praktikë, sepse në gjendje të papunësisë së pamasë në zonat rurale, prindërit do të duhet të shkojnë në burg, sepse nuk do jenë në mundësi t'i mbledhin mjetet financiare për ta paguar dënimin, gjë kjo e cila do të ketë ndikim plotësues në sidoqoftë, cilësisë së keqe të jetës së këtyre familjeve.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit në Rajonin Jug-Lindor ranë dakord se në përgjithësi, pozita e gruas në shoqëri dhe përfshirja e saj në procesin arsimor në masë të madhe varret nga ajo nëse familja nga e cila buron është patriarkale, e ngurtë, sepse më së shpeshi familjet e këtilla lënë anëtarët e vet femra të paedukuara, të painformuara. Siç u shprehën edhe vet: *"ekzistojnë familje krejtësisht patriarkale, ku gruaja, me vetë faktin se është grua, ajo duhet të jetë shërbëtore, ajo nuk duhet të jep përgjigje dhe të diskutojë, për këtë gjë është burri, andaj edhe ai është më i paguar. Ne patjetër duhet të punojmë në vetëdijësimin, kemi fushë të stërmadhe për veprim"*. Sipas tyre, pavarësisht nëse gratë vijnë nga qyteti apo fshati, ato duhet të inkurajohen për t'u inkuadruar në procesin arsimor, sepse nëse janë të përjashtuara nga këto procese, është shumë e lehtë që ato të privohen nga çfarëdoqoftë lirie, edhe nga liria ekonomike dhe seksuale, nga liria e lëvizjes, e ngjashëm. Pjesëmarrëset në grupin e fokusit theksuan rolin e rëndësishëm të organeve më të larta të shtetit gjatë krijimit të librave mësimorë, ose siç tha njëra pjesëmarrëse: *"një kohë ishim dëshmitarë se shteti ishte ai që na kufizonte në shkollim, në librat mësimorë që kishte miratuar vetë shteti, ai kishte lejuar që të shkruhet se gruaja është një grua vetëm kur është amvise, nëse ti fëmijën që nga mosha e hershme e mëson se suksesi i vetëm është që të jesh nënë dhe amvise, atëherë as nuk duhet të presim që ai fëmijë do të orvatet për diç më lartë se kjo, se ky fëmijë do të kërkojë të jetë gjykatëse, ose police, për të, një grua e suksesshme do të thotë të jetë amvise"*. Ato kon-

siderojnë se shteti, para së gjithash, nëpërmjet të procesit arsimor, duhet të punojë në drejtim të eliminimit të stigmatizimit të gruas dhe ndryshimit të vetëdijes në drejtim të vendosjes së barazisë gjinore. Megjithatë, ato as nuk shpërfillin dhe rolin e familjes që nga mosha më e hershme, sepse këtu vendosen themelet, ndërsa arsimimi dhe edukimi më tej vetëm mbindërtojnë këtë.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit të Rajonit Jug-Perëndimor në shumë raste cekën arsimin si faktorin kryesor për emancipimin e gjeneratave të reja. Përveç në disa rajone më të izoluara të komunës së Dibrës, ku mbizotëron mendimi se vajzat nuk kanë nevojë për arsim të mesëm, të intervistuarat tjera konsiderojnë se pikërisht me arsimimin, gratë e rajonit të tyre kishin arritur statusin e dëshiruar social dhe emancipimin, dhe me këtë dhe mundësinë e pavarësisë ekonomike. Një pjesë e pjesëmarrëseve posaçërisht theksuan dimensionin edukativ të arsimit, gjegjësisht, theksuan nevojën për arsim gjithëpërfshirës seksual, si vendimtar për parandalimin e martesave të të miturve si dhe të domosdoshme për tejkalimin e roleve gjinore tradicionale dhe përjetimin patriarkal të “nderit” të gruas si kryesore për statusin e familjes në rrethin rural.

Duke konstatuar gjendjen nëpërmjet të informacioneve të marra nga institucionet qendrore dhe lokale, intervistave të realizuara me gra të zonave rurale, si dhe nëpërmjet të grupeve të fokusit të përbëra nga përfaqësuese të OJQ, konsiderojmë se nevojitet krijimi i politikave dhe masave të përshtatshme ndaj nevojave dhe problemeve të grave të zonave rurale, nëpërmjet të cilave do të promovohen përfitimet dhe benefitet e arsimit për jetat e vajzave. Në të njëjtën kohë, në disa rajone të caktuara duhet mundësuar qasje më të mirë për gratë në institucionet arsimore, sidomos me sigurimin e zbatimit të masës së transportit falas për nxënësit. Duke patur parasysh se qasja në arsim është identifikuar si një nga pengesat për ndërprerje ose mosvazhdim të procesit të arsimimit, duhet menduar edhe rreth investimit në lloje alternative të arsimimit të grave që jetojnë në zonat rurale, siç janë, për shembull “qendrat e mësimi në distancë”. Në pajtim me informacionet e marra dhe të identifikuara nga gratë e intervistuarat, konsiderojmë se përmirësimi i qasjes së grave në nivelet e mesme dhe të larta të arsimit, do të kishte patur ndikim pozitiv mbi jetën e tyre dhe mirëqenien e përgjithshme. Fitimi i nivelit më të lartë të arsimit po i rrit gjasat e grave për punësim formal dhe pavarësi ekonomike, që në të njëjtën kohë do të kishte kontribuar për vendosje më të madhe të barazisë gjinore. Zhvillimi i programeve për aftësim profesionist të vajzave dhe grave të cilat në rini nuk kishin vazhduar arsimin e vet, do të kishte kontribuar për hapjen e mundësive për edukim plotësues të tyre, gjë kjo e cila do të mund të kontribuojë për punësimin e tyre, sigurimin e të ardhurave më të larta, si dhe pjesëmarrje më efektive në shoqëri. Programet e këtilla do t’u mundësojnë vajzave dhe grave avancim, gjë kjo e cila do të ndikonte edhe mbi aftësimin e tyre në profesione të cilat perceptohen si tradicionalisht “mashkullore”, si dhe mbi avancimin e tyre në karrierë.

Shëndetësia

Në Ligjin e Sigurimit Shëndetësor⁶⁷ në Nenin 5, në 15 alinea është përcaktuar se cilat kategori janë të domosdoshme për t'u siguruar, gjegjësisht, cilët të siguruar i nënshtrohen Ligjit të Sigurimit Shëndetësor. Kështu, mes tjerash, detyrueshëm sigurohet bartësi i ekonomisë bujqësore familjare i kategorisë së dytë dhe të tretë*, që është në pajtim me Ligjin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural⁶⁸, si dhe një person perkohësisht i papunësuar përderisa po pranon kompensim financiar nga sigurimi në rast papunësie. Në Nenin 8 të Ligjit përcaktohet se me sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, personave të siguruar u shërbime elementare shëndetësore nën kushtet e përcaktuara me këtë Ligj, të cilat nënkuptojnë shërbime në: a) në mbrojtjen shëndetësore primare: 1) shërbime shëndetësore për përcaktim, ndjekje dhe kontrollim të gjendjes shëndetësore; 2) marrja e masave profesionale mjekësore dhe e procedurave për avancim të gjendjes shëndetësore, parandalim, çrrenjosje dhe zbulim të hershëm të sëmundjeve dhe çrregullimeve tjera të shëndetit; 3) dhënie të ndihmës emergjente mjekësore, duke përfshirë këtu dhe transportin me automjetin sanitar kur është e nevojshme; 4) mjekim në ordinancë, apo në shtëpinë e shfrytëzuesit; 5) mbrojtje shëndetësore në lidhje me shtatzënësi dhe lidnje; 6) zbatim të masave parandaluese, terapeutike dhe të rehabilitimit; 7) parandalim, mjekim dhe trajtim të sëmundjeve të gojës dhe të dhëmbëve, dhe 8) barëra sipas listës së barërave të cilat me akt të përgjithshëm përcakton Fondi të cilit Ministri i Shëndetësisë i jep pëlqimin e vet; b) në mbrojtjen shëndetësore specialistike-këshilluese: 1) ekzaminim dhe përcaktim të sëmundjeve, lëndimeve dhe gjendjes shëndetësore; 2) zbatim të procedurave specialistike, diagnostike, terapeutike dhe të rehabilitimit, dhe 3) proteza, mjete ndihmëse ortopedike dhe të tjera, pajisje ndihmëse dhe sanitare, si dhe materiale dhe mjete të teknikës së dhëmbëve, sipas udhëzimeve të përcaktuara me akt të përgjithshëm të Fondit të cilit Ministri i Shëndetësisë i jep pëlqimin e vet; c) në mbrojtjen shëndetësore në spital (afatshkurtër dhe afatgjatë: 1) ekzaminimi dhe përcaktimi i gjendjes shëndetësore, mjekimi, rehabilitimi, kujdesi, sistemimi dhe ushqyerja në kushte spitali; 2) barëra sipas listës së barërave të cilat me akt të përgjithshëm të cilin përcakton Fondi të cilit Ministri i Shëndetësisë i jep pëlqimin e vet, si dhe materiale ndihmëse që shërbejnë për aplikimin e barërave dhe materialeve sanitare dhe materialeve tjera të nevojitura për trajtim, dhe 3) sistemimi dhe ushqyerja e shoqëruesit gjatë shoqërimit të domosdoshëm të fëmijës deri në moshën tre-vjeç, përderisa është në trajtim spitali, por më së shumti deri 30 ditë dhe ç) autopsia e të vdekurve me kërkesë të institucioneve shëndetësore⁶⁹. Ligji poashtu rregullon se në bazë të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor të të siguruarit, ofrohet edhe sigurimi i detyrueshëm shëndetësor i anëtarëve të familjes së tij.

Shëndeti i grave është posaçërisht i rëndësishëm sepse me atë përcaktohet edhe shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve të tyre dhe të bashkësive të tyre. Gratë nga zonat rurale, pavarësisht nëse janë të punësuara ose nëse ato dhe familjet e tyre po merren

67 Ligji i Sigurimit Shëndetësor, teksti intern i konsoliduar, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 65/2012, 16/2013 dhe 91/2013, i disponueshëm në: <http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon>

*Bartës i ekonomisë bujqësore familjare është një person i rritur i cili është përgjegjës për menaxhimin e ekonomisë bujqësore dhe i cili paraqitet në emër dhe për llogari të ekonomisë bujqësore familjare dhe si i tillë është regjistruar në Regjistrin e Vetëm të Ekonomive Bujqësore në Ministri

68 Ligji i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, teksti i konsoliduar, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 49/2010; 53/2011, 126/2012, 15/2013 dhe 69/2013, i disponueshëm në: http://www.mzsv.gov.mk/files/Zakon_za_zemjodelstvo_i_ruralen_razvoj_0.pdf

69 Ligji i Sigurimit Shëndetësor, teksti intern i konsoliduar, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 65/2012, 16/2013 dhe 91/2013, i disponueshëm në: <http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon>

me veprimtari bujqësore, mund ta realizojnë të drejtën e vet për sigurim shëndetësor, dhe me këtë dhe mundësinë e këqyrjeve të rregullta dhe parandaluese shëndetësore. Megjithatë, një pjesë e madhe e grave rurale në Republikën e Maqedonisë, për shkak të qasjes së kufizuar në informacione mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre për shfrytëzim të shërbimeve shëndetësore, duke përfshirë këtu këshillimet dhe planifikimin e familjes, në vend se të parandalojnë gjendje të caktuara, ato vizitojnë mjekun sipas nevojës, madje pasi që të shfaqen probleme të caktuara shëndetësore. Mosekzistimi i një infrastrukture përkatëse, i transportit publik dhe efikas, si dhe resurset e pamjaftueshme që kanë në dispozicion këto gra, vetëmse shton izolimin e tyre dhe kufizon mundësitë e tyre për qasje të lehtë, të shpejtë dhe të sigurt në institucionet shëndetësore, ku do të kishin marrë shërbimet shëndetësore përkatëse.

Në lidhje me këtë problem që është detektuar edhe në vende tjera të Evropës, në Raportin mbi Gratë Rurale në Evropë⁷⁰, Këshilli i Evropës rekomandon që vendet t'i sigurojnë zonat rurale me transport cilësor, përkujdesje dhe shërbime mjekësore, duke përfshirë këtu dhe fushën e shëndetit riprodhues dhe planifikimit të familjes. Në të njëjtën kohë, po inkurajohen shtetet për të siguruar klinika shëndetësore lëvizëse, të cilat do të vizitojnë edhe vendet më të largëta rurale dhe do të sigurojnë edukimin në tema të ndryshme shëndetësore, ndërsa do të ofrojnë edhe mbrojtje shëndetësore përkatëse për të gjitha gratë në vendin e ngjarjes.

Në vitin 2012 në Republikën e Maqedonisë filloi fushata për ekzaminimin e kancerit në grykën e mitrës, me të cilën parashikohej Testi PAP falas tek gjinekologu i përzgjedhur amë. Kjo fushatë, përveçse kishte për qëllim parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve malinje gjinekologjike, ajo njëkohësisht ndikonte ndërgjegjësimin e grave mbi nevojën për përzgjedhje të gjinekologut amë. Sipas Programit mbi Detektimin e Hershëm të Sëmundjeve Malinje në Republikën e Maqedonisë në vitin 2017⁷¹, “në nivel të tërë shtetit, për gratë që kishin përzgjedhur gjinekologun amë, ekzaminimin do ta kryenin gjinekologët e ISHP, në pajtim me qëllimet parandaluese të përcaktuara nga FSSHM: këqyrje gjinekologjike, marrje të mostrës, përgatitje dhe dërgim të materialit për analizë citologjike”⁷². Qëllimi i këtij procesi është parandalimi i sëmundjes, si dhe reduktimi i vdekjes tek gratë nga kanceri në grykën e mitrës, për të cilën nevojitet inkuadrimi i gjithë gjinekologëve amë në ekzaminimin dhe në detektimin e hershëm të kësaj sëmundjeje, si dhe ndërgjegjësimi i grave mbi rëndësinë e këqyrjeve të rregullta gjinekologjike dhe testeve PAP.

Për të marrë të dhëna konkrete statistikore për atë se sa gratë shfrytëzojnë shërbime shëndetësore, me vështrim në këqyrjet e rregullta gjinekologjike dhe në testimet PAP, nukri i rasteve të evidentuara të lindjes, spontane ose lindjeve të shkëputura qëllimisht tek vajzat e mitura, si dhe në numrin e rasteve të evidentuara të intervenimeve pas ndërprerjes joprofesionale të shtatzënisë në komunat e targetuara, u dërgua një kërkesë për qasje në informacione me karakter publik në Ministrinë e Shëndetësisë. Fatkeqësisht, deri në përfundimin e përpilimit të këtij dokumenti, nuk pranuan përgjigje nga ata.


70 Rural women in Europe" - Committee on Equal Opportunities for Women and Men Rapporteur: Ms Carmen Quintanilla Barba, Spain, EPP/CD 2010

71 http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/PROGRAMA_ZA_RANA_DETEKCIJA_NA_MALIGNI_ZABOLUVANA_VO_RM_ZA_2017_GODINA.pdf

72 Programi për Detektim të Hershëm të Sëmundjeve Malinje në Republikën e Maqedonisë për vitin 2017, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 192 i datës 17.10.2016, fq.1

Nga të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave të disponueshme nëpërmjet të MAKStat – baza e të dhënave⁷³ të dhëna në Grafikon 8, mund të vërehet se në rajonet e targetuara numri i nënave të reja në moshë nga 15 deri 19 vjeç po lëviz kryesisht brenda kufirit të 16 lindjeve për vit, përveç në rastin e komunës së Radovishit, ku kemi një numër konsiderueshëm më të lartë të nënave të reja, madje deri 32 në vitin 2014. Për fat të keq, ndonëse grupmosha sipas të cilës po mbahen të dhënat statistikore po lëviz nga 15 deri 19 vjeç, nga ato nuk mund të merret një informacion adekuat se sa nga nënat e reja kanë qenë të mitura në çastin e lindjes. Në të njëjtën kohë, janë tronditëse të dhënat që prezantojnë se në komuna të caktuara: Karbincë dhe Konçë në vitin 2016 dhe në Radovish në vitet 2015 dhe 2016, kur kishte patur nga një nënë të re nën moshën 15 vjeç.

Grafiku 8



Për të marrë të dhëna të caktuara kualitative të cilat duhej të ofronin vështrim në perceptimin e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) ndaj çështjeve të ndryshme të cilat lidhen me (mos)shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore nga gratë e zonave rurale, u zbatua një intervistë me një përfaqësuese të Ministrisë. Ajo u shpreh se nuk ekziston një sistem i posaçëm i evidencës në Ministri, i ndarë sipas vendbanimit të shfrytëzuesve (shfrytëzuesve) të shërbimeve, e as nuk është zhvilluar ndonjë analizë e programeve që po zbatohen konform këtij kriteri. Sipas saj, Instituti i Shëndetit Publik po grumbullon të dhëna të caktuara, por megjithatë ka një evidencë shumë të dobët se sa gra nuk kanë qasje në shërbime shëndetësore, sepse një analizë e tillë kurrë nuk ishte zhvilluar. Siç theksuan përfaqësuesit e Ministrisë, ata po kërkojnë mënyrë se si të fillohet me mbajtjen e një lloji të tillë të statistikës, sepse, sipas tyre, është bërë një ngatërrësë me futjen në përdorim të Sistemit Kombëtar për Evidenca Elektronike në shëndetësi, apo më i njohur si “termini im”⁷⁴, sepse shëndetësia elektronike grumbullon të dhënat e pacientëve, ndërsa Instituti i Shëndetit Publik është i detyruar për evidencën. Nga Ministria konsiderojnë se mbulimi me shtëpi shëndetësore mjafton, sepse janë rreth 40 shtëpi shëndetësore lokale në territorin e tërë shtetit. Megjithatë, sipas tyre, nevojitet shfrytëzimi më i mirë i kapaciteteve njerëzore, koordinimi më i lartë dhe rrjetëzimi i shtëpive shëndetësore, qendrave të shëndetit publik dhe spitaleve të përgjithshme, ku ata nuk do të punojnë në mënyrë të pavarur secili në fushën e vet, por me koordinim përkatës, do të mundësohet që të gjithë sfidat të detektohen lehtë dhe të propozohen mënyra për tejkalimin e tyre. Në lidhje me sigurimin e shërbimeve gjinekologjike, përfaqësuesja e Ministrisë konsideron se aparate për eho 3D ka mjaftueshëm dhe se

73 http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Naselenie__Vitalna/125_VitStat_Op_RodVozMajk_mk.px/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef

74 <http://mojtermini.mk/>

gjithkund ka shërbim patronazhi, por megjithatë mungon koordinimi me gjinekologët amë, dhe poashtu jo të gjitha shtëpitë shëndetësore kanë gjinekolog. Ose, siç theksoi ajo *“ne definitivisht kemi humbur lidhjen me gjinekologët amë, ata nuk janë në sistemin e koordinimit, nuk kanë detyrë të referojnë në MSH, relacioni i tyre po lidhet më tepër me Fondin”*. Sipas saj, ata deri më tani ishin treguar si partner i paiteresuar për zbatim të veprimeve që janë politika të qeverisë, sepse Ministria nuk paska gjetur mënyrë t’i motivojë, e as të realizojë një bashkëpunim përkatës. Prandaj, dëmin më të madh e pësojnë gratë rurale, të cilat nuk kanë përzgjedhur gjinekologun amë, sepse nuk ekziston një mekanizëm përkatës që ato të ftohen për të bërë teste PAP falas, që është përcaktuar me ligj, në shtëpitë shëndetësore lokale. Në të njëjtën kohë, “të dhënat e Fondit të Shëndetësisë tregojnë se numri i gjinekologëve amë arrin 144, nga të cilët 43 janë në Shkup, por sipas analizave të organizatave joqeveritare, madje edhe të Qeverisë së kaluar, mungojnë edhe 150 gjinekologë amë”⁷⁵.

Për fat të keq, Ministria e Shëndetësisë nuk mban evidencë për atë se sa gratë rurale shfrytëzojnë shërbime gjinekologjike (siç janë këqyrjet e rregullta, testet PAP, e ngjashëm), por në bisedë me ne, ata informuan se të dhëna të këtij lloji ka në dispozicion Instituti i Shëndetëtit Publik dhe sipas tij, shërbimet e këtilla nuk po shfrytëzohen mjaftueshëm as nga gratë e zonave urbane, sepse dijenia për përzgjedhjen e gjinekologut amë është në nivel shumë të ulët. Informacionet e gërshetuara në Raportin mbi realizimin e detyrave të programit sipas Programit Kombëtar Vjetor të Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016, tregojnë se vizita e këshillimoreve për shëndet seksual dhe riprodhues po shënon trend të rënies në disa vitet e fundit. “Njëra nga arsyet kryesore për vizitën e dobët të këshillimoreve është edhe paqasshmëria e hapësirave përkatësisht të pajisura për këtë qëllim, mungesa e stafit profesional dhe shërbimet e paqasshme të gjinekologut”⁷⁶. Në vendet e vogla, si arsye shtesë për vizitën e dobët, në Raport shënohet dhe orari i punës së këshillimores, i cili nuk siguron diskrecion përkatës për ata njerëz që dëshirojnë ta vizitojnë. Nga Ministria thanë se kishin bërë përpjekje për të siguruar një gjinekolog dhe motër medicinale në orët e pasdites, për gratë e zonave rurale ose për ato që janë me status të ulët social dhe akoma nuk kanë përzgjedhur një gjinekolog amë, por fatkeqësisht kjo nuk kishte funksionuar në praktikë, sipas tyre, me më shumë gjasa sepse nuk ishte përpunuar mirë. Ata konsiderojnë se numri i gjinekologëve dhe shpërndarja e tyre në Republikën e Maqedonisë paraqet problemin më të madh për momentin, sepse mungojnë gjinekologë si për kujde neonatal ashtu dhe për kujdes të nënave, ndërsa gjinekologët privatë, që kanë firmosur kontratë me Fondin, janë jashtë sistemit dhe Ministria nuk mund t’i detyrojë me asgjë. Sipas tyre, një nga mënyrat në të cilat mund të arrihen gratë e zonave rurale ose të kategorive të cenueshme janë klinikat gjinekologjike lëvizëse. Të tilla për momentin janë tre, njëra nga HERA, dy nga UNFPA, që janë fituar gjatë krizës së migrantëve, dhe tani i janë dhënë shtetit për përdorim. Ato gjenden në spitalet në Gjevgjeli dhe Kumanovë, sepse aty ishin vendosur qendrat e tranzitimit. Nga Ministria konsiderojnë se me organizim të mirë dhe shpërndarje të gjinekologëve, si dhe me kompensim përkatës për angazhim plotësues, nëpërmjet të këtyre klinikave lëvizëse mund të sigurohet të paktën fillimi i shërbimit për gratë nga zonat vështirë të qasshme dhe rurale.

Edhe pse shtëpitë shëndetësore lokale që kanë dhoma të lindjes, gjithsej 9 në territorin e Republikës së Maqedonisë, kanë për obligim të evidentojnë dhe të informojnë

75 <http://www.mojmaticengjinekolog.com/>

76 Raporti mbi realizimin e detyrave programike në pajtim me Programin Kombëtar Vjetor për Shëndet Publik të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016, fq. 6, pjesa e tretë, i disponueshëm në: <http://iph.mk/wp-content/uploads/2017/05/tret-del-2016-izvestaj.pdf>, qasur për herë të fundit më 11.12.2017

Ministrinë për raste të lindjeve tek vajzat e mitura, prapsepap nga Ministria thonë se nuk kanë informacione për raste të tilla në 3 vitet e fundit. Në të njëjtën kohë, shtëpitë shëndetësore lokale që kanë dhoma të lindjes nuk kanë për detyrë ta informojnë Ministrinë për raste të shtatzënësisë sponatene ose të ndërprerë me qëllim tek vajzat e mitura. Sipas njohurive të Ministrisë, abortet e këtilla po bëhen në shtëpi shëndetësore private, ndërsa Inspektorati Shëndetësor dhe Sanitar, Fondi i Shëndetësisë dhe komisionet profesionale të Ministrisë po bëjnë kontrolle vetëm pas rastit të evidentuar, më së shpeshi në rast se gjendja komplikohet, andaj këto vajza i dërgojnë në Klinikën e Gjinekologjisë dhe Obstetrisë.

Nga Ministria bëjnë të ditur se fatkeqësisht masat që po ndërmerren me qëllim për mirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore për gratë rurale janë më së shpeshi aktivitetet “ad hoc” për zgjidhje të problemeve. Nuk ka një program përkatësisht të përpunuar, dhe për momentin shprehen se nuk kanë para për realizim. Konsiderojnë se duhet të parashikohen aktivitetet sipas programeve dhe ato duhet të planifikohen sistematikisht dhe mirë. Sipas tyre, për momentin mund të shfrytëzohen tre klinikat gjinekologjike lëvizëse dhe të fitohet mbulim më ilartë në qoftë se hartohet një plan i mirë i vizitave të zonave më të largëta; ose të stimulohen gjinekologët në zonat rurale me pagesë më të lartë për pacient dhe me trajtim më të mirë. Ata konsiderojnë se duhet të definohen qëllime të reja me Fondin e Shëndetësisë, si vijon:

1. Masa e parë të jetë rritja e numrit të gjinekologëve;
2. Masa e dytë të jetë bërja e shpërndarjes përkatëse të rrjetit, për të shmangur situata ku ka përqëndri të lartë të gjinekologëve në një zonë, përderisa po mungojnë në zonë tjetër, apo më të vogël;
3. Masa e tretë të jetë stimulimi plotësues i gjinekologëve që dëshirojnë të punojnë në zona vështirë të qasshme dhe rurale.


Nga informacionet e marra me anë të pyetësorit anketues të dërguar në gjithsej 6 shtëpi shëndetësore lokale që mbulojnë rajonet e targetuara, janë grumbulluar të dhënat më poshtë.

Nga ISHP Shtëpia e Shëndetit Tetovë, bëjnë të ditur se nuk posedojnë informacione mbi numrin e shërbimeve të shfrytëzueara shëndetësore nga gra, sepse informacione të tilla kanë në dispozicion vetëm gjinekologët amë që janë privatizuar, gjegjësisht, janë koncesionerë të ISHP Shtëpia e Shëndetit Tetovë. Për momentin janë 4 gjinekologë amë dhe 27 motra patronazhi. Nga Shtëpia e Shëndetit bëjnë të ditur se në vitin 2014 është evidentuar një rast i lindjes së një vajze të mitur (17 vjeç) e komunitetit etnik maqedonas, me vendbanim në Komunën e Jegunocit. Për çështjet tjera lidhur me rastet e evidentuara të ndërprerjes spontane apo me qëllim të shtatzënësisë, të ndara sipas moshës së pacienteve dhe përkatësisë etnike; janë evidentuar raste të intervenimeve të bëra pas shtatzënësisë së ndërprerë në mënyrë joprofesionale, janë evidentuar raste të shfrytëzimit të testeve falas PAP të përcaktuara me ligj, si dhe raste të evidentuara të këqyrjeve të rregullta sitematike të grave, nga Shtëpia e Shëndetësisë bëjnë të ditur se ata nuk kanë në dispozicion të dhëna të këtilla, gjegjësisht, se ato janë në posedim të mjekëve amë dhe të Spitalit Klinik të Tetovës.

Nga ISHP Shtëpia e Shëndetit Shtip bëjnë të ditur se në bazë të informacioneve që ata kanë në dispozicion, e të cilat kanë të bëjnë me shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore nga gra me vendbanim në Komunën e Karbincës, në 3 vitet e fundit gjendja është

si më poshtë. Në vitin 2014 gjithsej 192 shërbime shëndetësore janë shfrytëzuar nga gra të komunitet etnik turk, në vitin 2015 ky numër bie dhe arrin gjithsej 175, ndërsa në vitin 2016 po shënohet rritje në numrin e shërbimeve të shfrytëzuara shëndetësore në Shtëpinë e Shëndetit në Shtip, dhe ky numër arrin gjithsej 238 shërbime. Në qoftë se vështrohen të dhënat që kanë të bëjnë me shëndetin seksual dhe riprodhues, si dhe me shfrytëzimin e shërbimeve gjinekologjike të dhëna në Grafikon 9, mund të vërehet rritje në numrin e vizitave të patronazhit, që tregon për rritjen e numrit të nënave të reja, dhe njëkohësisht ka reduktim të numrit të të pranishmëve në ligjeratat në temën e shëndetit seksual dhe riprodhues. Në këtë Shtëpi Shëndeti janë punësuar gjithsej 7 motra patronazhi.

Grafiku 9



Informacionet e marra janë ndarë sipas grupmoshave, ku grupmosha më e re përfshin vajza nga 15 deri 19 vjeç, për shkak të së cilës nuk mund të fitohet informacioni i saktë se sa nga nënat e reja të vizituara nga shërbimet e patronazhit kanë qenë të mitura. Megjithatë, nga të dhënat e grumbulluara dhe të prezantuara në Grafikon 10, mund të vërehet një rritje e konsiderueshme e shfrytëzimit të këtij shërbimi në 3 vitet e fundit.

Grafiku 10



Për çështjet tjera në lidhje me rastet e evidentuara të shtatzënisë së ndërprerë në mënyrë spontane dhe të ndërprerë me qëllim, të ndarë sipas moshës së pacienteve; janë evidentuar raste të intervenimeve të bëra pas shtatzënisë së ndërprerë joprofessionalisht, janë evidentuar raste të shfrytëzimit të testeve PAP falas të përcaktuara me ligj, si dhe janë evidentuar raste të këqyrjeve të rregullta sistematike të grave, nga Shtëpia e Shëndetit informojnë se ata nuk kanë në dispozicion këto të dhëna, apo se këto të dhëna janë në posedimin e mjekëve amë dhe të Spitalit Klinik të Shtipit.

Nga ISHP Shtëpia e Shëndetit Dibër, bëjnë të ditur se nuk kanë numër të shërbimeve shëndetësore të shfrytëzuara nga gra të ndara sipas moshës dhe përkatësisë etnike të pacienteve. Ata poashtu informojnë se nuk kanë një Shërbim Këshillues Specialist dhe nuk kanë gjinekolog, gjëra këto për të cilat nuk kanë përgjigje në asnjërën nga pyetjet e parashtruara në kërkesën tonë. Nga informacionet mediatike⁷⁷, mund të shihet se në Njësinë Gjinekologjike Dibrane është vetëm një gjinekolog privat të cilin vizitojnë gratë edhe nga komunat fqinje rurale, ndërsa ato për lindje udhëzohen në Strugë, ose për rastet më të rënda – në Shkup.

Nga ISHP Shtëpia e Shëndetit Koçan bëjnë të ditur se në kuadër të Shtëpisë vepron një shërbim patronazhi i përbërë nga 7 motra patronazhi që mbulojnë komunat e targetuara. Ata njëkohësisht bëjnë të ditur se për arsye të mungesës së bazës së të dhënave, si dhe për faktin se në kuadër të Shtëpisë nuk ka një ambulance gjinekologjike, e as njësi gjinekologjiko-obstetrike dhe pasi që nuk kanë gjinekologë të punësuar, nuk janë në gjendje t'i përgjigjen kërkesës sonë.

Nga ISHP Shtëpia e Shëndetit Ohër bëjnë të ditur se kanë 10 motra patronazhi të punësuar në Shtëpi, por edhe se nuk kanë gjinekologë të punësuar, sepse po merren me mbrojtje shëndetësore primare. Ata informojnë se nuk kanë në dispozicion informacionet e kërkuara dhe konsiderojnë se ato informacione janë në posedim të Qendrës së Shëndetit Publik të Ohrit.

Nga ISHP Shtëpia e Shëndetit Radovish bëjnë të ditur se nuk kanë dhomë të lindjes, nuk kanë gjinekolog të punësuar, si rezultat të privatizimit të gjinekologëve. Ata informojnë se këqyrjet e rregullta sistematike gratë e kësaj komune i kryejnë tek gjinekologët amë, për shkak të së cilës Shtëpia e Shëndetit nuk ka në dispozicion të dhëna të hollësishme. Në të njëjtën kohë, nga kjo Shtëpi e Shëndetit bëjnë të ditur se kanë 5 motra patronazhi të punësuar.

Nga informacionet e marra me bërjen e intervistave me gra të komuniteteve të ndryshme etnike, me shkallë të ndryshme të arsimit dhe me status të ndryshëm ekonomik në rajonet e targetuara, janë marrë të dhënat më poshtë, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre shëndetësore.

Në Rajonin e Pollogut, sigurimin shëndetësor kryesisht mbajnë gratë, por bartësi i sigurimit ndryshon, në varësi nga statusi i punësimit të grave, pavarësisht nga arsimit. Ato gra që nuk punojnë, më së shpeshi kanë sigurim shëndetësor ose përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë (APRM) ose përmes ndonjë anëtari tjetër të familjes (babai për të pamartuarat, bashkëshorti për të martuarat), ndërsa gratë që janë të punësuar, më së shpeshi janë të siguruara nëpërmjet të firmave ku punojnë.

Njëra nga gratë e intervistuar e komunitetit etnik rom theksoi se për shkak të ndërlikueshmërisë së procedurës së realizimit të së drejtës së sigurimit shëndetësor përmes APRM, apo nevoja për paraqitje mujore, ajo kishte vendosur se për të ishte më e pagueshme ta fshijnë nga evidenca e kërkuesve aktiv të punës, sepse e ka më mirë të mjekohet privatisht, në qoftë se ka nevojë. Ajo theksoi se për shkak të mosbesimit të institucioneve shëndetësore shtetërore dhe sjelljes së tyre ndaj komunitetit rom, ajo shfrytëzon shërbime shëndetësore vetëm në institucionet private. Ose, siç thotë vetë ajo: *“po trajtohem privatisht, sigurisht nëse ke një sëmundje më serioze, do të shkosh në institucion privat që të të këqyrin si duhet, sepse në institucionet publike, romët janë shumë të diskriminuar”*.

77 <http://www.libertas.mk/debar-reka-i-tsentar-zhupa-ostanaa-so-samo-eden-gjinekolog/>

Informacionet që morëm treguan se vetëdija për shfrytëzimin e rregullt të shërbimeve shëndetësore gjendet në nivel shumë të ulët, madje edhe tek gratë me arsim të lartë. Shërbimet shëndetësore të mjekëve amë pothuajse të gjitha gratë i shfrytëzojnë rrallë, vetëmse nëse ndiejnë nevojë. Fatkeqësisht, në disa nga lagjet më të vogla as nuk ka mjek amë, andaj gratë duhet të shkojnë në lagjet më të mëdha, që i nënshtron ndaj shpenzimit të plotësueshëm financiar, shpenzim të kohës dhe angazhim plotësues. E ngjashme është dhe gjendja me shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore dytësore (shërbime gjinekologjike dhe stomatologjike). Sipas të dhënave të marra mund të konkludohet se gratë e këtij rajoni, pavarësisht nga përkatësia etnike dhe shkalla e arsimit, shumë pak shfrytëzojnë testet gjinekologjike falas, edhe pse disa nga ato theksuan se vazhdimisht po informohen nga mjekët e tyre amë për nevojën e bërjes së testit PAP. Si pjesë e problemit të identifikuar nga vetë të intervistuarat është mosekzistimi i gjinekologut në zonat rurale, apo largësia e tij, dhe kështu, gratë e zonave rurale, për të shfrytëzuar shërbime gjinekologjike e kanë patjetër të udhëtojnë për në qytetin më të afërt (në rastin e këtij rajoni, në Tetovë apo Gostivar). Kjo shpesh paraqet problem për ato, sepse, duke patur parasysh se nuk ka transport publik të organizuar mirë, dhe shfrytëzimi i shërbimeve taksit është tepër i shtrenjtë për ato. Në të njëjtën kohë ato theksuan se jo çdoherë kanë besim në institucionet shëndetësore shtetërore, gjë kjo për të cilën nganjëherë përcaktohen ose të shkojnë në institucionet më të mëdha private gjinekologjike (më së shpeshi në Shkup) ose të vizitojnë një mjek/e të cilin/ën njohin personalisht dhe kjo më së shpeshi ndodh kur tanimë kanë ndonjë problem.

Gratë me arsim fillor të Rajonit Jug-Perëndimor kryesisht janë shumë pak të informuara për këqyrjet falas gjinekologjike dhe për testet PAP të cilët u takojnë në bazë të Programit të Detektimit të Hershëm të Sëmundjeve Malinje. Tek ato mund të vërehet një mosbesim evident në sistemin shëndetësor, ndërsa njëra nga të intervistuarat ishte kategorike dhe kërkoi të citohej deklarata e saj *“të gjithë në shëndetësi janë të korruptuar, me përjashtim të një pjese të vogël të personelit mjekësor”*. Veç kësaj, tek këto gra mund të vërehet dhe një druajtje e caktuar nga shfrytëzimi i këtyre shërbimeve, sidomos tek gratë që akoma nuk kanë fëmijë, për shkak të stigmatizimit nga rrethi si gra *“amorale”* në qoftë se shfrytëzojnë shërbime gjinekologjike përpara shtatzënësisë (e cila nënkupton se janë të *“çnderuara”*). Gratë që tanimë kanë lindur nuk ballafaqohen me gjykim aq të vrazhdë të rrethit. Më sa duket, ndryshimet e Ligjit mbi Abortin e vitit 2013 nuk i prekin këto gra fare dhe si pasojë, nuk janë shumë të informuara për ato, sepse ndërprerja e shtatzënësisë po shtjellohet njëjtë si më parë – gjegjësisht konsiderohet si *“i lejuar”* në qoftë se gruaja tanimë kishte lindur tre fëmijë. Gjithashtu duhet të theksohet dhe mosbërja e dallimit midis abortit të ligjshëm dhe të kundërligjshëm tek gratë e këtij rajoni, sepse të gjitha të intervistuarat konsideronin se aborti që kryhet në një ordinancë private nga një mjek specialist me çmim (më të shpeshtë) nga 500 euro, pa këshillimet e detyrueshme dhe kufizimet tjera të parashikuara me Ligjin e Abortit është i ligjshëm, përkundër *“të paligjshmëve”*, të cilët do të ishin kryer në kushte shtëpie nga persona të pakualifikuar. Për dallim nga ato, të intervistuarat me arsim të mesëm dhe të lartë kanë njohuri të qëndrueshme mbi mundësitë e shfrytëzimit të sigurimit shëndetësor dhe rregullisht shfrytëzojnë këqyrjet mjekësore parandaluese.

Në Rajonin Lindor të intervistuarat, pavarësisht nga niveli i arsimit, theksuan se kanë sigurim shëndetësor, janë të njohura me mundësitë që ai ofron, rregullisht bëjnë këqyrje mjekësore në vendbanimet e tyre, dhe sipas nevojës, në qytetin më të afërt. Në të njëjtën kohë, ato theksuan se më rrallë shfrytëzojnë shërbime gjinekologjike.

Në përgjithësi mund të konkludohet se pavarësisht nga përkatësia etnike, shkalla e arsimimit, statusi ekonomik dhe vendi i banimit, gratë jo mjaftueshëm shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore parandaluese, sidomos shërbimet gjinekologjike dhe testin PAP. Mospasjen e gjinekologut në komunën vetjake, këto gra e konsiderojnë si pengesë serioze për qasjen në shërbimet shëndetësore gjinekologjike, sepse kjo gjë i nënshtron ndaj shpenzimit të resurseve plotësuese (kohës, financave, e ngjashëm), gjëra këto të cilat ato jo çdoherë janë të gatshme ta ndajnë, sidomos për kontrolle parandaluese dhe në qoftë se nuk kanë ndonjë problem më serioz shëndetësor.

Nga informacionet e grumbulluara me zbatimin e grupeve të fokusit me përfaqësuese të organizatave joqeveritare të rajoneve të targetuara, të cilat veprojnë në fushat që janë përfshirë me këtë dokument, janë fituar të dhënat më poshtë, që kanë të bëjnë me mbrojtjen shëndetësore të grave.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit në Rajonin e Pollogut konsiderojnë se gratë e këtij rajoni kryesisht nuk shfrytëzojnë shërbime të rregullta gjinekologjike, e as nuk bëjnë teste të rregullta PAP. Sipas tyre, me rëndësi të madhe është edukimi, sidomos në fshatrat e largëta rurale, ku kontakti i drejtpërdrejtë me gjinekologun i cili sqaron rëndësinë e këqyrjeve të rregullta dhe testeve PAP në procesin e parandalimit dhe pengimit të kancerit të mitrës është vendimtar, sepse është vërejtur se pas vizitave të këtitilla, gjithnjë e më tepër po rritet numri i grave që vizitojnë gjinekologun. Ato theksuan se për fat të keq, Shtëpia e Shëndetit dhe shërbimi i patronazhit në Tetovë nuk kanë mbulim mjaftueshëm përkatës të tërë rajonit dhe se nuk kryejnë funksionin ashtu si do të duhej ta kryenin, sepse nuk i ndjekin gratë gjatë procesit të shtatzënisë që nga fillimi e deri në fund, duke patur parasysh edhe kushtet në të cilat jetojnë ato gra. Përfaqësueset e organizatave rome theksuan *“ne shpesh na drejtohen gra që kanë hasur në qasje të keqe nga gjinekologët, sidomos ato që nuk kanë dokumente personale, sepse kur nuk ke dokumentacionin, nuk mund të gëzosh asnjë të drejtë”*. Sipas tyre, jo të gjitha gratë që kanë hasur në trajtim të keq nga mjeku po kërkojnë ndihmë. Për shkak të jetës në familje patriarkale dhe për shkak të trajtimit në përgjithësi të keq me të cilin po përballen këto gra në jetën e përditshme, për disa nga ato kjo gjë akoma është temë tabu. Siç theksuan *“nganjëherë u ofrojmë ndihmë të drejtpërdrejtë, e nganjëherë i ridërgojmë, megjithatë konsiderojmë se është ky problem sistematik i shtetit, ai vet duhet gjetur zgjidhje për t’i përmbushur barabartësisht të drejtat e gjithë qytetareve të veta”*.

Për sa i përket ndërprerjes së shtatzënisë, përfaqësueset e organizatave që morën pjesë në grupin e fokusit ishin të njëzëshme se kjo çështje akoma paraqet një temë tabu në këtë rajon. Më së shpeshi abortet bëhen në ordinancat gjinekologjike private për çmim nga 500 euro, ku të njëjtit mjekë punojnë edhe në klinikë edhe privatisht, por intervencat po zbatohen më së shpeshi privatisht, me qëllim mbrojtja më e lartë e identitetit të gruas.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit në Rajonin Jug-Lindor janë dakord se është me rëndësi vendimtare për vizitën e rregullt tek gjinekologu janë edhe forumet edukative për ndërgjegjësimin dhe informimin e popullsisë mbi rëndësinë e kontrolleve dhe këqyrjeve të rregullta. Sipas tyre, madje edhe tek popullsia e re, nuk ka vetëdije të zhvilluar se këqyrja gjinekologjike është njëjtë si çdo këqyrje tjetër shëndetësore dhe se është më mirë ajo të bëhet në mënyrë parandaluese, sesa të pritet zhvillimi i ndonjë sëmundjeje dhe të shfaqen simptomat. Pjesëmarrësja në grupin e fokusit nga Gjevgjelia theksoi se madje edhe sot, kur ka një ambulance gjinekologjike lëvizëse, ekziston mosinteresim i madh tek gratë për ta vizituar atë. Megjithatë, si problem kryesor ato nënvizuan num-

rin e ulët të gjinekologëve të cilëve u është mbushur kuota dhe nuk mund të pranojnë pacientë tjerë, andaj, pacientët tjerë duhet të vizitojnë mjek privat. Siç tha njëra nga pjesëmarrëset *“në Strumicë tre gjinekologë janë pak për gjithë atë popullsi, patjetër duhet të shtohet dyfish, të kemi të paktën 6 gjinekologë, për të siguruar efektshmëri dhe kushte të njëjta për të gjithë”*.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit janë dakord se në këtë rajon, pjesa më e madhe e aborteve po bëhet në mënyrë të ligjshme, ekziston vetëdija e ngritur rreth problemeve dhe komplikimeve që mund të shfaqen për shkak të shtatzënisë së ndërrerë joprofesionalisht. Por, sipas tyre, akoma nuk është zhvilluar një diskrecion përkatës për këtë procedurë, e sidomos në vendet më të vogla, dhe disa vajza madje ndjehen sikurse në bankën akuzuese kur duhet gjinekologut t’i sqarojnë se përse dëshirojnë ta ndërpresin shtatzënisin e vet. Turpi dhe stigma që ndjekin vajzat që përcaktohen të vizitohen rregullisht gjinekologun në vendet më të vogla, për fat të keq, janë akoma në nivel të lartë. Ato, duke u frikësuar që mos ta nënshtrojnë veten ndaj thashethemeve dhe përhapjes së fjalëve, ato përcaktohen për masa dhe përdorim të “barërave popullore”, të cilat mund seriozisht ta dëmtojnë shëndetin e tyre si dhe jetën e tyre të përgjithshme. Apo, siç theksoi përfaqësuesja nga Radovishi *“flas për njerëz të rinj, ata nuk flasin për shëndet seksual dhe riprodhues, më e pranueshme është për të të jetë shtatzëne në moshën 16-vjeç dhe të martohet pa asnjë fjalë, sesa të abortojë ose të flasë për prezervativ, sidomos në zona të tilla të vogla”*. Ato nënvizuan rëndësinë e edukimit mbi sëmundjet seksualisht ngjitëse edhe të prindërve edhe të fëmijëve, përshtatjen e qasjes drejt grupeve qëllimore, në pajtim me specifikat e vetë vendeve, shfrytëzim më të madh të edukatorëve moshatarë, të cilët do e kishin më të lehtë të hapin disa tema dhe të arrijnë shfrytëzuesit e fundit. Poashtu, ato theksuan edhe problemin e mosqasjes drejt mjeteve të lira kontraceptive, të cilat do të kishin parandaluar dhe shtatzënisin e padëshiruar dhe sëmundjet seksualisht ngjitëse, ose siç tha njëra nga pjesëmarrëset *“tre prezervativë kushtojnë 100 denarë, kur unë isha në shkollë të mesme, më jepnin nga 30 denarë për të blerë diçka për të ngrënë në shkollë, e atëherë si mund një nxënës i shkollës së mesme të ndajë 100 denarë për prezervativë?”*

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit në Rajonin Lindor si problem më të madh në shëndetësi theksuan pajisjen e pamjaftueshme të qendrave shëndetësore me aparate dhe materiale, si dhe trajnimin e pamjaftueshëm të personelit i cili gjithnjë e më tepër po shpërbëhet, sidomos në shëndetësinë shtetërore, për shkak të trendit demografik të shpërnguljes së të rinjve të kualifikuar. Në të njëjtën kohë, ata paralajmëruan se ka tendencë që personeli mjekësor që po pensionohet të mos zëvendësohet me kuadro të reja, që lë banorët e këtyre rajoneve pa mbrojtje shëndetësore dytësore, ku posaçërisht të prekura janë nënat e reja, sepse nuk marrin trajtimin dhe kujdesin e nevojitur perinatal. Ata theksuan se pothuajse çdo intervencë mjekësore duhet të përsëritet për shkak të jokompetencës së personelit, si dhe për shkak të aparateve jo të përshtatshme. Sipas pjesëmarrëseve edhe përkundër këqyrjeve gjinekologjike falas, shpesh ordinancat e gjinekologëve amë detyrojnë pagimin e një paushali të caktuar dhe jorregullisht informojnë për rezultatet e testeve, sidomos kur rezultatet janë negative.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit të Rajonit Jug-Perëndimor janë mjaft të kënaqura me shërbimet shëndetësore që marrin, dhe sidomos nënvizuan funksionalitetin e shërbimit të patronazhit, ato në fakt treguan nivelin më të lartë të kënaqësisë edhe me mbulimin edhe me cilësinë e shërbimeve shëndetësore të shëndetësisë publike.

Duke konstatuar gjendjen nëpërmjet të informacioneve të marra nga institucionet qendrore dhe lokale, intervistave të realizuara me gra të zonave rurale si dhe grupeve të fokusit të përbëra nga përfaqësueset e OJQ, konsiderojmë se nevojitet krijimi i politikave dhe masave të përshtatshme ndaj nevojave dhe problemeve të grave të zonave rurale, përmes të cilave do të mundësohet shfrytëzimi më i madh i shërbimeve shëndetësore nga këto gra, që do të ketë efekt të drejtpërdrejtë mbi rritjen e cilësisë së jetës së tyre.

Enti Shtetëror i Statistikave si dhe institucionet tjera relevante, me grumbullimin dhe kategorizimin e të dhënave, sidomos atyre që lidhen me moshën e grave shfrytëzuese të shërbimeve të caktuara, duhet ta ndajnë kufirin e moshës në 15 deri 18 dhe nga 18 përpjetë, për të fituar informacione të sakta, të cilat më tej do të përpunohen në bazë të asaj nëse bëhet fjalë për persona të mitur apo për persona të rritur. Ministria e Shëndetësisë duhet të aplikojë një sistem të evidentimit të shfrytëzueseve të shërbimeve, i cili do të ndahet sipas vendbanimit të tyre, për të bërë analizë përkatëse dhe për të fituar një pasqyrë reale për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore nga gratë rurale. Ministria e Shëndetësisë duhet të zhvillojë një analizë rreth asaj se sa janë shërbimet shëndetësore të (pa)qasshme për gratë rurale. Ministria e Shëndetësisë duhet të aplikojë një sistem të koordinimit dhe lidhjes ndërmjet shtëpive të shëndetit, qendrave të shëndetit publik, spitaleve të përgjithshme dhe gjinekologëve amë, si ato privatë, ashtu dhe ato shtetërorë. Duhet të detyrohen gjinekologët amë, privatë dhe shtetërorë, që të dërgojnë rregullisht të dhëna përkatëse për shfrytëzimin e shërbimeve, të ndara sipas moshës dhe vendbanimit – deri tek Ministria e Shëndetësisë. Duhet të rritet numri i klinikave gjinekologjike lëvizëse, të cilat do t'i vizitojnë madje edhe zonat më të largëta rurale dhe do t'u mundësojnë këshillime, këqyrje dhe shërbime një numri sa më të lartë të grave rurale. Ministria e Shëndetësisë duhet të zhvillojë një program për përmirësimin e qasshmërisë drejt shërbimeve shëndetësore për gratë rurale, me aktivitete konkrete dhe sistematikisht të përpunuara. APRM duhet ta lehtësojë procedurën e marrjes së sigurimit shëndetësor për personat e papunësuar, sidomos për gratë e zonave rurale, me qëllim shfrytëzimi i përgjithshëm i së drejtës së sigurimit shëndetësor, të cilin ua mbulon shteti, përmes Ministrisë së Shëndetësisë.

Martestat e të miturve

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, me Nenin 42 rregullon se: “Republika posaçërisht mbron amësinë, fëmijët dhe fëmijët e mitur”⁷⁸. Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve që në nenin e parë përcakton se “mbrojtja e fëmijëve është një veprimtari e organizuar, që bazohet mbi të drejtat e fëmijëve, si dhe mbi të drejtat dhe detyrat e prindërve për planifikim të familjes, si dhe të shtetit dhe të njëjësive të vetëqeverisjes lokale për drejtim të politikës njerëzore mbi popullsinë”⁷⁹. Po i njëjti Ligj rregullon se si fëmijë konsiderohet çdo person deri në mbushjen e moshës 18 vjeç të jetës. Nga ana tjetër, Ligji i Familjes, me nenin 16 paragrafin 1 rregullon se “nuk mund të lidh martesë një person që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç të jetës”⁸⁰, megjithatë menjëherë në paragrafin pasues të po të njëjtit nen, thotë se “gjykata kompetente mund, në procedurë jashtë-procesore, të lejojë lidhje të martesës që ka mbushur moshën 16 vjeç të jetës, në qoftë se personi ka arritur pjekuri trupore dhe shpirtërore, të nevojitur për kryerjen e të drejtave dhe detyrimeve që krijohen në martesë, e pas mendimit paraprakisht të marrë nga një institucioni shëndetësor dhe pas ndihmës së dhënë profesionale në Qendrën e Punës Sociale”⁸¹. Ligji i Familjes, në as edhe një nen nuk rregullon themelimin e bashkësive jashtëmartesore, gjë kjo për të cilën as edhe një institucion nuk mban evidencë për atë se sa bashkësi të këtilla ekzistojnë, brenda të cilave njëri ose të dy partnerët janë të mitur. Kodi Penal, me Nenin 197 rregullon jetën jashtëmartesore me fëmijë, apo paragrafi 1 lexon: “një person i rritur, i cili jeton në bashkësi jashtëmartesore me fëmijë që ka mbushur moshë 14 vjeç, ndërsa nuk ka mbushur moshë 16 vjeç, do të dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet”⁸², dhe në të njëjtën kohë, paragrafi 2 rregullon se “me denimin e paragrafit 1 do të dënohet edhe prindi, birësuesi ose kujdestari i fëmijës që ka mbushur 14 vjet, por nuk ka mbushur 16 vjet, do ta lejojë të jetojë në bashkësi jashtëmartesore me person tjetër, ose do ta shtyejë ta bëjë këtë”⁸³. Për fat të keq, ky Kod, për shkak të mosprecizimit, lë hapësirë të kalojnë të pasanksionuara bashkësitë jashtëmartesore midis një të mituri të rritur* dhe një personi të rritur. Mosrregullimi i bashkësive jashtëmartesore pamundëson institucionet e sistemit të veprojnë për interesin më të mirë të fëmijës, duke mos lejuar formimin e bashkësive të këtilla, gjegjësisht, duke sanksionuar ato në mënyrën përkatëse. Kjo dukuri, e cila është ngulitur thellë në traditën kulturore të një pjese të caktuar të popullsisë, por njëkohësisht jo rrallë mund të takohet edhe tek komunitetet tjera etnike që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, jo vetëm që shkel të drejtat e njeriut, por ndikon cilësinë e jetës së vajzave.

Edhe pse të dhënat e marra nga Enti Shtetëror i Statistikave⁸⁴ tregojnë se moshja mesatare e lidhjes së martesës në tre vitet e kaluara është 26 deri 27 vjeç, por megjithatë, hulumtime të caktuara tregojnë se nuk është i ulët numri i martesave të të miturve në

78 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, e disponueshme në: <https://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/UstavnaRmizmeni.pdf>

79 Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve, teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 23/13; nr. 12/14; nr. 44/14; nr. 144/14; nr. 10/15; nr. 25/15 dhe nr.150/15, i disponueshëm në: <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/>

80 Ligji i Familjes, teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 153/2014, i disponueshëm në: <http://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-semejstvoto-20-10-2014-prechisten-tekst.pdf>

81 Njëjtë


83 Kodi Penal, teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 80/99, nr. 4/02, nr. 43/03, nr. 19/04, nr. 81/05, nr. 60/06, nr.73/06, nr. 7/08, nr. 139/08, nr. 114/09, nr. 51/11, nr. 135/11, nr. 185/11, nr. 142/12, nr. 166/12, nr. 55/13, nr. 82/13, nr. 14/14, nr. 27/14, nr. 28/14, nr. 115/14 dhe nr. 132/14, i disponueshëm në: <http://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>

84 Njëjtë

* Në pajtim me Ligjin e Drejtësisë së të Miturve, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 87/07; nr. 103/08; nr. 160/08; 145/10, “i mitur i rritur” është një i mitur i cili në kohën e kryerjes së veprës e cila me ligj është përcaktuar si veprë penale ose lajthitje, ka mbushur 16 vjet, ndërsa nuk ka mbushur 18 vjet.

84 http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat_PoloviStat/125_PoloviStatistiki_en.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef

Republikën e Maqedonisë, e sidomos në zonat rurale. Sipas të dhënave të marra nga hulumtimin në terren, i zbatuar në lagjen rome Trizlla 2, Prilep, në kuadër të Projektit Qytetarët në Kuvend: Nismat ligjvënëse për të drejtat e njeriut” po vërehet rritje e kësaj dukurie. Të dhënat tregojnë se: “... deri në vitin 2011, 28 të mitur kanë hyrë në bashkësi martesore, në vitin 2012 numri kishte qenë 11, në vitin 2013 numri ishte rritur në 15, ndërsa në vitin 2014 numri ishte rritur në 28. Në vitin 2015 numri është më i larti (31 të mitur), ku 27 janë vajza, dhe 4 janë djem”⁸⁵. Nga Grafiku 11 mund të vërehet se pas rënies së caktuar në vitet 2012 dhe 2013, në vitet pasuese po shënohet rritja e numrit të martesave të lidhura të të miturve.



Ky hulumtim tregon se gjithsej 122 bashkësi martesore, në të cilat të paktën njëri bashkëshort kishte qenë i mitur, janë formuar në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2016, “ku, 67% kishin qenë bashkësi midis të miturve, dhe 37% bashkësi ku vajza të mitura kanë hyrë në martesë me burra të rritur në moshë nga 18 deri 40 vjeç”⁸⁶.

Të dhënat e marra në kuadër të hulumtimit “Zona gri” midis traditës dhe të drejtave të fëmijëve, të zbatuar nga Organizata Rome për Afirmim Multikulturor – Roma SOS, tregojnë se institucione të ndryshme posedojnë informacione të ndryshme rreth po të njëjtit problem – martesat e të miturve. Siç thuhet në hulumtim “për shkak të mosharmonizimit të këtyre, dhe me siguri bashkëpunimi i dobët apo mosekzistues midis institucioneve në këtë çështje, nga të dhënat e grumbulluara nuk mund të konkludohet se cili është numri i përgjithshëm dhe nëse të gjitha rastet e evidentuara kanë marrë të gjitha informacionet dhe mbështetjen e nevojitur, apo nëse kanë realizuar të gjitha të drejtat nëpër këto institucione të sistemit”⁸⁷. Se ky problem ka dimension gjinor, flet edhe e dhëna se nga gjithsej 49 martesat të lidhura në periudhën mes viteve 2011 dhe 2014, ku njëri person është në moshë nga 16 deri 18 vjeç, dhe tjetri është i rritur, vetëm 2 persona të mitur kanë qenë të gjinisë mashkullore, ndërsa 47 të tjerët kishin qenë të gjinisë femërore⁸⁸.

85 Martesat e fëmijëve: nga dashuria e deri në shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, Fondacioni i Demokracisë i Westminster, Shkup 2016, fq. 16, e disponueshme në: <http://medium.edu.mk/attach/ROMA-preview2.pdf>


86 Njëjtë, fq. 15

87 “Zona gri” ndërmjet traditës dhe të drejtave të fëmijëve, Organizata Rome për Afirmim Multikulturor – Roma SOS, Prilep, viti 2016, fq. 15

88 Njëjtë, fq. 15

Për të marrë të dhëna konkrete statistikore për atë se sa bashkësi formale dhe joformale ku njëri ose dy partnerët janë të mitur, janë regjistruar në tre vitet e kaluara u dërgua një kërkesë për qasje në informacione me karakter publik deri tek Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Në përgjigjen e vet⁸⁹, ata na informojnë se sipas raportit të IP Enti i Veprimtarive Sociale i përgatitur në bazë të të dhënave të dërguara nga 30 qendra të punës sociale në bazën Lirikus, gjendja e personave të mitur, që kanë mbushur moshë 16 vjeç, kanë dëshiruar të lidhin martesë dhe janë drejtuar në qendrat e punës sociale, siç mund të shihet nga Grafiku 12, shënon rënie në vitin 2015, por fatkeqësisht, rritje në vitin 2016, sidomos nëse merret parasysh fakti se të dhënat e dërguara i referohen periudhës përfundimisht me 31.07.2016.

Grafiku 12



Për fat të keq, nga MPPS na bënë të ditur se nuk kanë në dispozicion të dhëna mbi numrin e bashkësive jashtëmartesore ku nusja është e mitur. Mosekzistimi i rregullimit ligjor, si dhe i sistemit për grumbullimin e kësisoj të dhënave dhe për regjistrimin e tyre, lë hapësirë për zonë gri ku shkelen të drejtat e fëmijëve dhe të grave.

Për të marrë të dhëna konkrete statistikore nga rajonet e targetuara, për nevojat e humltimit u dërguan kërkesa për qasje në informacione me karakter publik në 6 qendra të punës sociale, nga të cilat vetëm 3 dërguan përgjigjet e tyre.

Nga QPS Tetovë informojnë se në tre vitet e fundit nuk kanë evidentuar kërkesa formale për lidhje të martesës, ku nusja është e mitur, në komunat e targetuara.

Nga QPS Koçan informojnë se në tre vitet e fundit nuk kanë evidentuar raste të martesave formalisht të lidhura, me pëlqimin e prindit, ku nusja është e mitur, në komunën e Zërnocit. Martesa e vetme e këtillë është evidentuar në komunën Çeshinovë-Obleshevë në vitin 2015, ku nusja kishte qenë në moshë 17 vjeç dhe është e komunitetit etnik maqedonas.

Nga QPS Ohër na informojnë se janë 2 raste të evidentuara të martesës së lidhur formalisht, me pëlqimin e prindit, ku nusja kishte qenë e mitur në Komunën e Debërcës në vitin 2015, ku nuset kishin qenë në moshë 17 vjeç dhe të komunitetit etnik maqedonas.

Për të marrë të dhëna të caktuara kualitative, duhet të lejojnë vështrim në perceptimin se Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) ndaj martesave të të miturve në intervistën e zbatuar me përfaqësuesen e Ministrisë, ku u parashtrua një sërë pyetjesh në këtë temë. Në të gjitha përgjigjet e saja, ajo theksoi se MPPS po bën përpjekje për të reduktuar numrin e martesave të të miturve, gjegjësisht, në Ministri po bisedohet rreth

89 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Përgjigja në kërkesë nr. 14-463/8 e datës 05.08.2017;

ndryshimit të akteve ligjore në kuptimin e rritjes së pragut të moshës kur një fëmijë i mitur mund të lidh martesë, ose të përjashtohen ca gjëra të cilat japin mundësi për lidhjen e një martese të tillë. Nga Ministria konsiderojnë se programet e ndryshme, të drejtuara nga institucione të brendshme, ndërsa të mbështetura edhe nga donatorë të huaj, kanë kontribuar në ngritjen e vetëdijes tek të rinjtë, të cilët gjithnjë e më shpesh parapëlqejnë të arsimohen dhe sa më vonë të lidhin martesë. Sipas tyre, kjo dukuri është më e shprehur tek komuniteti rom, edhe pse kohëve të fundit po bie numri i martesave të të miturve, apo po ngritet pragu i moshës për hyrje në martesë. Në lidhje me çështjen e “blerjes” së nuseve, nga Ministria konsiderojnë se kjo çështje bie nën trafikimin e njerëzve. Megjithatë, në disa bashkësi, siç është ajo rome, ekzistojnë zakone kulturore dhe tradicionale, sipas të cilave ekziston dhënia e një garance të caktuar financiare se vajza do t’i takojë atij që e dëshiron atë. Megjithatë, siç bëri të ditur përfaqësuesja e Ministrisë, kohëve të fundit, tek njerëzit me shkallë më të ulët të arsimimit dhe me ekzistencë problematike, po kërkohen mjete financiare nga familja e dhëndrit, në lartësi të kostos së vetë dasmës.

Për të hulumtuar nëse në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë raste edhe të blerjes së nuseve të mitura, grave të intervistuar u parashtrohen edhe një sërë pyetjesh që përfshijnë edhe këtë problematikë. Nga informacionet e marra me bërjen e intervistave me gra me përkatësi të ndryshme etnike, me shkallë të ndryshme të arsimit dhe me status të ndryshëm ekonomik në rajonet e targetuara, janë marrë të dhënat më poshtë për këtë temë.

Grave të intervistuar nga Rajoni i Pollogut pavarësisht nga shkalla e arsimit dhe përkatësia etnike, moshë mesatare për lidhje të martesës lëviz nga 21 deri 25 vjeç, ku të gjitha thanë se janë martuar nga dashuria. Pothuajse të gjitha të intervistuarat thanë se janë regjistruar në shërbimin e gjendjes civile, përveç një e intervistuar, e cila tha se për arsye të gjendjes së mundësive më të mira ekonomike për jetë, jeton jashtë vendit në bashkësi jashtëmartesore. *“Nuk jemi të regjistruar sepse shpresoj se im shoq do të martohet jashtë vendit, do të merr dokumente, dhe pastaj do të më merr edhe mua. Fëmijët mbajnë mbiemrin e babait, dhe ai qëndron në certifikatën e lindjes”*. Asnjëra nga të intervistuarat nuk kishte qenë e mitur kur ishte bërë nënë për herë të parë, dhe poashtu, as nuk kishte patur abort pas sjelljes së Ligjit aktual mbi Ndërrerjen e Shtatzënësisë.

Sipas të intervistuarave, moshë mesatare e lidhjes së martesës në Rajonin e Pollogut po lëviz nga moshë 18 deri 25 vjeç, ndërsa tek burrat 28-29 vjeç. Njëra e intervistuar konsideron se kohëve të fundit ka trend të reduktimit të moshës së mbetjes shtatzëne tek vajzat, apo siç tha: *“po shikoj foto në FB të maturanteve shtatzëna edhe nga Tetova edhe nga Bërvenica, mbase ato kanë mbushur 18 vjet, por me siguri shtatzënësia u ka filluar edhe para moshës 18 vjeç”*. Në të njëjtën kohë, një pjesë e grave të intervistuar konsiderojnë se për vajzat nga zonat rurale është përfitim të gjejnë djalë nga zonat urbane, për shkak të mundësive më të mëdha të punësimit dhe për shkak të jetës më të bukur. Si rezultat i kësaj, ato lehtë hyjnë në lidhje serioze madje edhe në moshë më të re.

Shumica e grave të intervistuar, pavarësisht nga përkatësia etnike dhe shkalla e arsimit treguan se janë të njohura me ekzistimin e rasteve të martesave të të miturve në zona të caktuara, dhe si më të nënshtruara ndaj kësaj dukurie i nënvizuan vajzat e komunitetit etnik rom dhe atij shqiptar. Të intervistuarat e komunitetit etnik rom dhe shqiptar vërtetuan se janë të njohura me raste, kryesisht në zona më të vogla dhe më të largëta rurale, dhe para së gjithash, si rezultat i kushteve të vështira familjare dhe ekonomike. Sipas këtyre të intervistuarave, janë 3 kategori të nuseve të mitura: brenda

njërës hyjnë nuse të mitura në moshë 14-15 vjeç, që jetojnë në bashkësi të peregjistruara jashtëmartesore, në të dytën janë ato që lidhin martesë me pëlqimin e prindit me moshë të mbushur 16 vjeç dhe në të tretën janë ato që braktisin familjen dhe martohen si nuse të ikura.

Të gjitha të intervistuarat identifikojnë këtë dukuri si jashtëzakonisht negative, dënojnë martesat e këtilla dhe konsiderojnë se vajzat janë të papërgatitura për lidhje të martesës dhe për *"obligimet që sjell me vete martesë"*, e as se *"fëmijët janë të gatshëm të kenë fëmijë"*. Siç përmbloodhi bukur një e intervistuar: *"është për të ardhur keq, gruaja e mitur është akoma fëmijë, fizikisht, trupi është i fëmijës, mendja është e fëmijës, në mënyrë fëmijërore do të përballet me problemet që patjetër se do të vijnë. Akoma disi po ndërtohet personaliteti, është e mundur madje edhe të ndërtohet në një mënyrë më të keqe për shkak të kësaj. Të krijohet një njeri i revoltuar, sepse nuk është dhënë kot ky kufi i pjekurisë, ajo njëherë duhet të pjeket"*. Sipas të të intervistuarave, kjo dukuri më së shpeshi rezulton me mospajtim midis partnerëve bashkëshortor, të cilët përfundojnë të palumtur dhe të pakënaqur nga lidhja e këtillë, e cila jo rrallëherë mund të shndërrohet në të dhunshme.

Pothuajse gjitha të intervistuarat, pavarësisht nga niveli i arsimit dhe përkatësia etnike, theksuan se janë të njohura me rastet e nuseve "të blera", por megjithatë po orvateshin për ta "mbrojtur" lagjen e vet, çdoherë duke nënvizuar se kjo gjë ndodh në fshatrat fqinje. Sipas tyre, nuset e "blera" janë më së shpeshi nga Shqipëria, dhe arsyeja për këtë është se disa persona po përcaktohen të martohen në këtë mënyrë, sepse vajzat nga rrethi i tyre po largohen në qytetet për shkak të shkollimit ose për shkak të martesës, dhe në të dy rastet ato nuk kthehen në vendlindje. Asnjëra nga të intervistuarat nuk mundeshte me siguri të konfirmonte se këto nuse janë të blera, apo se për ardhjen e tyre në bashkësinë e re janë dhënë para. Megjithatë, ato theksuan se në të gjitha rastet e këtilla për të cilat ato kanë njohuri, nuset janë gra të rritura, ndërsa burrat janë në moshë për të cilën njerëzit në zonat rurale konsiderojnë se janë vonuar me martesën (mbi 35 vjeç), me nivel më të ulët të arsimit dhe pa jetë sociale, ose të ve. Si pjesë e arsyeve përse gratë nga Shqipëria po bëjnë dakord për kësaj lloji të martesave të dakorduara, të intervistuarat thanë se në vendet më të vogla në Shqipëri, nga më së shpesi vijnë këto gra, vajzat në moshë mbi 20 vjeç që akoma nuk janë martuar vështrohen si problem i tërë rrethit, ato nxiten për martesë, madje edhe me shkues, në vend tjetër. Gratë e intervistuarat konsiderojnë se këto gra po përshtaten mirë në mjedis, janë të zonja dhe me ndërgjegje të mirë po kujdesen për amvisërinë. I perceptojnë si nëna të mira, por megjithatë, konsiderojnë se këto nuk janë bashkësi të lumtura martesore, sepse nuk janë të formuara nga dashuria. Sjellja e mjedisit dhe komunitetit ndaj tyre e përshkruanë si maksimalisht korrekt, me përpjekje madje edhe u ndihmohet se si të përshtaten ndaj rrethit të ri. Disa nga ato theksuan se megjithatë ka patur raste kur nuset e blera janë larguar dhe kanë braktisur familjen e re, sepse nuk kanë qenë të lumtura me jetën.

Të intervistuarat me arsim fillor në Rajonin Jug-Perëndimor konstatuan se në ditët tona, vajzat po lidhin martesë në moshë më të rritur (25 vjeç), më së shpeshi për shkak të pamundësisë për të siguruar punësim të përhershëm. Megjithatë, një e intervistuar tha se kishte dëgjuar se në lagjet përreth ka edhe martesë të pakurorëzuar të të miturve, por nuk mundeshte të dallonte një rast konkret, sepse siç tha, *"kjo gjë mbahet në fshehtësi, njerëzit këtu janë më të prapambetur"*. Të intervistuarat nga Qendra Zhupa referuan drejt praktikës akoma jo të çrrënjësuar, edhe pse të reduktuar, të "rezervimit" të vajzave për ndonjë djalë nga fshati, madje që në moshën dhjetë-vjeç, martesë këto të cilat më

tej janë shpesh martesë të të miturve dhe dështojnë, për shkak të moshës tepër të re të fëmijëve. Të intervistuarat me arsim të mesëm dhe të lartë konsideruan se shumë nga vajzat e rrethit të tyre po martohen shumë të reja, disa nga ato madje janë edhe të mitura, por ato nuk kishin njohuri për ndonjë rast të tillë konkret. Të gjitha të intervistuarat, pavarësisht nga shkalla e arsimit, konsideronin se hyrja e hershme në martesë ka pasoja të përhershme mbi jetën e gruas, sepse një person i mitur nuk është në gjendje t'u përgjigjet të gjitha sfidave që sjell me vete jeta martesore.

Të intervistuarat theksuan se edhe në rajonin e tyre ka raste të nuseve të ardhura nga Shqipëria, por megjithatë nuk ekzistojnë prova se ato janë "blerë". Sipas tyre, arsyeja e "blerjes" së nuseve nga një shtet tjetër është se shumica e vajzave lokale, në luftën për ekzistencë më të mirë po martohet nëpër qytetet, kështu që në vendet rurale mbetet një numër i madh i burrave të pamartuar. Të intervistuarat konsiderojnë se këto gra janë nëna dhe amvise të mira, po përshtaten me rrethin dhe kanë respekt më të madh për familjen. Ato në shikim të parë duken të lumtura në martesat e tyre, por ekzistojnë dhe raste ku martesat e këtyra përfundojnë me shkurorëzim.

Të intervistuarat nga Rajoni Lindor pavarësisht nga shkalla e arsimit, theksuan se kanë vazhduar të jetonin në komunat e veta ndonëse, sipas tyre, herët kanë lidhur martesë (20-22 vjeç). Ato konsiderojnë se tanimë vajzat në komunën e tyre po martohen më të rritura në moshë, pas moshës 23 vjeç, ndryshe nga më herët, kur vajzat edhe nga komuniteti etnik rom edhe nga ai maqedonas, janë martuar në moshë 15-16 vjeç, sipas tyre, si rezultat i mjedisit patriarkal dhe lirisë së kufizuar të lëvizjes së vajzave. Një e intervistuar theksoi se i kujtohet një rast përpara 20 viteve, kur ndonjë vajzë që kur kishte qenë në shkollë fillore, dhe kishte mbetur shtatzënë dhe ishte martuar me lejen e prindërve. Një e intervistuar tjetër referoi se ka një mike e cila për arsye të marrëdhënieve të parregulluara në familje ishte martuar në moshë 16 vjeç, ndërkohë ishte divorcuar dhe tani, në moshë vetëm 18 vjeç, është në martesën e saj të dytë. Siç tha vetë ajo: *"vajzat e mitura nuk janë të pjekura mjaftueshëm për të gjykuar arsyeshëm dhe për t'i kuptuar negativitetet e lidhjes së hershme të martesës"*. Të gjitha të intervistuarat pajtohen se martesat e të miturve nuk kanë ndikim të mirë mbi cilësinë e jetës së vajzave, sepse në çastin kur ato hyjnë në martesë, ato as nuk janë të vetëdijshme për obligimet që kanë përpara.

Të intervistuarat theksuan se në këtë rajon ka shumë nuse nga Shqipëria, por se ato nuk mund me siguri të thonë se ato janë "të blera". Siç tha një e intervistuar: *"im vëlla është martuar me një vajzë nga Shqipëria, u njohën rastësisht dhe lidhën martesë nga dashuria"*. Të intervistuarat thanë se arsye për këtë dukuri është shpërngulja e vazhdueshme e vajzave nga fshatrat. Edhe në këtë rajon vërtetohet konstatimi se këto gra janë përshtatur me sukses në rrethin dhe perceptohen si amvise dhe nëna të mira, dhe në të njëjtën kohë janë të pranuar dhe respektuara mirë nga rrethi në të cilin jetojnë, si dhe nga familjet. Sipas të intervistuarave, burrat janë më së shpeshi në moshë më të "kaluar" (40 dhe më tepër), ose siç tha e intervistuarja e cila ka shembull personal në familje: *"vëllaut tim po i kalonte rinia, ai mbushi 34 vjet, andaj kërkonte një grua që do e ndihmonte atë në bujqësi"*.

Në përgjithësi mund të konkludohet se pavarësisht nga përkatësia etnike, shkalla e arsimit, statusi ekonomik dhe vendbanimi, të gjitha të intervistuarat konsiderojnë se martesat e të miturve kanë efekt jashtëzakonisht negativ mbi cilësinë e jetës së vajzave, sidomos për faktin se ato nuk janë të përgatitura për sfidat që sjell jeta martesore, që mund të rezultojë edhe me sjellje të dhunshme, si dhe problemet që mund të shkak-

tohen si rezultat i shtatzënisë së të miturve dhe rritjes së fëmijëve nga nëna që edhe vetë janë fëmijë. Në lidhje me çështjen e nuseve “të bëra”, të gjitha të intervistuarat janë dakord se këto gra, pa përjashtim, janë të rritura dhe më së shpeshti pragu i moshës midis partnerëve nuk është shumë i madh. Të gjitha shembujt e referuar treguan se këto nuse vijnë nga Shqipëria, ku është e lehtë për ato të përshtaten në mjedis, ndërsa bashkësia dhe familja i respektojnë ato.

Nga informacionet e marra me zbatimin e grupeve të fokusit me përfaqësuese të organizatave joqeveritare të rajoneve të targetuara, që punojnë në fushat që janë përfshirë me lëtë dokument, janë grumbulluar të dhënat më poshtë për këtë temë.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit në Rajonin e Pollogut konsiderojnë se martesat e të miturve janë më të shpeshta tek popullsia rome në këtë rajon, ku ka patur raste madje edhe të vajzave në klasën e shtatë-tetë që kanë ndërprerë arsimin, kanë themeluar bashkësi jashtëmartesore dhe për kohë të shkurtër janë bërë nëna. Sipas tyre, disa bashkësia po regjistrohen me pëlqimin e prindërve, dhe disa jo. Përfaqësueset e shoqatave shqiptare theksuan se kjo dukuri në të kaluarën kishte qenë më e shpeshtë tek popullsia shqiptare, por tanimë është më e rrallë. Megjithatë, ata referuan një rast ku një vajzë ishte bërë nënë në moshë 16 vjeç, por pasi nuk kishte mundur të lidhte martesë formale, fëmija mban mbiemrin e saj.

Për sa i përket nuseve “të blera”, përfaqësueset e organizatave informuan se në rajonin e tyre ekzistojnë nuse të këtilla që vijnë nga Shqipëria, ku ato më së shpeshti janë në moshë midis 35 dhe 40 vjeç, ndërsa bashkëshortët e tyre janë më së shpeshti në moshë mbi 45 vjeç. Njëra pjesëmarrëse theksoi *“unë njoh shumë njerëz nga ky rreth, nga rajoni që thjeshtë nuk kanë zgjidhje tjetër, e dijnë se ekziston një mundësi e tillë, por kjo nuk do të thotë se u japin para njerëzve atje, se i blejnë ato...”*. Ato theksuan se në shumë raste bëhet fjalë edhe për burra të ve, të cilët janë më të shtyrë në moshë dhe nuk duan të jetojnë të vetëm, dhe për shkak të, siç thanë: *“këtu zakonisht gratë e veja nuk martohen më, më herët janë martuar sepse nuk kishte patur kush t’i mbante ekonomikisht, e tani punojnë vetëm, rrallë e cila nga ato po rimartohet”*, pasi që burrat e ve janë të detyruar të kërkojnë nuse nga shtete tjera.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit në Rajonin Jug-Lindor theksuan se në këtë rajon, vajzat e mitura më së shpeshti po fillojnë lidhje jashtëmartesore, dhe si pasojë braktisin shkollën, dhe kur të mbushin 16 vjet, formojnë bashkësi martesore formale, me pëlqimin e prindit. Siç tha njëra nga pjesëmarrëset: *“unë po ndjekja shkollën fillore në Murtinë, kur isha 14 vjeç, që në shkollën fillore, ajo mbetet shtatzëne dhe kjo është situata, flas për popullsinë turke”*. Një pjesëmarrëse tjetër, e cila punon në sektorin arsimor dhe është kujdestare e paraleles në të cilën shumica e nxënësve janë të komunitetit etnik turk, konsideron se sot ka qasje më të madhe në informacione dhe qasje të lirë në ato, andaj ishte befasuar kur prindërit e një vajze të komunitetit etnik maqedonas, kishin ardhur në shkollë për ta informuar se ajo në moshën 16 vjeç (viti i dytë i shkollës së mesme), do të lidhte martesë. Pjesëmarrësja u shpreh: *“prindërit erdhën dhe thanë se është mirë që u martuan, sepse ai po vinte nga një familje me gjendje të mirë ekonomike; unë si kujdestare e klasës, mbeta pa tekst”*. Megjithatë, siç nënvizoi ajo, një pjesë të fajit duhet ta marrin përsipër institucionet arsimore, sepse duke dëshiruar t’i mbrojnë familjet nga procedurat e komplikuar dhe ngarkesa financiare, ato pranojnë gjendjen e sapokrijuar, në vend se t’i informojnë institucionet tjera për rastin në fjalë.

Në lidhje me “blerjen” e nuseve, përfaqësueset e organizatave që morën pjesë në grupin e fokusit informuan se janë të njohura me raste ku për nuset nga Shqipëria po paguhet madje edhe nga 3000 euro, ku tërë procedurën po e ndërmjetëson një person nga Pri-lepi. Sipas tyre, bëhet fjalë përnjë “krim të ligjshëm dhe mirë të organizuar”, ku, në qoftë se shfaqen “probleme” me nusen, ajo mund të zëvendësohet me një nuse tjetër, ose siç tha njëra nga pjesëmarrëset, ajo kishte dëshmuar një çast kur ndërmjetësuasi i kishte thënë “dhëndrit”: *“në rregull atëherë, do e kthej këtë, dhe do të jap një tjetër për ato para”*. Megjithatë, në të gjitha rastet bëhet fjalë për gra të rritura të moshës së mesme, ku më së shpeshi dallimi në moshë midis partnerëve lëviz nga 10 deri 12 vjet. Të intervistuarat thanë se këto gra, pothuajse pa përjashtim, janë të pranuar mirë nga rrethi dhe komuniteti dhe lehtë përshtaten në të.

Sipas pjesëmarrëseve në grupin e fokusit në Rajonin Lindor, në këtë rajon martesat e të miturve janë shumë të rralla dhe pothuajse të çrrënjësura, edhe pse nganjëherë u ndodhin adoleshentëve/eve më të rritur/a, më së shpeshi me moshatarë/e, për arsye të shtatzënisë së paplanifikuar. Sipas përvojave të tyre, pothuajse çdoherë martesat e tilla janë jofunkionale, sepse të rinjtë nuk janë të gatshëm për sfidat që sjell me vete jeta martesore, e sidomos prindëria.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit në Rajonin Jug-Perëndimor theksuan se në disa nga zonat ku jetojnë romë, martesat e të miturve pothuajse janë çrrënjësura, edhe pse në vitet e fundit përsëri kishte patur raste të regjistruara. Përndryshe, ata konsiderojnë se martesat e këtilla janë të rastit, si rezultat i shtatzënisë së paplanifikuar, më së shpeshi ndërmjet moshatarëve, andaj konsiderojnë se ky trend nuk është shumë shqetësues.

Pjesëmarrëset e grupeve të fokusit në Rajonin Lindor dhe në Rajonin Jug-Perëndimor ndajnë të njëjtin mendim si pjesëmarrëset e grupeve tjera të fokusit, për sa u përket “nuseve të blera” nga Shqipëria. Ato theksojnë se gratë vijnë nga andej më së shpeshi për shkak të kushteve substandarde të jetesës në vendin ku kanë orgjinën (pa rrjet ujësjellës dhe kanalizim dhe nganjëherë edhe pa energji elektrike), kështu që shpërngulja në vendin e ri të banimit paraqet mundësi për ato në përmirësimin e cilësisë së jetesës. Si pasojë, këto gra janë të gatshme që punët e shtëpisë t’i kryejnë shpejt dhe ngathët, dhe e kanë të lehtë që ta përvetësojnë gjuhën, andaj e kanë të lehtë të përshtaten në ambientin. Megjithatë, gjendja në të cilën janë, duke ditur se kanë shumë pak njerëz të njohur në shtet dhe nuk mund të kërkojnë përkrahje emergjente, i bën mjaft të cenueshme dhe të nënshtruara ndaj rrezikut, gjegjësisht, të varura nga vullneti i mirë i dhëndrit/bashkëshortit dhe familjes së tij.

Duke konstatuar gjendjen nëpërmjet të informacioneve të grumbulluara nga institucionet qendrore dhe lokale, nga intervistat e realizuara me gra të zonave rurale, si dhe të grupeve të fokusit të përbëra nga përfaqësuese të OJQ, konsiderojmë se nevojitet hartimi i politikave dhe masave që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e numrit të martesave të të miturve, me qëllim përmirësimi i cilësisë së jetesës së vajzave, si dhe masa që do ta destimulojnë “blerjen” e nuseve nga shtete tjera.

Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë duhet të riprecizohet, sidomos në kuptimin e aplikimit të sanksioneve për personat e rritur që janë në bashkësi jashtëmartesore me vajza të mitura më të rritura. Në të njëjtën kohë, patjetër duhet futur në përdorim një sistem të evidentimit të bashkësive jashtëmartesore, sidomos të atyre ku njëri ose të dy partnerët janë të mitur, nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Me qëllim reduktimi i martesave të lidhura formalisht, nevojitet ndryshimi i sistemit ligjor në drejtim të

ngritjes së pragut të moshës kur mund të lidhet martesë, si dhe edukimi i vazhdueshëm i prindërve dhe i fëmijëve mbi pasojat e dëmshme që mund të shkaktohen si rezultat i një martese të tillë. Për të ndikuar mbi reduktimin e rasteve të “blerjes” së nuseve nga shtete tjera, nevojitet aplikimi i sanksioneve për njerëzit që ndërmjetësojnë këtë proces, si dhe shkurajimi i njerëzve që po përcaktohen për lidhje të një martese të këtillë.

Mbrojtja sociale

Sipas hulumtimit të grave rurale të UN Women⁹⁰, këto gra përfaqësojnë një të katërtën të popullsisë botërore. Ato janë lidere, prodhuese, sipërmarrëse dhe dhënëse të shërbimeve, dhe kontributi i tyre ka rëndësi vitale për mirëqenien e familjeve, komuniteteve dhe ekonomive, si dhe për realizimin e Objektivave Zhvillimore të Mileniumit. Gratë rurale përbëjnë një pjesë të madhe të krahut të punës në bujqësi, ato prodhojnë pjesën më të madhe të ushqimit të kultivuar, sidomos në bujqësinë ekzistenciale, si dhe kryejnë pjesën më të madhe të punës së papaguar në zonat rurale.

Problemet kryesore sociale që prekin gratë e zonave rurale janë varfëria dhe standardet e ulëta të jetesës. Gratë rurale në përgjithësi janë të papunësuar, sepse për punën që kryejnë, ndonëse lidhet me obligimet e shtëpisë ose me aktivitetet bujqësore/blegtoriale, më së shpeshi nuk realizojnë të ardhura, dhe në të njëjtën kohë, nuk mund të realizojnë dhe të drejta të caktuara. Këtë problem kishte perceptuar dhe Bashkimi Evropian, si në vendet anëtare, ashtu dhe në një pjesë të vendeve që nuk janë anëtare të saja dhe në këtë kontekst, njëri nga raportet e Komisionit të Mundësive të Barabarta të Grave dhe Burrave rekomandon që vendet të vendosin dispozita të qarta ligjore mbi gjendjen e ndihmimit të bashkëshortëve, si dhe ta pranojnë të drejtën e pushimit të lindjes dhe shtesave për amësi, si dhe të drejtat autonome të mbrojtjes sociale për ndihmin të bashkëshortëve tek punëtorët e vetëpunësuar⁹¹.

Për fat të keq, mbizotërimi i gjendjeve të caktuara në zonat rurale, siç është papunësia, varfëria, lidhja e keqe infrastrukturore me qytetet dhe paqasshmëria në shërbime elementare arsimore, shëndetësore dhe sociale, si dhe ngulmimi i mentalitetit tradicional dhe patriarkal i cili imponon role të stereotipeve për gratë dhe burrat, duke kufizuar në të njëjtën kohë ndikimin e grave si në jetën private ashtu dhe në atë publike, gratë në zonat rurale po përballen me sfida të mëdha në realizimin e të drejtave të tyre edhe nga fusha e mbrojtjes sociale.

Në Nenin 2 të Ligjit të Mbrojtjes Sociale qëndron se “mbrojtja sociale paraqet një sistem të masave, aktiviteteve dhe politikave për parandalimin dhe tejkalimin e rreziqeve sociale elementare, të cilave u është nënshtruar qytetari gjatë jetës, për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social dhe për fuqizimin e kapacitetit të tij për mbrojtje vetjake”⁹². Mbrojtja sociale është veprimtari me interes publik, e cila po shtjelohet nëpër një sërë masash të cilat kategorive të cënueshme të qytetarëve u mundësojnë parandalim social, mbrojtje jashtë-institucionale dhe institucionale, si dhe ndihmë financiare nga mbrojtja sociale. Neni 9 i po të njëjtit Ligj rregullon se “përveç masave të mbrojtjes sociale të qytetarëve që janë përcaktuar me këtë Ligj, kujdesi i Republikës për parandalimin e shfaqjes së rrezikut social po realizohet edhe me marrje të masave në politikën tatimore, punësimin, politikën e bursave, mbrojtjen e familjes, shëndetësinë, edukimin dhe arsimin, si dhe në fusha tjera, në pajtim me Ligjin”⁹³. Ligji i Mbrojtjes Sociale ndalon

90 Rural Women, Their Contributions and Challenges, to Be Highlighted at UN Commission on the Status of Women, - February 23, 2012

91 „Rural women in Europe” - Committee on Equal Opportunities for Women and Men Rapporteur: Ms Carmen Quintanilla Barba, Spain, EPP/CD - fq.17


92 Ligji i Mbrojtjes Sociale, teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 79/09, nr. 36/11, nr. 51/11, nr. 166/12, nr. 15/13, nr. 79/13, nr. 164/13, nr. 187/13, nr. 38/14, nr. 44/14, nr. 116/14, nr. 180/14, nr. 33/15, nr. 72/15, nr. 104/15, nr. 150/15, i disponueshëm në: <http://www.financethink.mk/wp-content/uploads/2017/07/Zakona-socjalna-zastita.pdf>

93 Njëjtë

diskriminimin në baza të ndryshme, në mesin e të cilave bie edhe gjinia, në procesin e realizimit të të drejtave për mbrojtje sociale. Në mesin e masave për realizimin e mbrojtjes sociale gjendet edhe parandalimi social, i cili duhet të mundësojë parandalimin e shfaqjes së rrezikut social, ose zbulimin e tij të hershëm dhe trajtimin, me qëllim tejkalmimi ose zbutja e pasojave të dëmshme nga ai rrezik. Kjo masë po zbatohet me anë të aktiviteteve lidhur me ngritjen e vetëdijes tek qytetarët, sidomos ato që janë të grupeve të cënueshme, edukimin, këshillimet dhe sigurimin e ndihmesës përkatëse, në pajtim me nevojat konkrete. Mbrojtja jashtë-institucionale, e cila po realizohet përmes qendrave të mbrojtjes sociale, nënkupton një sërë masash të cilat u mundësojnë tejkalmimin e gjendjeve dhe rreziqeve të caktuara problematike, grupeve të ndryshme qëllimore, ndërsa mbrojtja institucionale nënkupton të drejtën e aftësisimit për aktivitet të punës-prodhimit dhe të drejtën e sistemimit në një institucion të mbrojtjes sociale. Ligji i Mbrojtjes Sociale rregullon edhe mënyrën e fitimit të së drejtës së ndihmës financiare nga mbrojtja sociale. Neni 45 paragrafi 1 i Ligjit rregullon se: “të drejtën për ndihmë financiare sociale ka një person i aftë për punë dhe amvisëri*, që është i pasiguruar materialisht dhe i cili sipas rregullave tjera, nuk mund të sigurojë mjete për ekzistencë”⁹⁴. Bartës i kësaj të drejte mund të jetë vetëm një person i papunësuar, i cili po kërkon punë në mënyrë aktive, që është në pajtim me Ligjin e Punësimit dhe Sigurimit në Rast Papunësie⁹⁵, materialisht i pasiguruar* dhe i cili sipas rregullave tjera nuk mund të sigurojë mjete për ekzistencë. Neni 47, paragrafi 3 i Ligjit të Mbrojtjes Sociale rregullon se: “Iartësia e ndihmës financiare falas e paragrafit 1 të këtij Neni po harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, të shpallura nga Enti Shtetëror i Statistikave në janar për vitin aktual dhe paraqet shumën bazë për Iartësinë e ndihmës financiare sociale për vitin vijues”⁹⁶.

Për marrje të të dhënave konkrete statistikore të cilat do të tregojnë se sa gratë rurale të zonave të targetuara po i shfrytëzojnë të drejtat dhe shërbimet që dalin nga mbrojtja sociale, u dërgua një kërkesë për qasje në informacione me karakter publik deri tek Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS).

Nëse vështrohen përgjigjet e marra, dhe të dhëna në Grafikon 13, që kanë të bëjnë me Iartësinë e ndihmës financiare sociale në tre vitet e kaluara, mund të vërehet se ajo shënon rritje në të gjitha kategoritë e fitimit të ndihmës financiare sociale*.



*Sipas Ligjit, amvisëria nënkupton një bashkësi të anëtarëve të familjes dhe familjarëve tjerë, në mes të të cilëve nuk ekziston një obligim ligjor për mbështetje të ndërsjellë, të cilët bashkërisht kontribuojnë, administrojnë dhe shpenzojnë.

⁹⁴ Njëjtë

⁹⁵ Ligji i Punësimit dhe Sigurimit në Rast Papunësie – teksti i konsoliduar, i disponueshëm në: <http://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-vrabetovaneto-i-osiguruvane-vo-sluchaj-na-nevrabotenost-Prechisten-tekst-25-07-2014.pdf>

*Sipas Ligjit, një person materialisht i pasiguruar konsiderohet një person dhe amvisëri që realizon të ardhura mbi të gjitha bazat që janë më të ulëta se shumata e ndihmës financiare sociale, e përcaktuar me këtë Ligj dhe i cili nuk posedon pronë e as të drejta pronësore nga të cilat mund të jetojë.

⁹⁶ Ligji i Mbrojtjes Sociale – teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 79/09, nr. 36/11, nr. 51/11, nr. 166/12, nr. 15/13, nr. 79/13, nr. 164/13, nr. 187/13, nr. 38/14, nr. 44/14, nr. 116/14, nr. 180/14, nr. 33/15, nr. 72/15, nr. 104/15, nr. 150/15, i disponueshëm në: <http://www.financethink.mk/wp-content/uploads/2017/07/Zakon-za-socjalna-zastita.pdf>

*Bazat e fitimit të ndihmës sociale janë këto në vijim: 1 – personi; 2 – familja dhe amvisëria me dy anëtarë; 3 – familja dhe amvisëria me tre anëtarë; 4 – familja dhe amvisëria me katër anëtarë; 5 – familja dhe amvisëria me pesë dhe më tepër anëtarë


Në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes Sociale, bartësi i së drejtës për ndihmë financiare sociale po përcaktohet nga qendrat e punës sociale dhe ai duhet vërtetuar gjendjen e të ardhurave mujore për vete dhe për të gjithë anëtarët në amvisëri, që të mund të realizojë këtë të drejtë.

Neni 57 i këtij Ligji rregullon se “të drejtë për ndihmë të përhershme financiare ka një person që është i paaftë për punë dhe që është materialisht i pasiguar^{*æ}, i cili nuk mund të sigurojë mjete për ekzistencën e vet, në bazë të rregullave tjera⁹⁷. Paaftësia për punë, në pajtim me Ligjin, del nga gjendje të caktuara shëndetësore, të moshës, ose sociale. Bartësi i kësaj të drejte është personi që nuk është i aftë për punë, si dhe një anëtar tjetër i familjes si bashkë-gëzues i ndihmës, poashtu pa aftësi juridike për punë, ose fëmijë deri në mbushjen e moshës 18 vjeç, apo 26 vjeç, në qoftë se është në shkollim të rregullt. Në pajtim me Ligjin, edhe lartësia e kësaj të drejte harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, njëjtë si me lartësinë e ndihmës financiare sociale.

Në qoftë se shikohen përgjigjet e MPPS të dhëna në Grafikon 14, të cilat kanë të bëjnë me lartësinë e ndihmës së përhershme financiare në tre vitet e fundit, poashtu mund të vërehet rritje e shumës në të gjitha kategoritë për fitim të ndihmës së përhershme financiare.

Grafiku 14

ndihma e përhershme financiare



Në pajtim me Nenin 38 të Ligjit të Mbrojtjes së Fëmijëve: “shtesë prindërore për fëmijë realizon nëna për fëmijën e saj të tretë të lindur gjallë⁹⁸. Për ta realizuar këtë të drejtë, nëna duhet të jetë shtetase e Republikës së Maqedonisë, të ketë vendbanim të vazhdueshëm në vend gjatë 3 viteve të fundit përpara paraqitjes së kërkesës, të kujdeset për fëmijët e vet, gjegjësisht, të mos i është pezulluar e drejta prindërore mbi asnjërin fëmijë, ata të jenë të vaksinuar rregullisht dhe të jenë pjesë të sistemit të detyrueshëm arsimor, dhe në të njëjtën kohë, ajo të ketë kryer rregullisht kontrolle dhe këqyrje shëndetësore gjatë shtatzënisë. Në rastet kur nëna nuk është e gjallë, kur ka braktisur fëmijën, ose për shkaqe të arsyeshme^{*} është e penguar për t’u përkujdesur për fëmijën në mënyrë të drejtpërdrejtë, të drejtën, në vend të nënës, mund ta realizojë babai ose kujdestari, në qoftë se janë përmbushur kushtet e përmendura më herët. Lartësia e

^{*æ}Sipas Ligjit, si person materialisht i pasiguar konsiderohet një person i cili nuk ka të ardhura ose të ardhurat e të cilit në të gjitha bazat si anëtar familjeje konsiderohet personi i cili nuk ka të ardhura, apo të ardhurat e të cilit sipas të të gjitha bazave për anëtar familjeje janë më të ulëta se 5.000 denarë, të harmonizuar me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, të shpallura nga Enti Shtetëror i Statistikave në janar të vitit aktual dhe që nuk posedon pronë dhe të drejta pronësore nga të cilat mund të jetojë.

⁹⁷ Njëjtë

⁹⁸ Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve, teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 23/13; nr. 12/14; nr. 44/14; nr. 144/14; nr. 10/15; nr. 25/15 dhe nr. 150/15, i disponueshëm në: <http://www.mtp.gov.mk/content/pdf/zakoni/>

^{*}Si arsye të bazuara, sipas Ligjit, konsiderohen: mjekimi më afatgjatë i vazhdueshëm i nënës, gjendja rëndë e dëmtuar shëndetësore e nënës, vizita studimore, avancimi dhe specializimi i nënës, si dhe aftësia e pezulluar juridike e punës e nënës.

shumës së shtesës prindërore për fëmijën e tretë, në pajtim me Ligjin, harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak, të shpallura nga Enti Shtetërorë i Statistikave në janar për vitin aktual.

Në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes Sociale, Nenin 70 “të drejtën e ndihmës financiare ka nëna e cila ka lindur të gjallë fëmijën e katërt nga 1 janari të vitit 2009”⁹⁹, ndërsa për të mund ta shfrytëzojë këtë të drejtë, nëna duhet të përkujdeset për fëmijët deri në moshën 18 vjeç, të mos i është pezulluar e drejta prindërore mbi asnjërin nga fëmijët, të jetë e papunësuar dhe të mos shfrytëzojë të drejtën e pensionit pas mbushjes së moshës 62 vjeç të jetës. Në pajtim me Nenin 9 paragrafit 2 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Mbrojtjes së Fëmijëve, “harmonizimi i lartësive të së drejtës së shtesës prindërore për fëmijë nga viti 2010 do të bëhet me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, të shpallura nga Enti Shtetërorë i Statistikave, në janar të vitit aktual”¹⁰⁰.

Për të hulumtuar se sa nëna nga rajonet e targetuara shfrytëzojnë këto shtesa, u kërkuan të dhëna zyrtare nga MPPS. Në lidhje me numrin e rasteve të shtesës së kërkuar dhe/ aprovaaur për fëmijën e tretë dhe të katërt nga nëna, nga MPPS informojnë se në tre vitet e ardhshme kanë gjithsej 23.855 nëna shfrytëzuese të shtesës prindërore për fëmijën e tretë, apo 837 nëna shfrytëzuese të shtesës prindërore për fëmijën e katërt në territorinë e Republikës së Maqedonisë. Numri i nënave që janë shfrytëzuese të kësaj të drejte nga rajonet e targetuara arrin gjithsej 1.925 nëna që shfrytëzojnë shtesën për fëmijën e tretë, apo 54 që nuk shfrytëzojnë shtesë për fëmijën e katërt. Prezantimi i detajuar i ndarë sipas për komunë në rajonet e targetuara, është dhënë në Tabelën 1.

Tabela 1

QPS/komuna e targetuar	Shtesa prindërore për fëmijën e tretë	Shtesa prindërore për fëmijën e katërt
QPS Ohër / Debërcë	29	/
QPS Dibër / Qendra Zhupa	140	6
QPS Makedonski Brod / Pllasnicë	104	4
QPS Tetovë / Bërvenicë	188	5
QPS Tetovë / Jegunoc	103	4
QPS Tetovë / Tearcë	256	2
QPS Gostivar / Vrapçisht	200	8
QPS Strumicë / Novosellë	68	3
QPS Radovish / Radovish	477	10
QPS Radovish / Konçë	57	2
QPS Vallandovë / Vallandovë	129	2
QPS Shtip / Karbincë	85	5
QPS Koçan / Zërnoc	20	/
QPS Koçan / Çeshinovë – Obleshevë	39	/
QÇS Dellçevë / Dellçevë	120	3

99 Ligji i Mbrojtjes Sociale – teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 79/09, nr. 36/11, nr. 51/11, nr. 166/12, nr. 15/13, nr. 79/13, nr. 164/13, nr. 187/13, nr. 38/14, nr. 44/14, nr. 116/14, nr. 180/14, nr. 33/15, nr. 72/15, nr. 104/15, nr. 150/15, i disponueshëm në: <http://www.financethink.mk/wp-content/uploads/2017/07/Zakona-socijalna-zastita.pdf>

100 Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Mbrojtjes së Fëmijëve, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 156/09, i disponueshëm në: <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/8816D57FCA81034AB22F688B6319BD6D.pdf>


Për të marrë të dhëna të caktuara kualitative që duhet të ofrojnë vështrim në perceptivime Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) ndaj shfrytëzimit të të drejtave që dalin nga mbrojtja sociale, gratë rurale gjatë intervistës së zbatuar me përfaqësuesen e Ministrisë i parashtruan asaj një sërë pyetjesh në këtë temë. Ajo theksoi se nga viti 2006 e deri më sot është rritur numri i qendrave të punës sociale (QPS) nga 24 në 30, aq sa ka sot në territorin e Republikës së Maqedonisë, që të vihen më tepër në dispozicionin e qytetarëve. Sipas saj, nga traditat kulturore dhe botëkuptimet patriarkale të komuniteteve, varet kush do t'i qaset QPS për të realizuar ndonjë të drejtë të caktuar. Në komunitetet më tradicionale, në përgjithësi më shpesh drejtohen burrat sesa gratë. Siç u shpreh ajo: *“sipas analizës së buxhetimit të përgjegjshëm gjinor 2008-2009, burrat janë në masën më të madhe bartës të ndihmës sociale. Tani besoj se ka ndryshime dhe është rritur numri i grave. Posaçërisht për shkak të shtesës nga 1000 denarë për nxënës të shkollave të mesme, ku bartës i së drejtës patjetër duhet qenë nëna”*. Në lidhje me shërbimet sociale, gratë e zonave rurale më së shpeshi shfrytëzojnë: të drejtën e mbrojtjes sociale, shtesës për përkujdesje nga një personi tjetër, ndihmës së njëhershme, mbështetjes së nxënësve të shkollave të mesme, e posaçërisht i shfrytëzojnë ato ku kërkohet që gruaja të jetë bartëse.

Për të marrë të dhëna konkrete statistikore nga rajonet e targetuara, për nevojat e humltimeve i paraqitën kërkesa për qasje në informacione me karakter publik në 6 qendra të punës sociale, nga të cilat 4 dërguan përgjigjen e tyre.

Në lidhje me numrin e rasteve të ndihmës së kërkuar dhe/ose aprovuar financiare nga mbrojtja sociale nga gra të ndara sipas moshës dhe përkatësisë etnike, nga QPS Tetovë bëjnë të ditur se në 3 vitet e fundit kanë aprovuar gjithsej 149 kërkesa për ndihmë financiare sociale për gra të komunave të Bërvenicës, Jegunocit dhe Tearcës, ku numri më i madh i shfrytëzuesëve janë të komunitetit etnik maqedonas me gjithsej 85, përderisa më i ulët është numri i atij shqiptar me 64, dhe ato janë në moshë nga 24 deri 65 vjeç. Nga QPS Koçan bëjnë të ditur se në 3 vitet e fundit kanë aprovuar gjithsej 20 kërkesa për ndihmë financiare sociale për gra të komunës Zërnoc dhe po aq kërkesa nga gra të Komunës Çeshinovë-Obleshevë, ku të gjitha shfrytëzueset i takojnë komunitetit etnik maqedonas dhe janë në moshë nga 40 deri 63 vjeç. Nga QPS Ohër bëjnë të ditur se në 3 vitet e fundit kanë aprovuar gjithsej 131 kërkesa për ndihmë financiare sociale për gra të Komunës së Debërcës, ku shfrytëzuesja më e re e kësaj të drejte ishte vetëm 24 vjeç, ndërsa më e moshuara 95 vjeç. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave, 125 janë paraqitur nga pjesëtarëve të komunitetit etnik maqedonas, ndërsa 6 nga përfaqësueset të komunitetit etnik shqiptar. Nga QPS Radovish informojnë se në 3 vitet e fundit kanë aprovuar gjithsej 721 kërkesa për ndihmë financiare sociale për gra, ku pjesa më e madhe e shfrytëzuesëve janë pjesëtare të komunitetit etnik maqedonas me gjithsej 619, ndërsa 92 janë pjesëtare të komunitetit etnik turk, ndërsa një numër më i ulët, apo 3 janë përfaqësueset të komunitetit etnik vllah dhe 7 janë pjesëtare të komunitetit etnik serb. Moshë e shfrytëzuesëve po lëviz nga 26 e deri më mbi 75 vjeç. Ndihma e aprovuar sociale në rajonin e targetuar, e ndarë sipas viteve dhe komunave, është prezantuar në Grafikon 15.

Grafiku 15

Ndihma financiare sociale



Nga informacionet e marra me bërjen e intervistave me gra të përkatësive të ndryshme etnike, me shkallë të ndryshme të arsimit dhe me status të ndryshëm ekonomik në rajonet e targetuara, janë fituar të dhënat më poshtë që kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre sociale.

Të intervistuarat në Rajonin e Pollogut në përgjithësi janë të njohura mirë me mundësitë që ofron shteti për shfrytëzimin e ndihmës dhe mbrojtjes sociale, por më së shpeshi nuk përdorin atë, sepse ato familje që kanë nevojë për kësaj ndihme janë në gjendje të vështirë financiare dhe nuk mund t'i lejojnë vetës të ndajnë nga buxheti familjar për t'i siguruar dokumentet e nevojitura, dhe ndërkaq, ndihma financiare të cilën duhet ta marrin, konsiderojnë se është shumë e vogël. Siç tha një e intervistuar *"edhe ajo ndihmë që e japin është shumë e vogël, dokumentet që duhet t'i paraqesëshë kushtojnë më tepër se ndihma"*. Në të njëjtën kohë, për shumicën e tyre procedura është e ndërlikuar për grumbullimin e dokumenteve të ndryshme, sidomos në qoftë se kërkohen dhe udhëtime të shumëhershme deri tek lagjeja ku ka qendër të punës sociale ose në Shkup, sepse kjo paraqet shpenzim plotësues për buxhetet sidoqoftë të vogla familjare. Siç na tregoi një e intervistuar: *"kur im shoq u operua në Shkup, ne paguam dhe duhet socialja të na i kthejë të hollat, por akoma nuk më janë kthyer. Më kthenin të vija disa herë dhe vazhdimisht më kërkonin dokumente të reja, dhe tanimë nuk shkoj, sepse është shpenzim për mua shkuarja në Shkup"*. Sipas përgjigjeve të të intervistuarave, u dëshmuua se në të shumtën e rasteve këto gra shfrytëzojnë shtesa prindërore për fëmijën e tretë, dhe si shtesë për përkujdesjen për anëtarin e sëmurë të familjeve të tyre, ndërsa në një numër më të vogël të rasteve, përdorin edhe ndihmë sociale.

Sipas intervistave të zbatuara në Rajonin Jug-Perëndimor, në lagjet në Komunën De-bërcë, të cilat edhe pse konsiderohen si zona më të varfëra rurale, treguan se pjesa më e madhe e grave të intervistuarat nuk shfrytëzojnë asnjë ndihmë sociale. Njëra e intervistuar, e cila përpara shumë vitesh kishte jetuar me familjen në qytetin fqinjë, theksoi: *"më herët po merrja ndihmë sociale, dhe pastaj ma shkëputën ndonëse erdha këtu në fshat. Im shoq nuk punonte, në fshat konsideronin se paskam bagëti, paskam ruajtur lopë, paskam patur tokë, paskam punuar tokën, ndërsa toka nuk ishte në emrin tonë, ajo ishte në emrin e pleqve"*. Përshtypja e saj ishte se padrejtësisht i është shkëputur ndihma sociale. Një e intervistuar tjetër, e cila përpara shumë vitesh kishte marrë ndihmë sociale, poashtu ndau përvojën e vet negative nga shfrytëzimi i ndihmës sociale, sepse kishte marrë një shumë me të cilën nuk kishte mundur t'i përmbushte nevojat elementare për jetesë, ose siç tha ajo vet: *"mora para shumë vitesh, kur isha pa punë, megjithatë mora një shumë me të cilën nuk mund të mbijetosh"*. Disa të intervistuarat nga ky rajon po marrin shtesë për fëmijën e tretë ose të katërt, duke theksuar se është kjo arsyeja kryesore përse ka mbajtur shtatzësinë. Një pjesë e tyre thonë se për shkak të arsimit të vet të ulët dhe jokualifikimit, janë paraqitur si kërkuese joaktive të punës në APRIM, dhe po mbahen nga bashkëshortët e tyre të cilët janë mërgimtarë dhe pjesën më të madhe të vitit kalojnë duke punuar jashtë vendit.

Të intervistuarat në Rajonin Lindor ishin të njohura pjesërisht me të drejtat që u mundësojnë mbrojtje shëndetësore, si dhe me mundësitë e ndihmës sociale. Siç tha një e intervistuar të cilës i kishte vdekur bashkëshorti herët: *"më vjen keq që as bursë nuk morën fëmijët. Po orvatesha, por nuk morën. Arsyeja përse më refuzonin, ishte, mbase, sepse po merrja pension social dhe po e tejkaloja limitin financiar"*. Këto të intervistuarat ishin më mirë të njohura me shtesën prindërore për fëmijën e tretë dhe të katërt, si dhe me shtesën fëmijërore, një pjesë të së cilës shfrytëzon një pjesë të tyre.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, me qëllim avancimin e parandalimit social dhe afrimit të mbrojtjes sociale drejt qytetarëve në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, ka realizuar projektin “Ditët e hapura për mbrojtje sociale në zonat rurale”¹⁰¹. Qëllimi bazë i këtij projekti është afrimi i mbrojtjes sociale dhe punës sociale drejt banorëve të zonave rurale, parandalimin dhe zbulimin e hershëm të nënshtrimit ndaj rrezikut social, si dhe intervenimin e mëkohshëm nga qendrat e punës sociale. Projekti është realizuar në tre faza: faza e parë në periudhën shtator-nëntor 2013, faza e dytë gjatë vitit 2014 në periudhën shkurt-qërshor 2014 dhe faza e tretë në periudhën shtator-dhjetor 2014. Sipas të dhënave të MPPS, në të tre fazat me aktivitete të ndryshme informative janë përfshirë gjithsej 1827 vende të banuara (në faqen zyrtare të MPPS nuk ka të dhëna se cilat komuna janë përfshirë me projektin) dhe mbi 10.000 qytetarë, megjithatë, asnjëra nga të intervistuarat tona nuk ishte e njohur me atë se përfaqësues të këtij institucioni kanë patur aktivitete të caktuara në lagjen e tyre.

Për sa i përket problemit me dhunën në familje dhe denoncimin e saj në qendrat e punës sociale nga gratë rurale, nga Ministria konsiderojnë se për shkak të shtrëngesave kulturologjike dhe të vlerave tradicionale, frikës nga pasiguria dhe turpiti, jo çdoherë gratë përcaktohen ta denoncojnë atë, dhe në qoftë se rasti nuk denoncohet, ai as nuk evidenciohet. Kufiri mesatar i moshës së atyre që bëjnë denoncime është nga 18 deri 46 vjeç, në pajtim me raportet që ka Ministria, në vitin 2015 janë denoncuar gjithsej 289 viktima nga zonat rurale, në vitin 2016 gjithsej 284 viktima, ndërsa në vitin 2017, përfundimisht me shtatorin denoncim kanë bërë 166 viktima. Në lidhje me llojet e dhunës që janë denoncuar, nga Ministria bëjnë të ditur se bëhet fjalë për dhunë psikologjike, fizike, seksuale dhe ekonomike. Megjithatë, ato thonë: *“këtu ka problem, ne mbajmë evidencën e rasteve të denoncuara në QPS, ndërsa MPB ka një numër tjetër, nga ato që denoncojnë rastet në polici. Ka dhe të tilla që bëjnë denoncimin në të dy vendet. MPB patjetër duhet të procedojnë çdo denoncim, kurse numrat janë të ndryshëm. Kryesorja këtu është kush kujt më tepër i beson për zgjidhjen e problemit”*. Sipas tyre, komunikimi ndërmjet QPS dhe MPB është në nivel të kënaqshëm, por megjithatë po shfaqen probleme në situata kur viktima ndryshon mendjen dhe ndërpreen procedurën e nisur, dhe në rastet e tilla është e pamundur të priten çfarëdo rezultate. Nga Ministria konsiderojnë se pas ratifikimit të Konventës së Stambollit*, do të tejkalohet një pjesë e madhe e problemeve, si për shembull ai problem që shfaqet për arsye të mënjanimit të viktimave (më së shpeshi gratë dhe fëmijët) nga shtëpia, duke mënjanuar kështu dhunuesin.

Sipas informacioneve të Ministrisë, në territorin e Republikës së Maqedonisë, për momentin janë vetëm 4 qendra strehimi rajonale për viktima të dhunës në familje, të cilat janë njësi organizative të QPS – MPPS, një strehimore dhe një qendër krize për sistemim 24/48 orë, të drejtuar nga një organizate joqeveritare, dhe financiarisht të mbështetur nga MPPS. Sipas Rrjetit Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje* në studimin “Hartizimi i shërbimeve të disponueshme për gratë viktima të dhunës në Republikën e Maqedonisë, për avancimin e sistemit të mbrojtjes dhe tejkalimit të sfidave lidhur me dhunën në familje, midis rekomandimeve tjera, rekomandohet edhe “hapja e qendrave të specializuara të strehimit për gra viktima të dhunës në familje, të dis-

101 Më tepër informacione mund të gjenden në: <http://www.mtsp.gov.mk/otvoreni-denovi-na-socijalna-zashtita-vo-ruralni-sredini.nspix>

* Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Stamboll, viti 2011, e disponueshme në: <https://rm.coe.int/168046253a>. Në çastin e zbatimit të intervistës, Konventa nuk ishte ratifikuar, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë gjatë një seance të mbajtur më 22.12.2017, miratoi Propozim-Ligjin mbi Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)

*Për më tepër informacione, vizitoni: <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/>

ponueshme në këtë rajon, me një vend në çdo 10.000 banorë; ose, në qoftë se qendrat e strehimit bëjnë pjesë të strategjisë shoqërore për intervenim, duhet ekzistuar vend për një familje në çdo 10.000 gra¹⁰². Ilustrimi më i mirë i gjendjes aktuale me shërbimet ekzistuese për viktimat, është prezantuar në Imazhin 3*.

Imazhi 3



Nga Ministria konsiderojnë se dhuna në familje, në përgjithësi ka ndikim të keq mbi jetën jo vetëm të viktimave, por edhe të atyre përreth, familja e ngushtë, fëmijët, fqinjët. Sipas tyre, çdo grua duhet marrë mbrojtjen përkatëse. Ato theksuan se ndihma që organizatat joqeveritare ua ofrojnë viktimave nganjëherë ka rëndësi vendimtare, ato bashkëpunojnë në projekte të ndryshme me organizatat, madje është edhe një linje SOS për viktima, e formuar nga Këshilli Kombëtar për Barazi Gjinore* (KKBGJ), e cila ka kaluar nën kompetencat e MPPS. Sipas përfaqësueses së intervistuar, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, që nga viti 2004 po ndërmer masa dhe aktivitete konkrete për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Është miratuar një kornizë ligjore, akte nënligjore, protokoll bashkëpunimi, është hartuar strategjia kombëtare, janë hartuar standarde për veprim dhe për shërbime të specializuara, janë vendosur këshillimore, strehimore, qendër krize, është formuar Trupi Koordinues Kombëtar kundër Dhunës në Familje. Ajo informoi se në periudhën që vijon do të avancohet sistemi i parandalimit, pengimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, në pajtim me Konventën e ratifikuar të Këshillit të Evropës – Konventa e Stambollit.

Nga informacionet e marra nëpërmjet të kërkesave për qasje në informacione me karakter publik, të dërguara gjithsej 6 qendrave të punës sociale, të cilat përfshijnë rajonet e targetuara, janë marrë të dhëna nga gjithsej 4 qendra.


102 Hartizimi i shërbimeve në dispozicion për gratë viktime të dhunës në Republikën e Maqedonisë, Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës mbi Gratë dhe Dhunës në Familje – Zëri kundër Dhunës, Shkup 2016, fq. 34, i disponueshëm në: http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2016/06/Mapiran-e-na-servisi_final.pdf

*I disponueshëm në: http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2017/08/12801210_755402404599520_60379744674071756_n.jpg

*Për më tepër informacione, vizitoni: <http://www.sozm.org.mk/>

Në lidhje me numrin e rasteve të dhunës në familje të denoncuar nga gra, të ndara sipas llojit të dhunës, moshës dhe përkatësisë etnike, nga QPS Tetovë bëjnë të ditur se në komunat e targetuara rurale në 3 vitet e kaluara janë gjithsej 44 denoncime të dhunës në familje, nga të cilat në vitin 2014 pjesa më e madhe e rasteve ka të bëjë me dhunë fizike, ndërsa në vitin 2015 të dhunës psikike, dhe në lidhje me përkatësinë etnike të viktimave, bëhet fjalë për gra pjesëtare të komuniteteve etnike maqedonase, shqiptare dhe rome. Nga QPS Koçan bëjnë të ditur se nga Komuna Zërnoc në 3 vitet e kaluara kanë gjithsej 2 denoncime të dhunës në familje, ndërsa në Komunën Çeshinovë-Obleshevë kanë gjithsej 5 denoncime. Të gjitha gratë që kanë denoncuar dhunën nga komunat e përmendura më lartë janë të komunitetit etnik maqedonas, ndërsa mosha e tyre lëviz nga 28 deri 45 vjeç. Nga QPS Ohër bëjnë të ditur se nga Komuna Debërcë, në 3 vitet e kaluara, gjithsej 13 gra kanë paraqitur denoncime të dhunës në familje, nga të cilat 12 pjesëtare të komunitetit etnik maqedonas dhe 1 pjesëtare e komunitetit etnik shqiptar, të gjitha këto në moshë nga 17 deri 49 vjeç. Nga QPS Radovish bëjnë të ditur se në 3 vitet e fundit, gjithsej 41 gra kanë paraqitur denoncime për dhunë në familje, nga të cilat 36 pjesëtare të komunitetit etnik maqedonas, 1 pjesëtare e atij shqiptar dhe 4 pjesëtare të komunitetit etnik turk. Mosha e viktimave po lëviz nga mosha 30 deri mbi 65 vjeç. Rastet e denoncuar të dhunës në familje janë ndarë sipas viteve dhe komunave të targetuara, dhe janë prezantuar grafikisht në Grafikon 16, nga i cili mund të vërehet se shumica e rasteve janë denoncuar në komunat e targetuara në Rajonin e Pollogut në vitin 2014.


Grafiku 16



Rastet e denoncuar të dhunës në familje, të ndara sipas viteve dhe sipas llojit të dhunës janë prezantuar në Grafikon 17 (mungojnë rastet e denoncuar në QPS Radovish, sepse të dhënat mbi llojin e dhunës nuk janë numëruar në korrespondencën e tyre), nga i cili mund të shihet se numri më i madh i rasteve të dhunës fizike janë denoncuar në vitin 2014, ndërsa të dhunës psikike në vitin 2015.


Grafiku 17

rastet e dhunës në familje të denoncuar nga gra



Në lidhje me numrin e procedurave të shkurorëzimit të ngritura nga gra, të ndara sipas arsyes së shënuar të shkurorëzimit, moshës dhe përkatësisë etnike të gruas, nga QPS Tetovë informojnë se në vitin 2014 janë paraqitur gjithsej 10 kërkesa nga gra në komunat e targetuara, nga të cilat 3 nga maqedonase dhe 7 nga shqiptare, në vitin 2015 janë paraqitur gjithsej 6 kërkesa shkurorëzimi, nga të cilat 5 nga shqiptare dhe 1 nga maqedonase dhe në vitin 2016 janë paraqitur gjithsej 3 kërkesa shkurorëzimi, të gjitha nga maqedonase. Nga QPS Koçan bëjnë të ditur se janë parashtruar gjithsej 3 procedura shkurorëzimi në Komunën Zërnoc dhe 4 në Komunën Çeshinovë-Obleshevë, të gjitha këto pjesëtare të komunitetit etnik maqedonas, në moshë nga 23 deri 45 vjeç. Nga QPS Ohër bëjnë të ditur se në 3 vitet e fundit janë paraqitur gjithsej 3 procedura shkurorëzimi në Komunën Debërcë nga pjesëtare të komunitetit etnik maqedonas, në moshë nga 31 deri 42 vjeç. Nga QPS Radovish bëjnë të ditur se në 3 vitet e fundit janë paraqitur gjithsej 22 procedura shkurorëzimi, nga të cilat 16 nga pjesëtare të komunitetit etnik maqedonas, ndërsa 6 janë nga pjesëtare të komunitetit etnik turk. Në lidhje me arsyet e ngritjes së procedurës së shkurorëzimit, sipas të dhënave të prezantuara në Grafikon 18, mund të konkludohet se numri më i madh i martesave janë shkurorëzuar në vitin 2014 për arsye të raporteve jofunksionale. Në këto të dhëna mungojnë të dhënat mbi arsyet e martesave të shkurorëzuara në komunat e targetuara nga Rajoni i Pollogut, si dhe nga Komuna e Radovishit, sepse ato nuk janë shënuar në përgjigjet e kërkesës së dërguar deri tek QPS Tetovë dhe QPS Radovish.

Grafiku 18



Në lidhje me problemin e dhunës në familje, të intervistuarat nga Rajoni i Pollogut në përgjithësi po deklaroheshin se dijnë nga ndonjë rast në rrethin e tyre, por jo edhe në familjen e vet më të gjerë. Pjesa më e madhe e tyre konsiderojnë se mund të njihin

dhunë në familje, megjithatë pas bisedës së hollësishme, mund të konkludohet se me dhunë familje njohin kryesisht dhunën fizike. Përjashtim të kësaj janë gratë me arsim të lartë, ose që janë të përfshira në aktivitetet e shoqatave qytetare, që thanë se dijnë të njohin edhe dhunë psikike. Të intervistuarat nga komuniteti etnik shqiptar theksuan se në komunitetin e tyre, nuk është i ulët numri i rasteve kur dhunën kryejnë gratë tjera të bashkësisë familjare, siç janë kunata dhe vjehrra.

Të gjitha të intervistuarat theksuan se rrethi nuk po bën përpjekje për t'i ndihmuar viktimat, sepse ajo konsiderohet si çështje private, gjegjësisht, se të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen në gjirin e familjes. Njëkohësisht, ato konsiderojnë se një pjesë e madhe e rasteve nuk denoncohen për shkak të mosbesimit ndaj policisë, se ajo me të vërtetë do të bëjë diçka për zbardhjen e rastit. Pothuajse të gjitha të intervistuarat, pavarësisht nga përkatësia etnike, ndanë lloje të ndryshme të rasteve të dhunë në familje në rrethin e tyre. Siç tha një e intervistuar: *"para ca kohe ndodhi këtu, në Vrapçisht, ku burri vrau gruan me sëpatë. Ajo po orvatej të kërkonte ndihmë, por nuk kishe reagim nga policia dhe askush nuk donte të përzihej në asçfarë zënkash. Këtu ka sukses ai i cili është më i fuqishëm për nga partia, në këtë rast, burri vinte nga një familje të një funksionari të lartë të VMRO-DPMNE edhe as sot nuk dijmë nëse është në burg"*. Të intervistuarat thanë se një pjesë e caktuar e rasteve po mbetet e paprosuar sepse edhe vetë gratë viktimat tërheqin denoncimet, duke u frikësuar se në qoftë se mëson rrethi se janë të keqtrajtuara, gjendja e tyre do të keqësohet dhe do të ishin përballur me denimin e komunitetit ku jetojnë. Një e intervistuar tregoi për një rast: *"njoh një grua, ajo orvatej ta zgjidhte problemin vetëm, sepse kur kishte denoncuar rastin, fundi kishte qenë më i keq për të, andaj gratë nuk denoncojnë"*. Gratë e këtij rajoni thanë se në lidhje me lirinë e lëvizjes, gratë, sidomos në komunitetin etnik shqiptar, janë akoma të kufizuara, dhe kështu, nëse kanë mirëkuptim nga burri për të lëvizur vetëm, prapsepap hasin në mosmiratimin e rrethit.

Të intervistuarat në Rajonin Jug-Perëndimor, në përgjithësi theksuan se dijnë të njohin dhunë në familje, ndërsa njëra e intervistuar ndau një rast të dhunës brenda një lidhjeje, ku vajza nuk denoncon rastin tek institucionet kompetente. Siç tha: *"mendon se ai e do dhe se do të ndryshojë me kalimin e kohës, dhe turpërohet nga gjykimi i rrethit, se pastaj nuk do të mund të gjejë të dashur tjetër"*. Njëra nga të intervistuarat poashtu tha: *"Nga burrat vuajmë"*. Dhuna psikike, si lloji i dhunës është minimizuar dhe normalizuar, dhe në qoftë se nuk kalon në dhunë fizike, madje edhe nëse nuk sjell viktimën në gjendje të rrezikut për jetë, nuk përjetohet si diçkë posaçërisht traumatike ose e pazakonshme. Të gjitha të intervistuarat ishin të njëzëshme se në qoftë se mësojnë për ndonjë rast të tillë, nuk do ta kishin denoncuar në institucionet kompetente, sepse kjo do të shkaktojë turp për familjen, andaj dhe bëhen përpjekje të fshihen të gjitha rastet e këtilla.

Për dallim nga ato, tek të intervistuarat nga Rajoni Lindor, përgjigjet ndryshoheshin varësisht nga vendbanimi, mosha dhe niveli i arsimit. Të intervistuarat më të moshuara nga njëra komunë, me arsim fillor dhe të mesëm theksuan se është e vështirë ta njohin dhunën në familje, sepse familjet fshehin rastet e tilla, ndërsa gratë heshtin dhe durojnë. Për dallim nga ato, të intervistuarat më të reja që janë në studime, na bënë të ditur se janë të njohura me rast ku i dashuri që është i dhunëshëm dhe i cili fizikisht vazhdimisht po sulmonte të dashurën e vet, dhe në disa raste edhe motrën dhe nënën e saj. Sipas tyre, të gjitha rastet ishin denoncuar në polici, por megjithatë dhunuesi asnjëherë nuk ishte dërguar në paraburgim, ose, siç thanë: *"çka nëse ajo denonconte, kur asgjë nuk mund t'i bëjnë atij, vjen nga një familje "e famshme" dhe ai po shëtitet lirshëm"*. Edhe të intervistuarat nga komuna tjetër na njohën me raste konkrete, ku për shkak të

denoncimit jo me kohë dhe funksionimit jopërkatës të institucioneve, dhuna në familje kishte përfunduar në mënyrë tragjike. Një e intervistuar tregoi një shembull në fshatin e saj për një grua që vazhdimisht kishte denoncuar rastin e dhunës, por megjithatë nuk kishte marrë ndihmë fare nga institucionet. Përveç keqtrajtimit të përditshëm, i shoqi nuk kishte lejuar gruan as të punësohet, dhe kështu, pas 20 viteve të vuajtjes së llojeve të ndryshme të dhunës, gruaja kishte vrarë të shoqin në vetëmbrojtje dhe për momentin ajo po vuan dënimin me burg. Në rastin konkret, edhe gruaja edhe burri kishin qenë me arsim të lartë, që tregon se jo çdoherë gratë e keqtrajtuara me nivel më të ulët të arsimit dhe për shkak të ekzistencës së vet nuk braktisin burrin. Një e intervistuar tjetër tregoi një shembull nga një fshat tjetër, ku një dhunë në familje shumëvjeçare kishte rezultuar me vrasje të gruas, burrit dhe djalit. Një e intervistuar nga e njëjta lagje edhe përkundër asaj se tha se mund të njohë dhunën në familje, ajo tha se nuk di për ndonjë rast të tillë, edhe pse është pothuajse e pamundur të mos kishte dëgjuar për vrasjet për të cilat treguan të intervistuarat tjera, që tregon për faktin se disa gra akoma nuk janë të gatshme që të flasin haptazi për këtë temë. Reagimi i ngadalshëm ose jopërkatës i institucioneve për zgjidhjen e rasteve të denoncuara të dhunës, tek gratë shkakton mosbesim në sistem, dhe kështu, për shkak të frikës për jetën e vet dhe frikës nga dënimi i rrethit ku jetojnë, ato shumë shpesh vendosin të heshtin. Për fat të keq, rrethi jo çdoherë di të njohë viktimën e dhunës në familje, dhe shumë shpesh ajo konsideron këtë si çështje private, gjë kjo për të cilën qëndron anësh.

Pjesëmarrëset në grupin e fokusit nga Rajoni i Pollogut u shprehën se për ato një problem i madh është fakti se në këtë rajon nuk ka qendër strehimi për viktimat të dhunës në familje. Siç thanë, viktimat, pasi që ta denoncojnë dhunuesin në polici dhe në QPS, më së shpeshi nga institucionet i ridërgojnë tek organizatat joqeveritare, të cilat po përpiqen t'u sigurojnë ndihmë falas juridike, por për fat të keq nuk kanë ku t'i vendosin ato. Ata informuan se në bazë mujore, nga 5-6 gra vijnë për konsultë dhe këshillime, disa nga ato që përpara se ta denoncojnë zyrtarisht dhunën nëpër institucionet. Një pjesëmarrëse ndau informacionin se në shumë raste, viktimat, pas denoncimit të dhunës shkojnë tek prindërit e tyre, dhe në qoftë se nuk mund të qëndrojnë aty për një kohë më të gjatë, u rikthehen dhunuesve, sepse nuk kanë mjete financiare dhe ekonomikisht varen nga burri. Siç tha ajo: *"sigurisht se ka bërë denoncime, megjithatë thotë se nuk ka shpëtim nga ai. Njëherë hyri në shtëpinë time me syze dhe nuk donte t'i hiqte ato, kur i hoqi më në fund, kisha çka të shihja, sytë zi"*. Pjesëmarrëset theksuan se me rëndësi të madhe është edukata dhe ngritja e vetëdijes publike për këtë çështje, gjë kjo për të cilën ato në mënyrë të organizuar po ndajnë broshura informative gjatë ngjarjeve publike në fshatrat. Megjithatë, ajo për të cilën po angazhohen është që së bashku me komunën, Qendrën e Punëve Sociale dhe komunitetin e biznesit, të gjejnë mënyrë për hapje të qendrës së strehimit, ku viktimat do të kishin mundur që të sistemohen në mënyrë të sigurt deri në çastin e gjetjes së zgjidhjes afatgjate.

Pjesa e madhe e pjesëmarrëseve në grupin e fokusit nga Rajoni Jug-Lindor vinin nga organizata joqeveritare të grave dhe kishin përvojë në punën me këtë problematikë, para së gjithash, në ofrimin e ndihmës falas juridike, këshillimin, inkurajimin, edukimin e ngjashëm. Ato ishin të njëzëshme se ekziston stigma në këtë çështje, sidomos në mjediset më të vogla ku të gjithë njihen mes vete, dhe në të njëjtën kohë, tek gratë rurale mbizotëro një mosbesim i caktuar në institucionet, kanë frikë që mos të enden nëpër labirintet institucionale dhe përsëri të përfundojnë tek dhunuesi më në fund. Në lidhje me llojet e dhunës të cilët gratë e këtij rajoni njohin, shumica e pjesëmarrëseve ishin të njëzëshme se dhuna fizike po mbisundon, ndërsa, si dhunë në familje konsiderohet vetëm ajo dhunë që ndodh në shtëpi, midis burrit dhe gruas, ndërsa dhuna në bazë

të gjinisë, e sidomos ajo që ndodh midis partnerëve është pothuajse e paidentifikuar dhe fare nuk perceptohet si dhunë në familje. Ose, siç rrëfeu një e intervistuar: *“vajzë, viti 4 në shkollë të mesme, tregon se i dashuri kishte rrahur atë përpara tërë shollës dhe thotë, por ama, është ky faji im, ai më bleu telefon dhe unë nuk iu përgjigja, dhe dihet se përse ma ka blerë... Ajo konsideron se kjo nuk mund të jetë dhunë në familje, sepse ata nuk janë familje, andaj konsideroj se duhet shumë më tepër t’i infromojmë të rinjtë”*. Në të njëjtën kohë, një pjesë e të pjesëmarrëseve konsideruan se qendra e strehimit të viktimave të dhunës në familje duhet qenë një shtëpi e sigurt, vendndodhjen e së cilës do ta dijnë vetëm njerëzit që punojnë në këtë problematikë. Sipas tyre, është e palejueshme që përfaqësues të institucioneve të fotografohen dhe ta promovojnë hapjen e qendrave të strehimit publikisht. Një problem tjetër është se pjesëmarrëset u shprehën se reagimi pamjaftueshëm i mirë dhe e shpejtë i institucioneve kur një grua nga një zonë rurale do të vijë për të denoncuar dhunë ose, siç u shpreh një pjesëmarrëse: *“viktima mezi se kishte gjetur mënyrën dhe kishte marrë guximin për të ardhur, nuk guxojnë ta lënë atë të presë, ta referojnë, të mos i ofrojnë ndihmë dhe mbështetje ose ta regjistrojnë dhunën nën ndonjë kategori tjetër, siç janë, probleme dashurie, për shembull”*.

Duke konstatuar gjendjen me ndihmën e informacioneve të marra nga institucionet qëndrore dhe lokale, të intervistave të realizuara me gra të zonave rurale, si dhe të grupeve të fokusit të përbëra nga përfaqësues të OJQ, konsiderojmë se nevojitet hartimi i politikave dhe masave që të ndikojnë mbi ngritjen e vetëdijes tek qytetarët për problemin me dhunën në familje, që do të çojë drejtpërsëdrejti në reduktimin e numrit të rasteve të dhunës në familje dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës së grave në rajonet rurale.

Për këtë qëllim, nevojitet vendosja e një sistemi funksional të koordinimit midis MPB dhe QPS në lidhje me denoncimin dhe procedimin në rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe mbajtjen e një statistike bashkërisht të harmonizuar. Nevojitet vendosja e një sistemi të vëzhgimit të procedimit të të gjitha institucioneve, që kanë kompetencë për të reaguar në raste të dhunës në familje, dhunës seksuale ose çfarëdo dhune në bazë të gjinisë, me qëllim reagimi i mëkohshëm dhe sanksionimi përkatës në qoftë se nuk veprohet sipas protokolleve të përcaktuara të sjelljes në raste të këtilla. Me rëndësi të madhe është edukimi plotësues dhe sensibilizimi i nëpunësve që realizojnë kontaktet e para me viktimat, siç janë zyrtarët e policisë, nëpunësit e punësuar në qendrat e punës sociale, si dhe punonjësit shëndetësorë për sa i përket trajtimit të viktimave në raste të dhunës në familje, dhunës seksuale ose çfarëdo dhune tjetër në bazë të gjinisë. Njëkohësisht është e nevojshme të fuqizohet roli i koordinatorëve për mundësi të barabarta në ministritë, si dhe në vetëqeverisjet lokale, me ndihmën e aplikimit të masave për cilësimin e sektorëve nga ata, që do të kishte mundësuar aktualizimin më të madh të kësaj problematike dhe qasje e koordinuar në zgjidhjen e saj. Me qëllim inkurajimi i grave që haptazi të flasin për këto tema, t’i aktualizojnë ato dhe të kërkojnë gjetjen e zgjidhjeve përkatëse, nevojitet fuqizimi i lidereve lokale, të cilat do të motivohen që të mbeten në mjediset e veta dhe të punojnë për ngritjen e vetëdijes në këtë çështje. Me rëndësi të stërmadhe është organizimi i fushatës në zonat rurale për ngritjen e vetëdijes mbi të drejtat, mundësitë dhe nevojën e vendosjes së barazisë gjinore, të orientuar barabartësisht ndaj burrave dhe ndaj grave.

Juruket

Hyrje

Në kuadër të hulumtimit, ekipi i projektit bëri përpjekje t'i hulumtonte edhe sfidat me të cilat po përballon një nëngrup i grave rurale, të identifikuar si posaçërisht specifike dhe të cenushme. Bëhet fjalë për një grup të grave me përkatësi etnike turke, juruket, të cilat janë më të përfaqësuara në rajonin juglindor të Maqedonisë, në komunat e Karbincës dhe në Radovich. Ato konsiderohen si popuj nomadë me origjinë të Turkmenistanit, të cilët kanë emigruar nga stepat e Azisë Qëndrore dhe Anadolisë dhe nga aty, në disa valë janë populluar në pjesët lindore të Ballkanit, ndërkaq edhe në Maqedoni, ku jetojnë edhe në ditët tona, të izoluar nga turmat e qytetit duke ruajtur kështu autencitetin e vet. Numri i saktë i grave që i takojnë këtij komuniteti etnik është i panjohur, sepse, sipas regjistrimit të përgjithshëm, ato evidentohen si kombësi turke. Flasin një dialekt specifik të turqishtes, i cili shpesh është i panjohur dhe i pakuptueshëm për folësit e gjuhës standarde turke.

Veçoria kryesore e këtij grupi etnik është izolimi dhe mosintegrimi i tij me pjesën tjetër të shoqërisë maqedonase. Në fakt, edhe në vetë vendin tonë, pjesëtarët e grupeve tjera etnike, sidomos të grupit etnik shumicë, Juruket po përjetojnë si fis ekzotik i cili jeton sipas zakoneve dhe traditave vetjake. Megjithatë, një gërvishtje e vogël në sipërfaqe zbulon se dallimet në fakt edhe nuk janë aq të mëdha, gjegjësisht, se rregullimi i fuqishëm patriarkal, sipas të cilit evidentohen këto bashkësi, është vetëm një formë më rudimentare të patriarkatit të pranishëm edhe në zonat tjera rurale, por edhe në ato urbane.

Perceptimet publike për jetën e jurukeve kryesisht fokusohen në tiparet e tyre antropologjike dhe etnike, pa observuar në mënyrë kritike dështimin e shtetit që t'i ofrojë mundësi integrimi dhe prosperiteti këtij grupi etnik. Nëpër shkresat mediatike, ata janë reduktuar në një grup memec (për shkak të mosnjohjes së gjuhës maqedonase) të grave kurreshatare, por gra shumë të dëgjueshme dhe të nënshtruara "të shkathëta" (në gastronomi) të veshura me roba tradicionale gazmore dhe piktoreske. Mungesa e shërbimeve të disponueshme publikisht aqë më tepër përforcon dhe vë në shprehje izolimin e tyre, dhe duke ditur kushtet e varfëra dhe shpesh substandarde në të cilat jetojnë, i ekspozon gratë, të cilat tradicionalisht janë të lidhura me sferën private dhe kanë arsimim minimal, ndaj një rreziku shumë të lartë nga dhuna ekonomike, fizike dhe seksuale.

Një pengesë e madhe për integrim më efikas të këtyre grave në shoqëri është mosnjohja e gjuhës maqedonase. Duke ditur shkallën e ulët të arsimit dhe mundësitë e pamjaftueshme që arsimimi që kanë kryer ofron për mësuarje të gjuhës maqedonase, ato mbeten në masë të madhe të shkëputura nga institucionet që kanë për detyrë t'u sigurojnë mundësi dhe mbrojtje. Siç thotë mjekja në fshat: *"Pasi përpara 20 viteve filluan të vendoseshin antena satelitore, ato pothuajse as nuk dëgjojnë program në gjuhën maqedonase në mediat, merr përshtypjen se jetojnë diku në ndonjë fshat të Turqisë. Për Maqedoninë nuk dijnë gjë, e as që i intereson. Po t'i pyesim tani, me siguri nuk do ta dijnë se as kush është kryeministër, e as kush është president"*.

Mes tjerash, kur bëhet fjalë për realizimin e të drejtave të këtyre grave, mund të thuhet se aparati shtetëror dhe gjyqësor, me mekanizmat e veta për sanksionimin e dhunës

familjare dhe seksuale, apo dhunës në bazë të gjinisë, janë pothuajse jofunksionale dhe rregullimi i delikteve të këtilla i është lënë të drejtës zakonore të komunitetit, i cili pothuajse rregullisht punon në mbrojtjen e “nderit të familjes”, kurse në dëm të vetë gruas, apo, në shumicën e rasteve, të vajzës.

Në kuadër të hulumtimit u zbatuan 17 intervista të thellësuara dhe disa biseda më të shkurtëra me gra rurale të fshatrave Radanjë dhe Kallauzli të komunës së Karbincës, si dhe të fshatit Ali Koç, të komunës së Radovishit.

Izolimi i komunitetit dhe shkyqja e tyre nga rrjedhat shoqërore bashkëkohore paraqiste një faktor vështirësues në marrjen e qasjes drejt këtij komuniteti, duke patur parasysh faktin se pothuajse të gjitha kontaktet që juruket kanë me botën jashtë fshatrave të tyre po realizohen përmes burrave të tyre, ose anëtarëve tjerë mashkullorë të familjeve. Pasi u themelua kontakti, për shkak të barrierës gjuhësore, ishte me rëndësi kryesore që me ekipin hulumtues, gjatë zbatimit të intervistave, të merrte pjesë dhe një grua lokale, si dhe intervistat të zbatoheshin në hapësirë e cila paraprakisht do të perceptohej si e sigurt, për t’u mundësuar grave të ndjehen lirshëm dhe jo nën presion, me qëllim shmangia e përgjigjeve të preferuara sipas shoqërisë.

Nga hulumtimi, fitohet përshtypja se fshatrat me lartësi më të ulët mbidetare të komunës së Karbincës janë më të integruara në shoqërinë moderne, sepse gratë kanë qasje të caktuar në pavarësinë ekonomike, për shkak të mundësisë së punësimit në fabrikat e tekstitit në Shtip, deri ku kanë transport të organizuar nga fshati me furgon. Megjithatë, sipas hulumtimit tonë, ato gra që përcaktohen, gjegjësisht, që marrin leje nga familja për kësisoj punësimi, janë pakicë dhe shpesh nuk kanë në dispozicion të pavarur mjetet financiare që fitojnë.

Duke folur për vete personalisht, fitohet përshtypja se gratë nuk janë të vetëdijshme se çdo ditë të drejtat bazë të njeriut po u shkelen, siç është e drejta e lëvizjes ose e drejta e zgjedhjes së lirë.

Arsimi

Të gjitha gratë e intervistuar (17) të këtij komuniteti etnik, kanë arsimin fillor të kryer, dhe shumica (13) kanë ndëprerë shkollimin e tyre pas klasës së 4-të të kryer. Të gjitha gratë u shprehën shumë pozitivisht rreth arsimimit, duke thënë se ai është “*gjëja më e bukur*” dhe të gjithë konsiderojnë se kjo gjë do t’u kishte sjellë një pikënisje më të mirë në jetë dhe do t’u kishte mundësuar qasje më të lehtë në pavarësinë ekonomike. Megjithatë, këto deklarata janë kontradiktore ndaj të dhënave se numri më i madh i vajzave nga fshati Ali Koç dhe fshatrat fqinje nuk po vazhdojnë arsimimin e tyre pas klasës së skatërt. Si arsye kryesore për këtë, të intervistuarat cekin faktin se në fshat, edhe përkundër numrit të madh të fëmijëve (diku 90), ka arsim të siguruar vetëm deri në klasën e 4-të, ku si problem i posaçëm nënvizohet ai se fëmijët e klasave të ndryshme, në praktikë kanë vetëm një orë shkollore në javë për ta mësuar gjuhën maqedonase, që në masë të madhe kontribuon për izolimin e tërë komunitetit, e sidomos të vajzave të cilat më së shpeshi nuk marrin shansin për të vazhduar shkollimin jashtë fshatit, dhe kështu mbeten pa veglën kryesore të komunikimit jashtë mjedisit të vet. Megjithatë, më sa duket, qasja e vështirë fizike në klasat më të larta të arsimit fillor (Ali Koç gjendet në lartësi mbidetare nga 800 metra, dhe dimrit rruga për në Radovish është shpesh e ngarkuar me borë), nuk është arsyeja e vetme për ndërprerjen e hershme të arsimimit

të jurukeve. Siç ja informoj specialistja lokale e mjekësisë familjare, koncepti i “nder-it” të familjes, është mishëruar nëpërmjet të virgjërisë seksuale të vajzave në familje, akoma po luan rolin kryesor të rregullimit shoqëror në atë ambient konkret. Si rezultat i kësaj, po shmangen rastet ku vajzave u lejohet lëvizje më e gjatë pa mbikëqyrje, e cila potencialisht do kishte mund të çonte drejt rrezikimit të moralit të tyre. Ky shqetësim është edhe më i shtuar me rastet e praktikës devijuese, ku burra të rinj të rritur (20-30 vjeç) përdorin mënyra nga më të ndryshmet të detyrimit dhe frikësimit, duke përfshirë këtu dhe rrjetet e reja sociale, për të mashtruar vajza 13-14 vjeç nga shkolla në Radovish dhe për t’i përdhunuar ato. Edhe përkundër paraqitjes së denoncimit në polici dhe nisjes së hetimit nga organet e persekutimit, rastet e këtilla përfundojnë në mënyrë që vajza tani më konsiderohet të jetë “e çnderuar” dhe e cila tanimë nuk do të mund të martohet dhe me këtë ta kryejë funksionin e vet kryesor në komunitet, “ia japin” si nuse përdhunuesit, pasi që familja e përdhunuesit do ta paguajë tarifën për nuse, e cila lëviz diku rreth 4000 euro.

Megjithatë, kjo praktikë e padëshiruar nuk mund të shfrytëzohet si argument kundër arsimimit të vajzave, për faktin se një e intervistuar na rrëfeu se si vajza e saj 30 vjeç, e cila asnjëherë nuk ishte regjistruar në shkollë (nëna ka sëmundje kronike, për shkak të së cilës kishte vendosur që bijën më të madhe ta mos edukojë, që të mund të ndihmojë në shtëpi), ishte mashtruar jashtë shtëpisë së saj, nga moshatarë, dhe në oborrin ishte rrëmbyer nga një burrë i rritur, i cili e kishte çuar atë në shtëpinë e tij dhe e kishte përdhunuar. Prindërit kanë arritur ta kthejnë atë në shtëpi me ndihmën e policisë, por pas disa ditësh, përsëri “ia kanë dhënë” si nuse përdhunuesit, sepse tanimë kishte qenë e “çnderuar”. Mjekja na pohoi se viktima është nën terapi të vazhdueshme me ilaçe antidepresion, të urdhëruara nga mjeku specialist, ku ajo si mjekë amë e kishte udhëzuar.

Njëra nga vajzat (17 vjeç) që intervistua, ishte regjistruar në shkollë të mesme, (drejtimi i makinerisë), dhe për në shkollë të mesme po bëhej gati edhe motra e saj më e vogël, e cila dëshironte të bëhej mjekë. Pjesa më e madhe e vajzave që do të arrijnë të regjistrohen në shkollë të mesme ose të vazhdojnë studimet universitare, gjejnë punë në vendet urbane dhe shpërngulen nga fshati.

Shëndetësia

Gjendja në të dy fshatrat ku zbatuam intervistat është mjaft e ndryshme. Arsyeja kryesore për këtë është fakti se në Radanjë nuk ka ambulantë të përhershme, dhe kështu, përveç njëres së intervistuar, të gjitha gratë tjera nuk kanë sigurim shëndetësor, dhe privatisht paguajnë shërbimet e shëndetësisë publike dhe kanë një vetëdije shumë të ulët në lidhje me këqyrjeve të rregullta të rekomanduara.

Nga ana tjetër, në Ali Koç është një ambulantë funksionale me motër medicinale dhe mjekë – specialiste e mjekësisë familjare, e cila, përveçse kujdeset për shëndetin e pacienteve dhe pacientëve të veta, i ndihmon shumë edhe me obligimet administrative që kanë të siguruarat, dhe kështu, të gjitha gratë e intervistuar dhe një vajzë në Ali Koç kishin sigurim shëndetësor, dhe ato që janë me sëmundje kronike, kanë realizuar edhe të drejtën e ndihmës së përhershme financiare për shkak të sëmundjes së rrallë, me ndihmën e mjekes. Veç kësaj, çdo vit ato kryejnë këqyrjet e detyrueshme të rregullta gjinekologjike me ndihmën e mjekes, e cila i udhëzon në Shtip dhe ua mundëson realizimin e të drejtave të tyre për mbrojtje shëndetësore që u takojnë si të siguruarat, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e ndërprerjes së shtatzënisë.

Shembulli me ndikimin e mjekes në këtë mjedis dëshmon se sa domethënës është ekzistimi i një lidereje në mjediset patriarkale, e cila do të kishte mund të ishte shembull i mirë për atë se si arsimimi dhe pavarësia ekonomike çojnë drejt cilësisë më të mirë të jetesës së vetë gruas, por kështu bëhen edhe më të dobishme për komunitetin.

Mbrojtja sociale

Për fat të keq, të intervistuarat që u përfshinë me intervistën nuk janë shumë të njohura me të drejtat e mbrojtjes sociale dhe mënyrat në të cilat ato mund t'i realizojnë. Më të moshuarat nga ato nuk shfrytëzojnë asçfarë ndihmë sociale, dhe ndjehen posaçërisht të rrezikuara, sepse në moshë të shtyrë nuk kanë as pension dhe kështu duhet të varen nga fëmijët e tyre dhe të ndjehen si barrë. Detyra e tyre kryesore është rritja e fëmijëve dhe mirëmbajtja e shtëpisë, dhe nëse u mbetet kohë plotësuese, merren me prodhimin e duhanit, që në fakt është edhe dega kryesore ekonomike në këtë fshat. Megjithatë, shumica e grave më të reja shfrytëzojnë shtesën për fëmijën e tretë dhe të katërt dhe shprehen se shpesh përcaktohen për më shumë fëmijë, pikërisht për shkak të kësaj mase stimulimi.

Gratë, madje edhe kur janë të ngarkuara me detyrë për ndarjen e buxhetit familjar dhe kur paratë ruhen tek ato, nuk vendosin për shpenzim të mëvetësishëm të tyre, ndërsa sipas rregullave të pashkruara, nuk u lejohet që vetë të shkojnë të bëjnë pazarin në dyqanin e fshatit.

Duke patur parasysh pozitën e tyre të varësisë së plotë ekonomike, edhe aq më tepër mosnjohja e gjuhës maqedonase, ato nuk kanë qasje në institucionet, ndërsa anëtarët mashkullorë të familjeve u shërbejnë si lidhje midis tyre dhe shtetit, dhe kur janë të kërçënuara pikërisht nga ata, nuk kanë mënyrë se si ta denoncojnë atë. Veç kësaj, ekziston dhe mosnjohja e themeltë e dukurisë së dhunës në familje si një dukuri negative. Në fakt, edhe vetë gjuha që përdoret për të përshkruar dhunën në familje tregon se deri në cilën shkallë është normalizuar dhe pranuar shfaqja e disiplinimit të dhunshëm të grave nga burrat e tyre, ose nga anëtarët mashkullorë të familjes, sepse për dhunë mbi gruan përdoret shprehja *“(në atë shtëpi) shumë po grinden”* që në mënyrë semantike barabartësisht shpërndan fajin për mospajtimin dhe normalizon dhunën sikur të ishte një zënkë verbale. Një grua e ve më e moshuar tha: *“Le të rrahin, vetëm le të jenë të gjallë”* në përpjekje për të sqaruar se sa e vështirë është jeta pa burrë. Gruaja e vetme më e re (30) që u intervistua haptazi tregoi se dhuna është një dukuri normale dhe se ka ndikim serioz mbi cilësinë e jetave të tyre: *“Le të mos gënjëjnë, 99% të grave këtu rrihen nga burrat, vetëm 1% nuk rrihen”*. Për fat të keq, sipas deklaratës së kësaj të intervistuarë, madje edhe në rastet kur dhuna bëhet e padurueshme dhe gruaja vendos ta denoncojë në polici, përgjigjen që merr nga organet e persekutimit është se *“është ajo punë e shtëpisë”, se “duhet të pajtohen”, dhe që ajo “të mos provokojë”* më. U tregua për vetëm një rast të sanksionimit të dhunës në familje nga policia, kur dhunuesi ishte detyruar të paguante gjobë nga 500 euro, dhe i është thënë që nëse do të përsëriste veprën, do të shkonte në burg. Gjithashtu, na treguan për vetëm një rast të divorcit, pas të cilit gruaja ishte pranuar, së bashku me fëmijët, në familjen e vet primare.

Dhuna në familje është poashtu e pranishme në “disiplinimin” e vajzave kur ato nuk janë “të ndershme”. Është i njohur edhe një rast i kohëve të fundit, ku njëra nga vajzat e klasave më të larta të arsimit fillor ishte xhiruar me kamera në sjellje “të pahijshme” me një moshatar në ndonjë shtëpi të braktisur, gjë kjo pas së cilës incizimi ishte vënë në

internet. Vajza pas kësaj i ishte nënshtruar dhunës nga familja, dhe për faktin se moshatari kishte refuzuar ta merrte për grua, e tërë familja ishte detyruar të shpërngulej në Turqi, për shkak të turpit pas këtij incidenti.

Të gjitha gratë e intervistuarat identifikojnë se jeta e tyre është shumë më e lehtë se jeta e nënave dhe gjysheve të tyre, por kjo gjë është falë makinave moderne që ua lehtësojnë punën, e jo emancipimi ose oferta më e madhe e serviseve nga shteti.

Në pyetjen se çka do të kishte mund shteti të bënte për ato, shumica e grave u përgjigjën se do të kishte mund të hapeshin fabrika tekstili në afërsinë e tyre, që të mund të punësohen dhe të arrijnë pavarësi ekonomike, e përsëri të mbeten nën mbikëqyrjen e familjes dhe rrethit. Gjithashtu, konsiderojnë se një kopsht fëmijësh, apo gjegjësisht, një institucion për përkujdesin ndaj fëmijëve parashkollorë do të ishte shumë domethënëse, sepse do të ketë vend ku t'i lënë fëmijët përderisa ato po merren me aktivitete ekonomikisht të pagueshme.

Martelat e të miturve

Martelat e të miturve nuk janë asgjë e pazakonshme për këtë mjedis dhe ato ndodhin mjaft shpesh, dhe sipas të intervistuarave tona, shfaqja e tyre është shpeshtuar në vitet e fundit, kështu që vajzat shpesh vendosin “të ikin” me të dashurin në moshë mjaft të hershme. Arsyeja për këtë mund të jetë përpjekja që t'i iket martesës së dakorduar, edhe pse të gjitha gratë e intervistuarat vërtetuan se tanimë martelat janë me zgjedhjen personale të bashkëshortit dhe bashkëshortes së ardhshëm.

Edhe pse nuk ndiejnë vetën si një dukuri e preferuar, nuset e mitura në këtë mjedis prapëprap as nuk konsiderohen si ndonjë devijim i madh, duke ditur se vajzat të cilat ndërprejnë arsimin në klasën e 4-të, nuk kanë gjasa të mëdha për gjetje të punës jashtë shtetësisë. Në fakt, për dallim nga rajonet tjera rurale, ku martelat e të miturve më tepër përjetohen si tabu, këtu shumë haptazi po flitet për ato.

Nga të intervistuarat, vetëm dy kishin lidhur martesa përpara se të mbushin moshën 18 vjeç, ndërsa njëra nga ato tanimë ka nuse 16-vjeç, tanimë shtatzëne, me pëlqimin e prindërve, por gjithashtu flisnin edhe për raste aktuale të vajzave të martuara në moshën 13 apo 14 vjeç.

Është me siguri se juruket janë të izoluar, megjithatë, sipas të dhënave të marra në kuadër të hulumtimit, ajo nuk është aq rezultat i mbylljes dhe jopërgatitjes së tyre për t'i pranuar rrjedhat shoqërore, sa është kjo rezultat i mangësive në sistemin dhe në tërë shoqërinë. Për të përmirësuar cilësinë e jetesës dhe gjendjen e këtyre grave, nevojitet që shteti t'ia arrijë të gjejë mënyra të afrimit të këtyre grave drejt rrjedhave kryesore shoqërore, si dhe mundësimin e mbrojtjes së të drejtave të garantuara me kushtetutë, pa humbur specifikat e veta dhe autencitetin e vet.

Studim i rastit 1

S.LI. është një vajzë njëzet e katër vjeç nga fshati Broshticë, Qendra Zhupa, Maqedonase-Muslimane, defektologe e diplomuar, e cila punon në Zhupë si profesore e shkollës së mesme.

E lindur në një familje me shumë fëmijë, me shumë motra dhe një vëlla, S. vendos që, edhe përkundër presionit të madh të rrethit, të vazhdojë shkollimin dhe të bëhet defektologe e diplomuar, e pastaj të kthehet në fshatin e lindjes, edhe përkundër mundësisë e ofruar që të largohet jashtë vendit, ku jetojnë disa nga motrat e saja.

S. në mënyrë aktive po lufton kundër paragjykimeve dhe përjetimit tradicional të rolit të gruas në rrethin e vet. Që nga mosha e hershme vendos se do të vazhdojë shkollimin, që të mund t'i ndihmojë fëmijët dhe njerëzit me aftësi të kufizuara që më lehtë të integrohen në komunitet. Shkollën fillore kryen në fshatin e lindjes, shkollën e mesme në Shkup, duke prezantuar rezultate të jashtëzakonshme gjatë shkollimit, e pastaj vazhdon studimet përsëri në Shkup, pranë Institutit të Defektologjisë, ku diplomon dhe merr titullin defektologe e diplomuar. Për momentin nuk punon sipas profesionit, në fakt, punon si profesore, por pret dhe shpreson se kjo do të ndryshojë së shpejti.

Tradicionalisht në Broshticë, vajzave shumë rrallë u lejohet të vazhdojnë shkollimin e mesëm, pjesërisht sepse nuk ka shkollë të mesme në vetë fshatin, e kështu duhet të udhëtojnë në Zhupë për në gjimnaz (15 km) ose në Dibër për arsim profesional, por më së shumti sepse nga ato nuk pritet të kenë ndonjë profesion dhe të fitojnë para, por të kujdesen për shtëpinë dhe anëtarët tjerë të familjes. Në fakt, pavarësia ekonomike e grave më së shpeshi nuk përjetohet si e dëshirueshme, por më tepër si kërcënim për rolin tradicional të burrit, si ai që fiton në familje dhe mban monopolin mbi financat, dhe me këtë edhe mbi sjelljen e vendimeve në lidhje me familjes.

S. është e vetëdijshme për diskriminimin që bëhet mbi vajzat në rrethin e saj, duke mos i lejuar ato të vizitojnë shkollë të mesme pas përfundimit të shkollimit të mesëm dhe po orvatet të ndikojë rrethin nëpërmjet të shembullit të saj pozitiv, edhe pse shpesh përballat me refuzim. Përmes shembullit të saj personal, ajo po orvatet t'i motivojë vajzat t'i shfrytëzojnë mundësitë që u janë ofruar për t'i realizuar endërrat e tyre, edhe pse në këtë gjë nuk ka mbështetje të madhe nga komuniteti.

Përkundër kësaj, në rrethin S. vlen si një person i jashtëzakonshëm dhe bashkëfshataret dhe bashkëfshatarët e respektojnë atë dhe e pranojnë si autoritet, por gjatë shkollimit, e madje edhe sot, ajo po përballat me shumë thashetheme në lidhje me vullnetin e saj të lirë, e sidomos në lidhje me studimet dhe qëndrimin në Shkup. Ajo haptazi flet për atë se si çdo këqyrje mjekësore, madje edhe stomatologjike të vajzave të këtij fshati, mjedisi interpreton si abort dhe provë e lidhjes amorale (jashtë martesës) tek gratë që nuk janë në martesë, ose egoizëm tek gratë që janë në martesë. Në të njëjtën kohë, pavarësia e saj ekonomike dhe arsimit i lartë kanë efekt frikësues mbi mjedisin, pra ajo nuk sheh se si në këtë ambient do të kishte mund të gjente partner ose të krijonte familje.

Ajo konsideron se përgjegjës për suksesin dhe vetëbesimin e saj janë prindërit e saj, të cilët në asnjë çast nuk janë munduar ta kufizonin atë, por ata kanë inkurajuar për t'i realizuar dëshirat e veta. Ajo haptazi flet se nëna e saj është një nga gratë e rralla në fshat që nuk është e detyruar të kërkojë lejen e bashkëshortit, ose nga prindërit e

bashkëshortit, në lidhje me lirinë e vet të lëvizjes. Megjithatë, ajo haptazi tregon se prindërit e saj kanë vendosur të kanë më tepër fëmijë derisa t'u lindte djalë, sepse konsiderohet se vetëm fëmijët meshkuj vazhdojnë lozën familjare. S. është një nga gratë e rralla të fshatit që nganjëherë hy në kafenenë e fshatit, që, sipas rregullës së pashkruar, konsiderohet si ambient i pahijshëm për gra.

Shembulli i S. tregon se si në rajone të caktuara në një vend të vetëm, vetëm vajzat dhe gratë jashtëzakonisht të talentuara dhe luftarake mund të marrin mundësinë e realizimit të të drejtave të veta të arsimit dhe mbrojtjes shëndetësore, dhe kjo gjë jo rrallë shoqërohet me reperkusione të caktuara në lidhje me integrimin social në mjedisin e lindjes.

Studim i rastit 2

K.T. është grua në moshë midis 30 dhe 40 vjeç nga fshati Radanjë, komuna Karbincë, nga grupi etnik turk – jurukë. Ka kryer arsim fillor në shkollën fillore “Strasho Pinxhur” në fshatin Karbincë, por nuk kishte vazhduar arsimin, sepse shkolla më e afërt e mesme gjendet në Shtip, kështu që udhëtimi i përditshëm kishte paraqitur ngarkesë për familjen e saj. Dy vëllezërit e saj kanë kryer jo vetëm shkollën e mesme, por edhe arsim të lartë.

K.T. është e punësuar dhe është e vetmja në familje që ka të ardhura stabile dhe të rregullta gjatë tërë vitit. Është relativisht e kënaqur me kushtet që ka në vendin e punës dhe nga të drejtat e veta të punëtorit, duke ditur se ata nuk i mbajnë në punë jashtë orarit, kanë ditë të diela të lira dhe kanë rrogë të rregullt. Nga ana tjetër, konsiderojnë se rroga minimale që ajo merr është e pamjaftueshme dhe se rroga nga 20.000 denarë do të ishte më e përshtatshme për mundin. K.T. krenohet shumë se vetë fiton për jetesë, fakt ky i cili përveç sigurisë materiale, i ofron edhe respekt në sytë e familjes dhe komunitetit, dhe gjithashtu i jep dhe një mobilitet të caktuar për të lëvizur nëpër shtip, pa mbikëqyrjen e familjes dhe mjedisit.

Sido që të jetë, merret përshtypja se K. Nuk menaxhon vetë paratë që fiton, sepse nuk e dinte se cili është numri i xhiro-llogarisë së saj, gjegjësisht, ajo duhej ta pyeste vëllaun e vet në lidhje me të dhënat e saja bankare. Gjithashtu, është simptomatike se në takimin e dytë të caktuar me të, K. nuk u shfaq dhe nuk u përgjigjej telefonatave gjatë asaj dite, që në ditën e ardhshme të na informonte se nuk kishte patur telefonin me vete, e pastaj nuk arritëm të caktonim takimin e radhës.

Për faktin se ajo mirë po zotëronte gjuhën maqedonase, për dallim nga shumica e grave më të moshuara të fshatit, ka qasje më të lehtë në shërbimet sociale dhe shëndetësore, të cilat prapseprap rrallë shfrytëzohen, më së shumti për shkak të mosbesimit tradicional në institucionet e sistemit nga ky grup etnik, dhe në masë të madhe, për arsye të mospasjes së shprehisë të shfrytëzohen të drejtat dhe përfitimet nga këto lloje të mbrojtjes (sociale dhe shëndetësore), nga të cilat pjesëtarët e këtij grupi etnik janë pothuajse të përjashtuara, edhe pse i takojnë një grupi të cenueshëm.

Megjithatë, nga intervistat që bëmë me disa vajza të mitura të fshatit, tek gjeneratat më të reja ekziston tendenca dhe dëshira e qartë për të vazhduar arsimin dhe të kualifikohen për ndonjë profesion të caktuar.

Sipas përgjigjeve të saja, K.T. nuk ndjehet e diskriminuar nga rrethi i vet dhe konsideron se jeta për gratë e gjeneratës së saj është shumë më e lehtë në krahasim me jetën e nënave të tyre, më së shumti sepse bujqësia dhe blegtoaria (të cilat i konsideron si veprimtari jashtëzakonisht të rënda dhe të mundimshme) nuk janë alternativa e vetme për ta për ekzistencë materiale. Edhe krahas kësaj, merret përshtypja se K. në masë të madhe na jepte përgjigje të preferuara për shoqërinë lidhur me temat që akoma konsiderohen si tabu në shoqërinë tonë, sidomos në zonat rurale dhe në bashkësitë e marginalizuara (dhuna familjare dhe seksuale, shkurorëzimi dhe kujdestaria ndaj fëmijëve, këqyrjet gjinekologjike). Edhe vet nuk guxonte të ulet në tavolinë me ne pa lejen e një anëtari mashkull të familjes, dhe na tregoi se zakonet e blerjes së nuseve në rrethin e tyre janë çrrënjësor, edhe pse më vonë, nga një burim i drejtpërdrejtë mësuam se përpara vetëm disa muajve, janë paguar 4000 euro për një nuse nga fshati Koxhali i Radovishit.

Për fat të keq, pikërisht kur u vendos një lidhje më e afërt dhe kur filluan dalë ngadalë të zbulohen problemet shqetësuese të grave të këtij rrethi, komunikimi përnjëherë u ndërpre dhe më nuk arritëm të hynim në kontakt me të.

Konkluzione dhe rekomandime

Hulumtimi dëshmoi se sot jeta e grave rurale në mjedise të caktuara po dallon në raport me të kaluarën, si rezultat i ndryshimeve shoqërore që janë pasojë e demokratizimit të shoqërisë, përpjekjeve të gruas për barazi, globalizimi. Megjithatë, për të arritur barazinë e potë të gruas rurale në shoqëri, nevojitet mëvetësia dhe pavarësia më e lartë ekonomike, si dhe përfaqësimi më i lartë në jetën politike. Matrica patriarkale dhe ndarja tradicionale e roleve në role mashkullore-femërore, sidomos rreth shtëpisë dhe familjes akoma paraqesin pengesë në masë të madhe, sidomos në zonat rurale. Gratë në zonat rurale kanë mundësi shumë të vogla për jetë sociale, sepse më së shpeshi kafenetë ose kafeteritë paraqesin “vend të ndaluar” për gratë, e objekte tjera të argëtimit as nuk ekzistojnë. Largësia nga qytetet më të mëdha, si dhe mosekzistimi i transportit publik të organizuar mirë janë pengesë plotësuese për socializimin e ndërsjellë të tyre në një hapësirë publike, dhe si rezultat, alternativa që u mbetet janë vizitat e ndërsjella në shtëpitë e tyre. Këto gra konsiderojnë se shteti duhet bërë përpjekje plotësuese për ndërtimin e kopshteve të fëmijëve, shkollave dhe ambulantave, gjëra këto të cilat do ua kishin lehtësuar jetën, dhe në të njëjtën kohë, me sjelljen e politikave për ndihmë financiare, duhet ta nxisin zhvillimin e rajoneve rurale. Ato njohin edhe organizatat qytetare, sidomos ato lokale, si veprues të fuqishëm në mjediset, sepse kanë mundësi që nga afër dhe më lehtë t’u qasen grave.

Si rezultat i gjërave të përmendura më lartë, konstatimi i përgjithshëm i hulumtimit sjell konkluzionin se legjislati në Republikën e Maqedonisë, në masën më të madhe ofron mundësitë e zhvillimit të grave në zonat rurale, por megjithatë ekziston nevoja për zbatim të plotë të akteve ligjore dhe akteve nënligjore që tanimë ekzistojnë. Në një pjesë, nevojitet dhe ndryshimi i tyre, para së gjithash, për arsytet më poshtë:

- Bërja e mundur të qasjes përkatëse në arsim për gratë në zonat rurale;
- Thjeshtësimi i procedurës së APRM për parashikimin e sigurimit shëndetësor për personat e papunësuar;
- Inkurajimi i gjinekologëve të punojnë në zonat rurale;
- Sigurimi i masave plotësuese sociale për gratë në zonat rurale;
- Precizimi plotësues i legjislatit dhe aplikimi i sanksioneve për personat e rritur që janë në bashkësi jashtëmartesore me të mitura të rritura;
- Ndryshimi i akteve ligjore në drejtim të rritjes së pragut të moshës kur mund të lidhet martesë;
- Vendosja e një Fondi për Mbështetjen e Grave në Zonat Rurale, mjetet financiare të të cilit do t’u ndahen shoqatave të qytetarëve pas projekteve të paraqitura më herët dhe me tregues të rreptë të vlerësimit.

Për të tejkaluar gjendjet ekzistuese dhe për të përmirësuar pozitën e grave në zonat rurale, ekipi hulumtues propozon masat e propozuara sipas fushave:

Arsimi:

- Ndryshimi i programit mësimor në shkollat fillore me qëllim inkuadrimi i lëndëve dhe librave mësimorë të cilat do të thyejnë stereotipet gjinore;
- Inkuadrimi i edukimit seksual në shkollat fillore dhe të mesme dhe/ose punëtori të shtuara, të cilat do të drejtohen nga edukatorë moshatarë nëpër shkollat;
- Sigurimi i zbatimit të qëndrueshëm të dispozitave për sigurim të transportit falas deri dhe nga shkollat, me aplikim të sanksioneve për komunat që nuk do t'i zbatojnë ato;
- Zbatimi i programeve për kualifikim plotësues dhe rikualifikim për gratë në zonat rurale, si dhe sigurimi i kushteve për “mësim nga distanca”;
- Zbatimi i procedurës për sanksionimin e prindërve që do të ndikojnë mbi ndërpre-rjen e arsimit të detyrueshëm për fëmijët e tyre;
- Rritja e fondit të orëve në gjuhën maqedonase në shkollat fillore ku jetojnë juruket;
- Hapja e institucioneve të përkujdesit për fëmijët e moshës parashkollore në komunat rurale, ose propozimi i masave të përkujdesit për fëmijë nga gra të trajnuara nga komuniteti, të subvencionuara nga vetëqeverisjet lokale;

Shëndetësia:

- Ricaktimi dhe pajisja e objekteve të pashfrytëzuara institucionale në zonat rurale, në ordianca mjekësore;
- Vendosja e ndarjes së barabartë territoriale të ordiancave gjinekologjike;
- Vënia e masave për nxitje të gjinekologëve të punojnë në zonat rurale (pika më të larta për pacient, subvencione për pajisjen e ordiancës, e ngjashëm);
- Vënia e sistemit të evidencës në Ministrinë e Shëndetësisë të ndarë sipas vendbanimit të shfrytëzuesve(shfrytëzueseve) të shërbimeve;
- Vënia e sistemit të evidencës në të cilin, gjatë grumbullimit dhe kategorizimit të të dhënave, grupmosha të ndahet në 15 deri 18 vjeç dhe pastaj nga 18 vjeç e më tepër, për të patur informacione të sakta të cilat do të procesohen, nëse bëhet fjalë për persona të mitur apo të rritur;
- Analiza e programeve shëndetësore dhe shfrytëzimi i tyre (suksesi) në bazë të vendbanimit të shfrytëzuesve(shfrytëzueseve) të shërbimeve;
- Vënia e sistemit të koordinimit dhe lidhjes së shtëpive të shëndetit, qendrave të shëndetit publik dhe spitaleve të përgjithshme;
- Informimi i detyrueshëm i Ministrisë së Shëndetësisë nga shtëpitë lokale të shëndetit që kanë dhoma të lindjes, dhe mbajtja e statistikës përkatëse për rastet e lindjes tek vajzat e mitura, si dhe për rastet e shtatzënisë së ndërprerë në mënyrë spontane ose me qëllim tek vajzat e mitura;

-Mjetet më të lira kontraceptive (vënia e kontraceptimit oral për gra dhe burra në listën pozitive);

-Vendosja e klinikave gjinekologjike lëvizëse të cilat do t'i vizitojnë edhe zonat më të largëta rurale dhe do t'u mundësojnë këshillime, këqyrje dhe shërbime një numri sa më të madh të grave rurale.

Martestat e të miturve:

-Vendosja e një sistemi të evidentimit të bashkësive jashtëmartesore, sidomos ato ku njëri ose të dy partnerët janë të mitur;

-Edukimi i vazhdueshëm i prindërve dhe i fëmijëve për pasojat e dëmshme që mund të shfaqen si rezultat i martesave të të miturve;

-Aplikimi i sanksioneve për njerëzit që ndërmjetësojnë procesin e “blerjes” së nuseve nga shtete tjera;

-Shkurajimi i njerëzve që përcaktohen për lidhje të martesave të tilla.

Mbrojtja sociale:

-Sensibilizimi i punonjësve në qendrat e punës sociale ose aplikimi i sanksioneve në bazë të ankesave të qytetarëve, për të korigjuar kontaktin e parë të qytetarëve me këto institucione, si dhe besimin në ato;

-Ndryshimi i mënyrës së klasifikimit dhe mbajtjes së të dhënave statistikore (grupmoshat nga 15 deri 18 vjeç, shpërndarja territoriale, e ngjashëm);

-Vendosja e punonjësve lëvizës të sportelit të APRM, të cilët do të mundësojnë dhënie të shërbimeve në vende që janë lehtë të qasshme për gratë e zonave rurale;

-Vendosja e një sistemi funksional të koordinimit të MPB dhe QPS për sa i përket denoncimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke përfshirë këtu dhe mbajtjen e statistikës bashkërisht të harmonizuar;

-Vendosja e sistemit të vëzhgimit të veprimit të të gjitha institucioneve që kanë kompetenca të reagojnë në raste të dhunës në familje, dhunës seksuale ose cilësdo dhune në bazë të gjinisë, me qëllim reagimi i mëkohshëm dhe sanksionimi përkatës në qoftë se nuk veprohet sipas protokolleve të përcaktuara të sjelljes në raste të tilla;

-Edukimi dhe sensibilizimi plotësues i zyrtarëve që realizojnë kontaktet e para me viktimat, siç janë zyrtarët e policisë, nëpunësit e qendrave të punës sociale, si dhe punonjësit shëndetësorë, në lidhje me trajtimin e viktimave në raste të dhunës në familje, dhunës seksuale ose të cilësdo dhune në bazë të gjinisë.

Bibliografia

1. Mallnes Raino dhe Midgard Knut, Filozofika Politike, Feniks, Shkup, 2008;
2. Sllapshak Svetlana, Ikonat e femrave të Shekullit XX, Templum, Shkup 2003;
3. D-r Stojanoviç Gjorgjeviç Dijana, "Integrimi i aspektit gjinor në politikë si një nga kushtet e vendosjes së barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë", Universiteti Kirili dhe Metodi, Instituti i Kërkimeve Sociologjike dhe Politiko-Juridike, Shkup, 2014;
4. Swedish International Development Cooperation Agency, "Supporting Women's Economic Empowerment: Scope for Sida's Engagement", 2015;
5. Quintanilla Barba Carmen, "Rural women in Europe", Committee on Equal Opportunities for Women and Men Rapporteur: Spain, EPP/CD 2010;
6. Organizata Rome për Afirmim Multikulturor – Roma SOS "Zona gri" ndërmjet traditës dhe të drejtave të fëmijëve, Prilep, 2016;
7. Fondacioni i Demokracisë i Westminster, "Martesat e fëmijëve: nga dashuria e deri në shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut", Shkup, 2016;
8. UN Commission on the Status of Women, "Rural Women, Their Contributions and Challenges", February 23, 2012;
9. UNFPA, "Worlds apart – Reproductive health and rights in an age of inequality", State of world population, 2017;
10. Analiza e shkallës së zbatimit të Ligjit të Mundësive të Barabarta të Grave dhe Burrave, Shkup, qershor, 2011;
11. Anketa mbi shfrytëzimin e kohës, 2014/2015, Enti Shtetëror i Statistikave, Shkup;
12. "Gratë dhe burrat në Maqedoni", 2017, Enti Shtetëror i Statistikave, Shkup;
13. Finance Think, Ed Plako Application;
14. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e RM", nr. 52/91;
15. Raporti i gjashtë Periodik në bazë të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit, 2017;
16. Raporti mbi realizimin e detyrave programike në pajtim me Programin Vjetor Kombëtar për Shëndet Publik i Republikës së Maqedonisë për vitin 2016;
17. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Stamboll, 2011;
18. "Hartizimi i shërbimeve të disponueshme për gratë viktime të dhunës në Republikën e Maqedonisë", Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje – Zëri kundër Dhunës, Shkup 2016;
19. "Programi për detektimin e hershëm të sëmundjeve malinje në Republikën e Maqedonisë për vitin 2017", "Gazeta Zyrtare e RM", nr. 192/16;
20. Ligji i Ndihmës Falas Juridike – teksti i konsoliduar, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 161/09 dhe 185/11
21. Ligji mbi Punësimin dhe Sigurimin në Rast Papunësie – teksti i konsoliduar, 2014;
22. Ligji i Mundësive të Barabarta të Grave dhe Burrave, "Gazeta Zyrtare e RM", nr. 66/06;
23. Ligji i Arsimit Fillor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017
24. Ligji i Marrëdhënieve të Punës, "Gazeta Zyrtare e RM", nr. 74/15;

- 25.Ligji mbi Pengimin, Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 138/14;
- 26.Ligji mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 50/10;
- 27.Ligji i Arsimit të Mesëm “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017;
- 28.Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Përgjigja në kërkesë nr. 12-8734/2 e datës 03.08.2017;
- 29.Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Përgjigja në kërkesë nr. 14-463/8 e datës 5.08.2017;
- 30.Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 7/05, 103/08, 124/10, 43/14, 135/11, 153/15 11 99 /16;
- 31.Ligji mbi Mbrojtjen e Fëmijëve – teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 23/13; nr. 12/14; nr. 44/14; nr. 144/14; nr. 10/15; nr. 25/15 dhe nr. 150/15;
- 32.Ligji mbi Sigurimin Shëndetësor, teksti intern i konsoliduar “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 65/2012, 16/2013 dhe 91/2013;
- 33.Ligji mbi Mbrojtjen Sociale – teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 79/09, nr. 36/11, nr. 51/11, nr. 166/12, nr. 15/13, nr. 79/13, nr. 164/13, nr. 187/13, nr. 38/14, nr. 44/14, nr.116/14, nr. 180/14, nr. 33/15, nr. 72/15, nr. 104/15, nr. 150/15;
- 34.Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Mbrojtjes së Fëmijëve, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 156/09;
- 35.Ligji mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural – teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 49/2010; 53/2011, 126/2012, 15/2013 dhe 69/2013;
- 36.Ligji mbi Mbrojtjen e Fëmijëve – teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 23/13; nr. 12/14; nr. 44/14; nr. 144/14; nr. 10/15; nr. 25/15 dhe nr.150/15;
- 37.Ligji mbi Familjen – teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e RM”, nr.153/2014;
- 38.Ligji mbi Mbrojtjen Sociale – teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 79/09, nr. 36/11, nr. 51/11, nr. 166/12, nr. 15/13, nr. 79/13, nr. 164/13, nr.187/13, nr. 38/14, nr. 44/14, nr.116/14, nr. 180/14, nr. 33/15, nr. 72/15, nr. 104/15, nr. 150/15;
- 39.Kodi Penal – teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 80/99, nr. 4/02, nr. 43/03, nr. 19/04, nr. 81/05, nr. 60/06, nr.73/06, nr. 7/08, nr. 139/08, nr. 114/09, nr. 51/11, nr. 135/11 , nr. 185/11, nr. 142/12, nr. 166/12, nr. 55/13, nr. 82/13, nr. 14/14, nr. 27/14, nr. 28/14, nr. 115/14 dhe nr. 132/14;
- 40.http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat__PoloviStat/125_PoloviStatistiki_en.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef;
- 41.pdf/UNFPA_PUB_2017_EN_SWOP.pdf <http://brr.gov.mk/mk/%D0%BF%D0%BB%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D1%80%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D0%BE%D0%BD%D0%B8-%D0%BD%D0%B0-%D1%80-%D0%BC%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0/>;
- 42.<http://mkd-news.com/detsa-za-orden-peshachat-na-20-sekoj-den-po-4-km/>; <http://www.tirekovmirece.com/Novost/%D0%A2%D1%80%D0%B3%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0%D0%B0%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D1%83%D1%87%D0%B8%D0%BB%D0%B8%D1%88%D1%82%D0%B5-%D1%81%D0%BE-%D0%B8%D0%B7%D0%B3%D1%80%D0%B5%D1%98%D1%81%D0%BE%D0%BD%D1%86%D0%B5-%D0%B0-%D1%81%D0%B5-%D0%B2%D1%80%D0%B0%D1%9C%D0%B0%D0%B0%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%B7%D0%B0%D1%98%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%BE%D0%BD%D1%86%D0%B5>;

[http://tv21.tv/mk/?p=60419;](http://tv21.tv/mk/?p=60419)
[https://sdk.mk/index.php/glasno-za-ombudsmanot/prvache-posebni-potrebi-peshachi-po-13-km-shkolo-oti-nema-prevoz/;](https://sdk.mk/index.php/glasno-za-ombudsmanot/prvache-posebni-potrebi-peshachi-po-13-km-shkolo-oti-nema-prevoz/)
43. <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/Zakon%20za%20prevencija%20semejno.pdf>
44. [http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20oigsuruvanje%20\(Interen%20precisten%20tekst\).pdf;](http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20oigsuruvanje%20(Interen%20precisten%20tekst).pdf)
45. [http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/PROGRAMA_ZA_RANA_DETEKCIJA_NA_MALIGNI_ZABOLUVANA_VO_RM_ZA_2017_GODINA.pdf;](http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/PROGRAMA_ZA_RANA_DETEKCIJA_NA_MALIGNI_ZABOLUVANA_VO_RM_ZA_2017_GODINA.pdf)
46. http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Naselenie__Vitalna/125_VitStat_Op_RodVozMajk_mk.px/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef;
47. [http://mojtermin.mk/;](http://mojtermin.mk/)
48. [http://www.mojmaticenginekolog.com/;](http://www.mojmaticenginekolog.com/)
49. [http://www.libertas.mk/debar-reka-i-tsentar-zhupa-ostanaa-so-samo-edem-ginekolog/;](http://www.libertas.mk/debar-reka-i-tsentar-zhupa-ostanaa-so-samo-edem-ginekolog/)
50. http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat__PoloviStat/125_PoloviStatistiki_en.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef;
51. [http://www.mtsp.gov.mk/otvoreni-denovi-na-socijalna-zashtita-vo-ruralni-sredini.nspix;](http://www.mtsp.gov.mk/otvoreni-denovi-na-socijalna-zashtita-vo-ruralni-sredini.nspix)
52. [http://www.sozm.org.mk/;](http://www.sozm.org.mk/)